



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VJETOR

JANAR-DHJETOR 2016

I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË BORDIT TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	
1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 5
1.1.	TË ARRITURAT KRYESORE 5
1.2.	SFIDAT DHE PENGESAT 5
2.	KORNIZA LIGJORE 8
2.1.	RREGULLORET DHE PROCEDURAT E APROVUARA GJATË VITIT 2016 NGA AGJENCIA..... 9
3.	PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT 10
3.1.	MISIONI DHE VIZIONI 10
3.1.1	MISIONI..... 10
3.1.2	VIZIONI..... 10
3.2.	KOMPENTENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT..... 10
4.	FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA 11
4.1.	BORDI I DREJTORËVE..... 11
5.	AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 13
5.1.	SHITJA DHE ADMINISTRIMI I ASETVE 13
5.1.1	SHITJA E ASETVE 14
5.1.1.1	SHITJA E ASETVE 2016 DHE OBJEKTIVAT 15
5.1.1.2	MASAT E PËRKOHSHME NGA DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME..... 18
5.1.1.3	SPIN OFF–ET SPECIALE DHE ME KUSHTE TË VEÇANTA..... 18
5.1.2	SHITJA E BANESAVE – BARTJA E SË DREJTËS BANESORE..... 26
5.1.3	KOMISIONI PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE JOLIGJORE NË PRONAT E NSH-ve 26
5.1.4	ADMINISTRIMI I ASETVE TË PASHITURA..... 26
5.1.4.1	ASETET E LËSHUARA ME QIRA..... 27
5.1.4.2	TRAJTIMI I ASETVE TË UZURPUARA..... 27
5.1.4.3	SHPALOSJE PËR TREPÇËN 29
5.1.4.4	ADMINISTRIMI DIREKT I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE..... 29
5.2	LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE..... 31
5.2.1	OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE..... 31
5.2.2	SHQYRTIMI DHE SHPËRNDARJA E MJETEVE NDAJ KREDITORËVE 32
5.3	SHPËRNDARJA E 20% TË PUNËTORËVE..... 33

5.4	AKTIVITETET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-së	33
5.4.1	BURIMET NJERËZORE	33
5.4.2	DEPARTAMENTI I PROKURIMIT	33
5.4.3	ADMINISTRATA.....	34
5.4.4	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	34
5.4.5	DEPARTAMENTI LIGJOR.....	35
5.5	NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	36
5.6	KOMISIONI PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE - KPS.....	37
6.	REKOMANDIMET PËRMBLEDHËSE PËR TË ARDHMEN	38
7.	RAPORTET FINANCIARE PËRMBLEDHËSE	39
7.1	FINANCIMI I AKTIVITETEVE OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-së.....	39
7.2	PROCESI I FONDEVE NË MIRËBESIM – NDËRMARRJET SHOQËRORE.....	40
8.	RAPORTI I ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT	41
9.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	42
10.	SHTOJCAT E RAPORTIT VJETOR TË AKP-së	43
10.1	Neni 6.1 - Lista e ndërmarrjeve nën Administrim Direkt.....	43
10.2	Neni 9 –Përmbledhja e transaksioneve sipas valëve.....	43
10.3	Lista e NSh-ve në proces të Riorganizimit	43
10.4	Neni 9 – Lista e ndërmarrjeve të likuiduara	43
10.5	Pjesa tekstuale e raportit financiar sipas formatit të Komisionit për buxhet dhe financa të Kuvendit të Kosovës (shtojcë)	43
10.6	Pjesa tabelare e raportit financiar sipas formatit të Komisionit për buxhet dhe financa të Kuvendit të Kosovës (shtojcë)	43
10.7	Pasqyrat financiare të buxhetit vjetor të agjencisë (shtojcë).....	43
10.8	Pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim (shtojcë).....	43
10.9	Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitet 2013, 2014, 2015 (shtojcë).....	43

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Agjencia Kosovare e Privatizimit, themeluar nga Kuvendi i Kosovës, përbën një nga shtyllat themelore të infrastrukturës ekonomike në vend. Mandati i saj është drejtepërdrejtë i lidhur me ndërtimin e një ekonomie bashkëkohore të tregut. Përmes procesit të transformimit të pronës Agjencia përbën një nga hallkat kryesore të ndërtimit dhe fuqizimit të sektorit privat, bartës kryesor i zhvillimit të qëndryeshëm ekonomik.

Pas emërimit të Bordit të ri të Drejtorëve në dhjetor të vitit 2015, si dhe përzgjedhjes të Menaxhmentit, Agjencia ka arritur që përmes rishikimit dhe plotësimit të infrastrukturës ligjore, si dhe masave të tjera, të krijojë dhe implementojë strategji nëpërmjet të cilave ka arritur të përmbushë objektivat të cilat ndikojnë në përmirësimin e imazhit, transparencës dhe rritjen e efikasitetit të procesit të transformimit të pronës.

Angazhimi në përmbushjen e objektivave ka rezultuar në realizimin e planit të shitjes të aseteve në periudha mujore, shpërndarjen e mjeteve për kreditorët e Ndërmarrjeve Shoqërore dhe shpërndarjen e 20%-it të punëtorëve. Agjencia po ashtu ka arritur të përmirësojë procesin e inkasimit të të hyrave nga qiradhënia e aseteve në administrimin e saj. Për më tepër, Agjencia ka arritur të ngrisë besueshmërinë përmes identifikimit të aseteve të reja dhe lirimit të pronave të uzurpuara shoqërore.

Agjencia falenderon të gjitha institucionet në nivelin lokal dhe qëndror në mbështetjen e dhënë për përmbushjen e objektivave të përbashkëta, duke shpresuar që ky bashkëpunim të vazhdojë dhe të rritet edhe më tepër në të ardhmen. Gjithashtu, i jemi mirënjohës Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për bashkëpunim profesional dhe intensifikimin e trajtimit të lëndëve pranë kësaj gjykate. Për më tepër, jemi të inkurajuar nga korrektësia qëndrimi i investitorëve karshi procesit të shitjeve, si dhe ish-punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore për mirëkuptimin e treguar. Vazhdimi i bashkëpunimi me të gjithë këta aktorë është jetik në përmbjlljen e suksesshme të mandatit të Agjencisë.

Raporti në vijim përmban të gjitha rezultatet, sfidat dhe pengesat, planet e punës për vitin 2016 si dhe rekomandimet për tu adresuar në vitet në vijim. Si Bord, manaxhment, dhe staf i Agjencisë jemi të përkushtuar të vazhdojmë angazhimin maksimal në përmbushjen e objektivave strategjike për përmbjlljen e e suksesshme të punës së Agjencisë në një periudhe optimale.

Sinqerisht,

Petrit Gashi
Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

PËR VËMENDJEN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS:

Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit i plotëson kërkesat ligjore për raportim sipas nenit 20.1 të ligjit të AKP-së.

Raporti është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së dhe dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform nenit 20.1 të ligjit të AKP-së.



1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë kapitull është paraqitur një përmbledhje e shkurtër për periudhën deri më 31 Dhjetor 2016 lidhur me këto fusha:

- Të arriturat kryesore;
- Administrimi dhe Shitja e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Pagesat për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (20%);
- Likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Trepça;
- Aktivitetet operative dhe administrative të AKP-së;
- Përmbledhje lidhur me financat.

1.1. TË ARRITURAT KRYESORE

- Emërimi i Menaxhmentit të AKP-së;
- Aprovimi i strukturës së përgjithshme organizative-riorganizimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Pas një periudhe pothuajse dyvjeçare është filluar me shitjet e aseteve. Strategjia është shumë sfiduese nëpërmjet të cilës është planifikuar që të realizohen shitjet në cikle mujore;
- Aprovimi i shumës prej EUR 17,414,431 lidhur me shpërndarjen e mjeteve ndaj kreditorëve. Ndërsa, pagesat e realizuara deri me 31 dhjetor 2016 janë gjithsej EUR 15,826,886;
- Shpërndarja e 20% për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore në vlerën prej EUR 5,728,413;
- Rritja e efikasitetit në administrimin, kontrollimin dhe monitorimin e NSh-ve, Spin-Offet speciale dhe privatizimeve me kushte;
- Trajtimi i aseteve të uzurpuara apo të shfrytëzuara pa bazë ligjore nga palët e treta;
- Rritja e jashtëzakonshme e inkasimit të qirasë, në vlerën prej EUR 6,137,570;
- Bashkëpunimi me institucionet në nivel qendror dhe lokal.

1.2. SFIDAT DHE PENGESAT

Sa i përket sfidave dhe pengesave, më poshtë kemi paraqitur faktorët e jashtëm të cilat kanë një rol kyç në administrimin më të mirë të aseteve, shitjen, likuidimin e tyre, dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve operative dhe administrative. Faktorët që kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në periudhat pasuese janë paraqitur si më poshtë:

- **Kuvendi i Kosovës** – Luan një rol kyç në proceset e AKP-së.
 - Kuvendi i Kosovës emëron anëtarët e Bordit të AKP-së. Mandati i anëtarëve të Bordit përfundon në Dhjetor 2017, përveç Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit që kanë mandat deri në Dhjetor 2018. Çdo vonesë e mundshme në emërimin e anëtarëve të Bordit do të shkaktoj vonesa në procesin e shitjes, shpërndarjen e 20% të punëtorëve dhe procesin e likuidimit të NSh-ve;
 - trajtimin e tokave bujqësore apo strategji që trajtojnë asetet në interes të Republikës së Kosovës;
 - Amandamentimin/ndryshimin sa i përket financimit të aktiviteteve të AKP-së. AKP për buxhetin e vitit 2018 nga gjysmë vjetori i dytë e tutje nuk do të ketë mjete në dispozicion për mbulim të shpenzimeve për zhvillim e aktiviteteve operative me normën 5% sipas nenit 21 të ligjit të AKP-së.
- **Gjykatat** – Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe Gjykatat Themelore kanë kapacitete të limituara sa i përket shqyrtimit të lëndëve për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Varësisht nga kompleksiteti i rasteve, shqyrtimi dhe vendimi përfundimtar mund të merr shumë kohë (vite). P.sh. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka caktuar Masë të Përkohshme ndaj një aseti i cili ka qenë në valën 37 në vitin 2009. Nga viti 2009, kontesti gjyqësor ende nuk është zgjidhur. Të gjitha proceset (administrimi, shitja

dhe likuidimi) lidhen me Gjykatat. Janë mbi 30,000 raste gjyqësore që duhet trajtuar në instanca të ndryshme, prej të cilave rreth 23,000 janë në Dhomën e Posacme të Gjykatës Supreme, ndërsa rreth 7,000 janë në gjykatat e rregullta në Republikën e Kosovës;

- **Komunat** – faktorë relevant në përshpejtimin e kohës dhe përgatitjes të aseteve për shitje. P.sh. vonesa në qasjen e dokumenteve kadastrale ose komuna në mënyrë të njëanshme, në emër të saj, ka ndërruar titullarin e pronësisë;
- **Komunat në pjesën veriore të Republikës së Kosovës** – ekziston një numër i konsiderueshëm i aseteve në këtë pjesë, për të cilat ka mungesë të bashkëpunimit me këto komuna, që mund të krijojnë vonesa në realizimin e shitjeve të aseteve;
- **ATK-ja** – Vonesa në dhënien e informacioneve për barrën tatimore dhe vonesa në heqjen e barrës tatimore. Në periudhën 2016 është rritur bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve;
- **Qeveria** – Pagesa e pronave të shpronësuar nga ana e Qeverisë. Janë 699 asete (deri Maj 2016) të cilat janë shpronësuar dhe për të cilat duhet paguar mjetet nga ana e Qeverisë;
- **Qiratë nga Qeveria dhe institucionet relevante** – pronat e shfrytëzuara me qira të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. P.sh. nga përvoja e AKP-së, ka dy vite që institucionet ende nuk kanë bërë ndonjë zgjidhje për zhvendosjen e zyrave të AKP-së. Janë gjithsej 89 asete, të cilat shfrytëzohen nga Qeveria dhe institucionet ndërkombëtare;
- **Ndërtimet joligjore dhe uzurpatorët** – Janë përafërsisht të njohura deri më tani rreth 2,500 raste. Veçanërisht lidhen edhe me Dhomën e Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës (shih më lartë);
- **Ofertat e blerësve** – Mund të ketë asete të cilat nuk janë atraktive për tërheqjen e investitorëve/blerësve, faktor ky i cili ndikon në ri-tenderimin e aseteve për shitje për shkak të mungesës së ofertave;
- **Tjera** – mungesë e dokumentacionit në përcaktimit të statusit të NSh-ve dhe trajtimit të shitjeve të aseteve të tyre.

Të gjithë këta faktorë të shënuar më lartë, ndër vite kanë qenë dhe janë ende sfida dhe pengesa lidhur me procesin e privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Gjithsesi, këto sfida vit pas viti janë bërë më të lehta, kjo për shkak të ngritjes të kapaciteteve ndër institucionale, por ka shumë punë për të bërë në nivel qendror dhe lokal, sidomos në shqyrtimin e lëndëve nga Dhoma e Posacme e Kosovës dhe komunave, të cilat janë faktorë kyç në përshpejtimin e proceseve.


Të gjitha këto janë faktorë kyç për planin e punës 2017 e cila është sfiduese. Më poshtë është një përmbledhje lidhur me planin e punës për vitin 2017:

- **Shitja** – AKP-ja ka planifikuar dhe ka filluar së zbatuari strategjinë e saj, nga tremujori i fundit të 2016-së, që të realizojë shitjen e aseteve në periudha mujore. Ky proces është tejet kompleks dhe ndërlidhet me të gjithë faktorët e sipërshënuar. Asete të pashitura deri në periudhën raportuese janë gjithsej 1,867;
- Trajtimi i aseteve jashtë Kosovës – asete që duhet trajtuar të cilat gjenden jashtë Kosovës janë 162;
- Shpërndarja e 20% të punëtorëve;
- Shpërndarja e mjeteve ndaj kreditorëve;
- Vendosja e të gjitha ndërmarrjeve të mbetura në likuidim;
- Implementimi i procesit të Riorganizimit të AKP-së;
- Trajtimi i Llogarive të Arkëtueshme të qirave/ndëshkimeve financiare për “Spin Off-et speciale”;
- Proces i monitorimit të shitjeve me “Spin Off Special” dhe me “Kushte të Veçanta”;
- Trajtimi i ndërtimeve joligjore.

Pa realizimin e planit të punës të paraqitur si më lartë, AKP-ja nuk mund të përfundojë misionin e saj të përcaktuar sipas Ligjit. Andaj është e rëndësishë jetike që:

- Institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të përgatisin strategjinë përkatëse në përshpejtimin e shqyrtimit të lëndëve gjyqësore nga Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme dhe të lëndëve në Gjykatat Themelore;

- Në koordinim me Qeverinë dhe organet komunale të përgatitet një strategji e veçantë për trajtimin e ndërtimeve joligjore në pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Komunat, të jenë më fleksibile dhe bashkëpunuese lidhur me kërkesat e AKP-së. Në rast të mungesës të mosbashkëpunimit, një mekanizëm rregullues do të ishte nxjerrja e një rezolute nga Kuvendi që obligon komunat të bashkëpunojnë me të gjitha çështjet të tilla si: ofrimin e dokumenteve kadastrale, rregullimin e statusit të pronësisë dhe bashkëpunimin e ngushtë lidhur me trajtimin e aseteve në interes publik;
- Qeveria të realizojë pagesat për pronat e shpronësuara dhe të gjejë lokacionet e reja për institucionet vendore dhe ndërkombëtare të cilat janë duke i shfrytëzuar aktualisht asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore.



2. KORNIZA LIGJORE

1. Ligji i AKP-së nr. 04/L-034 dhe ndryshuar me Ligjin nr. 080 të datës 24 Dhjetor 2015;
2. Akti themelues i AKP-së;
3. Statuti i Bordit të Drejtorëve të AKP-së;
4. Politikat Operacionale të AKP-së dhe Aneksat e saj:
 - 4.1. Rregullat e tenderit në privatizim;
 - 4.2. Rregullat e tenderit në likuidim;
 - 4.3. Rregullat e Procedurës të Komisionit për shqyrtim të ankesave ndaj listave të punëtorëve.
5. Procedurat Financiare të AKP-së;
6. Udhëzuesi i Likuidimit me Aneksat e tij:
 - 6.1. Lista me Format/Formularët për Likuidim;
 - 6.2. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave të Caktuara të Punës (marrëdhënia e punës);
 - 6.3. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore (të NSH-së) gjatë periudhës së transformimit;
 - 6.4. Aneksi i Udhëzuesit të Likuidimit për Procedimin e Kërkesave Kolektive në procedurën e likuidimit.
7. Rregullorja për kompensimin e anëtarëve të Bordit;
8. Udhëzuesi për Procedurën e shpërndarjes së të hyrave nga 20%;
9. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore;
10. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim;
11. Procedurat e brendshme të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;
12. Procedurat Bankare të AKP-së;
13. Rregullorja Nr. 01/2012 mbi Ruajtjen e Integritetit të AKP-së;
14. Rregullorja për përdorimin të vulave zyrtare të Agjencisë dhe Autorizimit për lejimin e përdorimit të vulave zyrtare të Agjencisë nga Autoriteti i Likuidimit;
15. Statuti Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB);
16. Rregullorja për përcaktimin e mënyrave të kompensimit për menaxherët si dhe punëtorët tjerë të NSH-ve nën mandatin e Njesisë së Administrimit Direkt;
17. Rregullorja për procedurën e rekrutimit të Drejtorit Menaxhues, dy Zëvendës Drejtorëve Menaxhues dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;
18. Rregullorja për Zhvillimin e punonjësve dhe ngritje të kapaciteteve;
19. Rregullorja për procedurat dhe masat e nevojshme për sigurinë e personave që hyjnë dhe dalin në AKP;
20. Rregullorja e brendshme e Agjencisë për Vlerësim të Performancës së Menaxhmentit;
21. Politikat mbi pagesën e pjesshme për punëtorët;
22. Udhëzuesi i prokurimit për ndërmarrjen Trepça nën Administrimin e AKP-së;
23. Rregullorja e Shitjes së Ndërmarrjes Trepça në Administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
24. Rregullorja e Pagave për nëpunësit e Agjencisë;
25. Rregullorja e Personelit për nëpunësit e Agjencisë;
26. Rregullorja e Përdorimit të Veturave zyrtare të Agjencisë;
27. Rregullat e Procedurës për Shitjen e Banesave të NSH-ve;
28. Rregullat e Punës të Komisionit për ndërtimeve jo ligjore në pronat e ndërmarrjeve shoqërore;
29. Rregullorja për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
30. Rregullorja për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim;
31. Rregullat e Procedurës së Komisionit për shqyrtimin e listave fillestare të punëtorëve (KShLFP);
32. Vendimi për lirim të aseteve të uzurpuara të NSH-ve dhe Udhëzuesi për lirim të aseteve nga uzurpatorët;
33. Rregullorja për Procedurat e Njesisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes gjatë Monitorimit të Ndërmarrjeve të Privatizuara me Spin Off Special dhe me Kushte;
34. Rregullorja mbi Procedurat e trajtimit të llogarive të arkëtueshme;

35. Udhëzuesi për Menaxhimin e Performancës së Personelit;
36. Udhëzuesi për Teknologjinë Informative;
37. Statuti i Komitetit të Auditimit;
38. Rregullorja e punës së Njësish të Administrimit Direkt;
39. Rregullorja e re e Qiradhënies së aseteve të NSH-ve;
40. Udhëzuesi për Lirimin e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit e Paligjshëm;
41. Rregullorja për monitorim të Trepçës;
42. Procedurat e Shitjes dhe Rregullat e Përgjithshme të Tenderit.

2.1. RREGULLORET DHE PROCEDURAT E APROVUARA GJATË VITIT 2016 NGA AGJENCIA

Rregulloret dhe procedurat e aprovuara gjatë periudhës raportuese janë:

1. Amadamentimi i Rregullores mbi procedurat e rekrutimit, nominimit dhe emërimit të Menaxhmentit dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve të AKP-së – miratuar më 28 Janar/02 Shkurt 2016.
2. Statuti i Komitetit të Auditimit – miratuar më 31 Mars/07 Prill 2016.
3. Amadamentimi i Politikave Operacionale të Agjencisë - Amadamentohenenet 7.12 dhe 7.14.1 të Politikave Operacionale të Agjencisë – miratuar më 31 Mars/07 Prill 2016.
4. Rregullorja e punës së Njësish të Administrimit Direkt – miratuar më 31 Mars/07 Prill 2016.
5. Amadamentimi i Rregullores së kompensimit të Bordit – miratuar më 31 Mars/07 Prill 2016.
6. Rregullorja e re e Qiradhënies së aseteve të NSH-ve – miratuar më 28 Prill 2016.
7. Udhëzuesi për Lirimin e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit e Paligjshëm – miratuar më 28 Prill 2016.
8. Rregullorja për monitorim të Trepçës – 21 Korrik 2016.
9. Amadamentim - Rregullore për Qiradhënie të Ndërmarrjeve Shoqërore – 26 Gusht 2016.
10. Shfuqizimi i Aneksit III të Udhëzuesit të Likuidimit - Trajtimi i Kërkesave Kolektive të Kreditorëve – 21 Shtator 2016.
11. Plotësim/Ndryshimi 3 i Politikave Operacionale (nenet 6.4 dhe 7.9) – 21 Shtator 2016.
12. Procedurat e Shitjes dhe Rregullat e Përgjithshme të Tenderit – 21 Shtator 2016.
13. Amadamentim - Rregullore për Qiradhënie të Ndërmarrjeve Shoqërore – 13 Tetor 2016.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1. MISIONI DHE VIZIONI

3.1.1 MISIONI

Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Për realizimin e këtij misioni, Agjencia mban dhe administron secilën ndërmarrje (nën mandatin e saj) në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, si dhe shet ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin.

3.1.2 VIZIONI

Agjencia është e vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet pozitive për ekonominë si dhe nxitjen e investimeve në Ndërmarrjet Shoqërore, përmes autorizimeve të gjera publike administrative që i ka mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose asetëve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

3.2. KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me Ligjin nr. 04/L-034, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në Korrik të vitit 2008 si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit i raporton Kuvendit të Kosovës në baza vjetore.

Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues, Zëvendës Drejtori Menaxhues-Shitje dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues-Likuidim.

Brenda Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë edhe departamentet si në vijim:

- Departamenti i Shitjes;
- Departamenti për Koordinim të Likuidimit;
- Departamenti i Koordinimit Rajonal;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit;
- Departamenti i Administratës; dhe
- Departamenti i Prokurimit.

Agjencia e ka të themeluar edhe Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe Sekretarinë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve. Agjencia ka zyrën qendrore në Prishtinë si dhe ka pesë (5) zyra rajonale (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan) dhe një (1) zyrë satelitore (Shtërpce).

Struktura organizative (në shtojcë) e aplikueshme deri më 31 Dhjetor 2016 është paraqitur në fund të raportit, ndërsa struktura e re e aprovuar nga Bordi ka hyrë në fuqi më 1 Janar 2017.

4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA

Ndërmarrjet Shoqërore kanë funksionuar në sektorë të ndryshëm duke përfshirë përpunimin e metalit, plastikës, letrës, hotelieri, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, material ndërtimor, ndërtimtari, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me shumicë dhe pakicë.

NSH-të zënë rreth 90% të industrisë dhe minierave në Kosovës, 50% të hapësirës për shitje komerciale me pakicë dhe më pak se 20% të tokës bujqësore duke përfshirë tërë tokën komerciale bujqësore dhe shumicën e pjesës malore të Kosovës.

Shumica e pronës industriale e Kosovës, toka bujqësore, pyje, tokë urbane komerciale dhe pronë komerciale janë pronë e NSH-së. Privatizimi i këtyre aseteve dhe tërheqja e investitorëve të huaj si dhe atyre nga diaspora, rajoni dhe Kosova pritet që të kenë ndikim pozitiv në ekonominë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

AKP-ja deri në datën raportuese ka menaxhuar me 541 Ndërmarrje Shoqërore. Ndërsa, në periudha të ndryshme janë larguar gjithsej 91 NSH nga mandati i AKP-së. Sipas Ligjit dhe me vendim të Bordit të Drejtorëve janë si më poshtë:

PËRSHKRIMI	NUMRI
Trepça	20
Ekonomitë Pyjore	23
Kosovatransat	13
NSH-të që janë hequr me vendime të Bordit*	35
GJITHSEJ	91

* Në Dhjetor 2016, Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme ka vendosur që ndërmarrja "UNIFARM" (në likuidim që nga 16 Qershor 2014 sipas vendimit të Bordit të AKP-së) nuk është në kompetencë administrative të AKP-së. Prandaj, shënimet e mësipërme azhurnohen (largohet nga lista e NSH-ve nën administrim të AKP-së) pasi që në Bordin e AKP-së të merret vendimi formal për ndërprerjen e procesit të likuidimit.

4.1. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve i AKP-së takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej¹ funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas ligjit. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë duke përfshirë një anëtarë të komunitetit jo-shumicë dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mandati i Bordit të Drejtorëve është dyvjeçar për anëtarët e Bordit (deri në Dhjetor 2017), ndërsa për Kryesuesin dhe Zëvendës Kryesuesin është trevjeçar (deri në Dhjetor 2018).

¹ Përbërja, procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve janë të paraqitura në nenin 14 dhe 15 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 12 të Ligjit nr. 05/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034.

Gjatë vitit 2016, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjithsej 15 mbledhje, ku janë marr 154 vendime formale dhe shumë udhëzime për veprim për Menaxhmentin. Më poshtë, në mënyrë përmbledhëse janë të paraqitura aktivitetet e Bordit:

- Emërimin e Zëvendës Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, Drejtorin Menaxhues, Zëvendës Drejtorin Menaxhues-Likuidim dhe Zëvendës Drejtorin Menaxhues - Shitje;
- Themelimin e Komitetit të Auditimit dhe Komisionin për aprovimin e raporteve të kontraktorit - Ofruesin e Shërbimeve Profesionale si pjesë e² Autoritetit të Likuidimit për kontratën deri me 10 Korrik 2016;
- Sa i përket NSH Trepça, Bordi ka ndërmarrë veprimet: themelimin e komisionit për shqyrtimin preliminar të kërkesave ndaj NSH-së; ka aprovuar termat e referencës për studim të fizibilitetit dhe ka udhëzuar Menaxhmentin për shpalljen publike të tenderit për angazhim të Ofruesit të Shërbimeve për këtë studim, i ka aprovuar planin prodhues dhe të prokurimit për vitin 2016; ka aprovuar shitjen e mbetjeve industriale dhe ka shqyrtuar dhe miratuar shitjen e 12000 T pluhur të Pb sipas kërkesës Trepça Veri dhe ka aprovuar Rregulloren për monitorim të NSH-së me 21 Korrik 2016;
- Shpalljen e shitjes së aseteve përmes likuidimit valëve 27, 28 dhe 29. Gjithashtu në këtë periudhë është aprovuar vlera e shitjes të aseteve të valës 27. Janë shpalosur tek nënkapitulli 5.1.1 Shitja e Aseteve;
- Aprovimin e 117 raporteve për shpërndarjen e mjeteve ndaj kërkesave të kreditorëve;
- Aprovimin për shpërndarjen e 20% të punëtorëve, 395 raste për shitjen e së drejtës banesore dhe dhënien me qira të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore – këtu vlen të theksohet aprovimi i vendimit për kërkesën e Ferronikelit për shfrytëzimin e parcelës së NSH MIM Golesh, me të cilin është bërë një hap i rëndësishëm për revitalizimin e ndërmarrjes Ferronikeli;
- Aprovimin e statusit të 21 Ndërmarrjeve Shoqërore, vendosjen nën administrim direkt dhe në likuidim të 13 Ndërmarrjeve Shoqërore. Vlen të theksohet veçanërisht Pallati i Rinisë, Kulturës dhe Sportit i cili është vendosur në likuidim me 28 prill 2016;
- Aprovimin e rregulloreve dhe udhëzuesve të tilla si: amadamentim të rregullave të qiradhënies dhe uzurpimit të aseteve, rregullat e brendshme të njësisë administrimit direkt, aprovim të rregullave të tenderit/procedurave të shitjes dhe të tjera;
- Aprovimin për transferimin e NSH Stacioni i Autobusëve Malishevë në kompetencë të Komunës, shpronësimin e pjesëve të NSH INA, Auto Moto dhe KBI Ereniku sipas vendimit të Qeverisë me interes publik, si dhe ka liruar NSH Lotaria e Kosovës nga administrimi i Agjencisë;
- Aprovimin e buxhetit të vitit 2016 dhe 2017 për AKP-në;
- Aprovimin e raporteve vjetore 2014 dhe 2015 dhe planet e punës 2016 dhe 2017 të AKP-së;
- Aprovimin e planit për ristrukturim të Agjencisë.

² Autoriteti i Likuidimit do të thotë Agjencia apo personi(at) i autorizuar nga Agjencia dhe i caktuar nga Bordi që të veprojë si Autoritet i Likuidimit i një Ndërmarrje në procedurë të likuidimit. Gjithashtu shih nenin 13 të shtojcës të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

5.1. SHITJA DHE ADMINISTRIMI I ASETEVE

Agjencia sipas mandatit të saj, nga viti 2002 deri më 31 Dhjetor 2016 ka administruar dhe kërkon të administroj (duke përfshirë asetet jashtë territorit të Kosovës) me gjithsej 3,324 aset të Ndërmarrjeve Shoqërore. Ky numër paraqet numrin e të gjitha aseteve të shitura dhe të pashitura të cilat janë identifikuar nga ana e Agjencisë brenda Republikës së Kosovës dhe jashtë Republikës së Kosovës. Më poshtë janë paraqitur të dhënat në mënyrë tabelare të aseteve sipas territorit apo llojit të tyre nga viti 2002 – 2016.

RAPORTI PËRMBLEDHËS I ASETEVE TË PASHITURA BRENDA KOSOVËS

	1	2	3	4=sum(1:3)	=4/total
Rajoni	Asetet tjera	Tokat bujqësore	Tokat tjera	Gjithsej	
Prishtina	302	127	57	486	26%
Peja	274	179	106	559	30%
Prizren	114	159	11	284	15%
Gjilan	66	35	100	201	11%
Mitrovica	193	117	27	337	18%
Gjithsej	949	617	301	1867	100%

Asetet jashtë Republikës së Kosovës:

Regjioni	Asetet tjera	Tokat bujqësore	Tokat tjera	gjithsej
Bosne	14	-	1	15
Kroaci	5	-	-	5
Mal të Zi	34	-	1	35
Maqedoni	6	-	1	7
Slloveni	1	-	-	1
Serbi	99	-	-	99
Gjithsej	159	-	3	162

Administrimi i aseteve dhe përgatitja e tyre për shitje është proces tejet kompleks dhe i ndërlidhur me faktorë të jashtëm të cilat janë jashtë menaxhimit të AKP-së. Të gjithë faktorët e jashtëm janë paraqitur tek nënkapitulli “Sfidat dhe Pengesat”.

Më poshtë janë paraqitur disa nga veprimet e AKP-së, ndër vite lidhur me trajtimin e aseteve:

- Identifikimin e tyre dhe vendosjen nën administrim;
- Shitjen e aseteve;

- Dhënie me qira;
- Zgjidhjen e kontesteve gjyqësore lidhur me pronësinë;
- Trajtimin e aseteve të uzurpuara;
- Shpronësimin e tyre për interes publik (me ligj dhe me vendim të Bordit të Drejtorëve);
- Trajtimin e ndërtimeve ilegale;
- Shitjen e së drejtës banesore dhe të tjera.

Veprimet e marra nga Menaxhmenti lidhur me administrimin e aseteve të cilët kanë qenë kyç në rritjen e progresit dhe uljen e kostove janë si më poshtë:

1. Vendimi për lirim të pronave të uzurpuara në Nëntor 2014. Ky vendim ka mundësuar që asetet e AKP-së të jenë më shpejt nën administrim të saj e cila ka ndikuar në rritjen e inkasimeve të qirave. Ky vendim poashtu është në ndërlidhje edhe me vendimin që asnjë aset i uzurpuar të mos vendoset për shitje;
2. Strategjia për shitjen e aseteve – shpalljen e tyre në periudha mujore. Ky objektiv është sfidues dhe kërkon koordinim në nivelin lokal dhe qendror për arritjen e këtij objekti. Gjithashtu, edhe pse është planifikuar shitja në periudha mujore, AKP-ja do të ruaj balancin ndërmjet raportit të realizimit të shitjeve dhe ruajtjes dhe rritjes së vlerës së aseteve të NSh-ve. Ruajta dhe rritja e vlerës së aseteve është një ndër objektivat kryesore dhe kjo gjithashtu varet nga fuqia blerëse sipas ofertave të dorëzuara.

Për të gjitha këto pika rreth administrimit të aseteve (shitja, qiratë e të tjera) janë paraqitur në nënkapitujt vijues.

5.1.1 SHITJA E ASETEVE

Agjencia Kosovare e Privatizimit sipas mandatit të saj realizon shitjen e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore. Realizimi i shitjeve të Ndërmarrjeve Shoqërore është bërë nëpërmjet dy metodave:

- Shitja e Ndërmarrjeve të Reja, të themeluaranga asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore apo siç njihet ndryshe “Spin Off” apo valët e privatizimit. Gjithashtu janë bartur një numër i kufizuar i detyrimeve të Ndërmarrjeve Shoqërore tek këto Ndërmarrje të Reja të themeluara. Nga shitja me “Spin Off” që janë shitur, mënyra e shitjes është realizuar sipas politikave të më poshtme:
 - “Spin Off” të rregullt – oferta më e lartë;
 - “Spin Off special” – oferta më e mirë, vlera e investimeve dhe numrin e të punësuarve;
 - “Spin Off” me kushte të veçanta – vazhdimin e aktivitetit të Ndërmarrjes;
 - Negociatave direkte.
- Pas hyrjes të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim, realizohen shitjet e aseteve të mbetura. Ndryshe njihet edhe si shitja e aseteve përmes likuidimit (ShAL).

Pas shpërndarjes të 20% të punëtorëve dhe 5% të tarifës administrative për AKP-në, nga shitja e realizuar nëpërmjet dy metodave të sipërsënuara, mjetet e grumbulluara transferohen në llogaritë përkatëse të NSh-ve në likuidim, duke përfshirë edhe të hyra të tjera e që janë pasuri e likuidimit, nga e cila potencialisht do të realizohen pagesat me prioritet sipas kornizës ligjore të nenit 40 të shtojcës të Ligjit nr. 04/L-034.

Ky nen përfshinë pagesat e vendimeve të gjykatave, koston e likuidimit dhe mjetet e mbetura që shpërndahen tek kreditorët e vlefshëm. Nga të dyja metodat e shitjes të paraqitura më lartë, gjithsej të hyrat e realizuara nga shitja janë **EUR 661,310,024**, me gjithsej 1,295 asete të shitura dhe atë:

Lloji i shitjes	Asetet tjera	Tokat bujqësore	Tokat tjera	Gjithsej	Pjesëmarrja e totalit %	Numri i aseteve
Spin Off të rregullt	336,664,717	78,701,400	10,337,744	425,703,861	64.4%	720
Spin Off Special	84,459,696	8,478,899	0	92,938,595	14.1%	26
Spin Off me Kushte	18,531,056	0	6,665,417	25,196,473	3.8%	18
*Negociim direkt	30,464,500	0	1,500	30,466,000	4.6%	4
Asete përmes likuidimit	69,412,171	12,567,611	5,025,313	87,005,095	13.2%	527
GJITHSEJ	539,532,140	99,747,910	22,029,974	661,310,024	100%	1,295

* Tek pjesa me negociim direkt, pjesa e aseteve tjera është realizuar shitja e fabrikës "Sharrcem".

5.1.1.1 SHITJA E ASETEVE 2016 DHE OBJEKTIVAT

Gjatë vitit 2016 është realizuar nënshkrimi i dy kontratave për shitjet të cilat janë bërë nga vitet paraprake dhe atë:

- Kontratës në vlerën prej EUR 951,000 për Ndërmarrja e Re "Ereniku Industria Depo" në Prishtinë pas lirimit nga masa e përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës. Kjo shitje ka qenë e tenderuar në vitin 2010 përmes metodës të Spin Off-it të rregullt në valën 59 të shitjes;
- Kontratës në vlerën prej EUR 135,555 për asetin Lux në Mitrovicë. Kjo shitje ka qenë në vitin 2014, mirëpo në mungesë të Bordit (periudha Tetor 2014 – Dhjetor 2015), kontrata ka ngelur pa u nënshkruar.

Bordi i Drejtorëve së bashku me menaxhmentin ka aprovuar strategjinë për shpalljen e shitjeve të aseteve në periudha mujore dhe njëkohësisht, përveç shpalljeve do të tentohet që të realizohen shitjet (nënshkrimi i kontratave). Një ndër objektivat kryesore të AKP-së është rritja dhe ruajtja e vlerës të aseteve të NSh-ve dhe se AKP-ja do të ruaj raportin e realizimit të shitjeve me vlerën e synuar. Pra strategjia është sfiduese e cila kërkon ruajtjen e këtij bilanci dhe e cila kryesisht varet nga faktorët e jashtëm dhe situatat e mëposhtëm:

- **Fuqia blerëse** – absorbimin e ofertave kundrejt vëllimit të shitjeve;
- **Menaxhimi efikas dhe efektiv të aseteve** – p.sh. afatet kohore të marrëveshjeve të qirave dhe vënia në dispozicion për shitje tek blerësit;
- Koordinim me institucionet relevante të tilla si: objektet e shfrytëzuara nga institucionet, ngritjen e kapaciteteve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, komunat, bashkëpunimi me ATK-në rreth barrës tatimore etj.;
- Lirimin e aseteve nga uzurpatorët;
- Trajtimin e ndërtimeve ilegale të aseteve të NSh-ve;
- Kompletimin e dokumentacionit (regjistrave kadastral).

Duke filluar nga tremujori i fundit i vitit 2016, Bordi ka shpallur valët për shitjen e aseteve përmes likuidimit. Gjithsej janë 161 asete dhe atë:

1. Vala 27 – Gjithsej 53 asete;
2. Vala 28 – Gjithsej 57 asete;
3. Vala 29 – Gjithsej 51 asete.

Për valët 27 është mbajtur dita e ofertimit dhe rezultatet deri më 31 Dhjetor 2016 janë si më poshtë:

Shitja përmes Likuidimit	Nr. i Aseteve	Nr. i Ofertave të Pranuara	Gjithsej Vlera e Ofertave Fituese	Tërheqjet, Anulimet	Gjithsej Vlera	Nr. i Aseteve të anuluar nga BiD, tërheqjet	Kontratat e realizuara	Shitjet e parealizuara – në proces
27	53	216	5,840,724	0.00	5,840,724	0	Në proces	0

* tabela e sipër shënuar paraqet rezultatet sipas prerjes të periudhës 31 Dhjetor 2016. Këto rezultate mund të ndryshojnë në periudhat pasuese, pasi që mund të ketë tërheqje apo anulim të tenderit nga Bordi i Drejtorëve apo faktorë të tjerë që janë jashtë administrimit të AKP-së.

Dita e ofertimit për valën 28 dhe 29 është mbajtur në periudhën pasuese në 2017.

Në qoftë se marrim parasysh se realizohen shitjet për këto tri valë në total prej 161 asetëve dhe duke marrë si indikatorë shitjen e asetëve më të mirë të realizuar ndonjëherë prej 163 asetëve (viti 2012) atëherë niveli i performancës është i barabartë me performancën më të mirë të realizuar ndonjëherë në vitin 2012.

AKP-ja ka planifikuar që realizimi i shitjes të asetëve të NSh-ve të përfundojë brenda periudhës katërvjeçare. Implementimi i këtij plani ka filluar qysh në tremujorin e fundit të 2016-së. Aktualisht asetë të pashitura janë gjithsej 1,867 apo rreth 59.72% të asetëve në total prej 3,162. Asetet e pashitura janë paraqitur në nënkapitullin “Administrimi i Asetëve”.

MARKETINGU DHE AKTIVITETET PROMOVUESE

Si vazhdimësi e projektit të iniciuar në fund të vitit 2015, janë ndërmarrë aktivitete në drejtim të identifikimit të një numri të konsiderueshëm të ndërmarrjeve që janë funksionalizuar dhe kanë ndikim pozitiv në aspektin e punësimit, investimeve dhe prodhimit, në periudhën e post-privatizimit. Në këtë drejtim, është vazhduar me realizimin e vizitave dhe plotësimin e pyetësorëve për identifikimin e ndërmarrjeve potencialisht të suksesshme. Raporti përfundimtar pritet të finalizohet në fillim të vitit 2017.

Aktivitete promovuese

Në mbështetje të strategjisë për promovimin dhe tërheqjen e investorëve, Njësia e Marketingut ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme marketingu:

1. Realizimi i materialeve të shtypura promovuese - përfshirë konceptimin, dizajnin dhe mbikëqyrjen e shtypit.
2. Gjatë vitit 2016 përfaqësues të Njesisë kanë marrë pjesë në ngjarje të ndryshme, me qëllim të promovimit të procesit të privatizimit në përgjithësi si dhe projekteve specifike në veçanti, përfshirë:
 - Panairin Ndërkombëtar “Prishtina 2016”, ku janë prezantuar mundësitë investive dhe të arriturat e deritanishme të Agjencisë.
 - Konferencën ndërkombëtare për investorë, pjesë e “Hardh Fest” të mbajtur në Rahovec.
3. Konceptimi, planifikimi dhe implementimi i fushatave promovuese, përfshirë realizimin e reklamave televizive dhe përzgjedhjen e medimeve relevante. Fushatat e implementuara janë:
 - Lansimi i aplikacionit për statusin e kërkesave të kreditorëve;
 - Rifillimi i shitjeve të asetëve.

4. Dizajni dhe realizimi i videove të shkurtëra promovuese për postim në llogaritë e AKP-së në rrjetet sociale.

Shpallja e Shitjes së Aseteve 27 dhe Shitjes së Aseteve 28

Në kuadër të aktiviteteve mbështetëse për shpalljen e shitjeve janë ndërmarrë veprimet relevante në drejtim të implementimit të strategjisë së marketingut masiv në kombinim me aktivitete të marketingut direkt. Aktivitetet e ndërmarra:

1. Publikimi i shpalljeve të Shitjeve është bërë në të gjitha gazetat lokale, ueb faqen e AKP-së dhe përmes transmetimit të TV Reklamës në tri Televizionet Kombëtare RTK, RTV 21, KTV. Njoftime të shkurtëra gjithashtu janë publikuar rreth afateve për parakualifikim dhe datave për dorëzimin dhe hapjen e tenderëve.
2. Investitorët e parakualifikuar janë njoftuar mbi shpalljen e Valëve dhe Shitjeve të Aseteve përmes postës elektronike dhe SMS shërbimit.
3. Informatat rreth shpalljes së Shitjeve janë bërë edhe në mediet elektronike, me ç'rast baneri me njoftimin e shpalljes është publikuar në tetë (8) portalet e kontraktuara nga AKP-ja.
4. Publikimi i shpalljeve përmes radio reklamave, ku reklama në gjuhën shqipe është transmetuar në 3 radio stacionet nacionale (Radio Dukagjini, Radio Kosova dhe Radio 21) dhe në radio stacionet lokale përmes Rrjetit të Radiove Lokale, në rajonet ku ka pasur më shumë prona të përfshira në shitje. Gjithashtu, reklama në gjuhën serbe është transmetuar në Radio Kontakt Plus, që operon në Mitrovicën Veriore dhe Radio Omega në Dragash, për shkak të asetëve që janë në shitje në këto lokacione.

Marrëdhënie me Investitorë

1. Janë ofruar këshillime rreth procedurave të parakualifikimit dhe është bërë pranimi i kërkesave për regjistrim. Deri më 30 dhjetor 2016 në total janë pranuar **217 kërkesa** për regjistrim për Shitjen e Aseteve 27 dhe Shitjen e Aseteve 28.
2. Pas shqyrtimit të kërkesave për regjistrim, Komisioni për Vlerësimin e Kualifikueshmërisë (KVROK) nga **186 kërkesa** ka aprovuar **170 regjistrime si ofertues të kualifikuar**, për të cilët janë shtypur certifikatat e parakualifikimit që u janë shpërndarë investitorëve për pjesëmarrje në Shitjen e Aseteve 27.
3. Rreth nivelit të interesimit për asetet e tenderuara, me ç'rast palët kanë nënshkruar marrëveshjen për ruajtjen e sekretit afarist, kanë pranuar dosjet e tenderit dhe sipas kërkesës është bërë edhe koordinimi për vizita në terren:
 - **Shitja e Aseteve – 27:** janë dhënë **943 dosje** të tenderit tek **157 persona** fizik/juridik;
 - **Shitja e Aseteve – 28:** deri më 30 dhjetor 2016, janë dhënë **71 dosje** të tenderit tek **29 persona** fizik/juridik.
4. Janë ofruar këshillime rreth procedurave të shitjes dhe udhëzime rreth përgatitjes së ofertave.

Ueb Faqja

Në shërbim të ngritjes së transparencës dhe nivelit të informimit të drejtë dhe në kohë reale për të gjitha palët e interesit, ueb faqja e AKP-së popullohet me të gjitha informatat publike në lidhje me procesin e privatizimit.

5.1.1.2 MASAT E PËRKOHSHME NGA DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

Për katër (4) shitje të organizuara kemi ndalesa nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe derisa nuk hiqen këto ndalesa nuk mund të vazhdohet me shitjen. Ndaletat vlejné për ndërmarrjet/asetet në vijim:

1. Ndërmarrja e Re “AGROKOSOVA – Zyret Sh.P.K.” – Vala 37;
2. Ndërmarrja e Re “Punëtorja Iliria Sh.P.K.” – Vala 43.
3. Aseti në likuidim “Farmakos Blue Factory” Prizren;
4. Njësia nr. 12: Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme i - SHAL 20;

Nga 740 raste të dorëzuara në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për masa të përkohshme ndaj veprimeve të AKP-së, përgjatë periudhës së procesit të privatizimit dhe likuidimit nga qershor 2002 e deri më 31 dhjetor 2015 janë këto të dhëna:

- 93 masa të përkohshme janë ende në fuqi;
- 195 kërkesa për masë të përkohshme janë ende në shqyrtim e sipër nga Gjykata; dhe
- 452 kërkesa janë refuzuar nga Gjykata.

5.1.1.3 SPIN OFF-ET SPECIALE DHE ME KUSHTE TË VEÇANTA

SPIN OFF-ET SPECIALE

Që nga fillimi i procesit të privatizimit e deri më tani janë privatizuar 26 ndërmarrje përmes metodës së “Spin Off-it Special”. Nga këto ndërmarrje 20 janë liruar nga marrëveshja e zotimeve, 4 ndërmarrje për shkak të mospërbushjes së zotimeve për investime dhe punësim me vendim të Bordit të AKP-së iu janë marrë aksionet kurse dy ndërmarrje të privatizuara me metodën e “Spin Off-ve Speciale” janë monitoruar nga Njësia për Kontrollë e Mbikëqyrje gjatë periudhës e këto janë “IDGJ Tobacco” - Gjilan dhe “NBI Suhareka” (Agrokosova Holding) - Suharekë. Për këto dy Ndërmarrje të Reja, më poshtë janë shpalosur aktivitetet në mënyrë detaje.

Për të gjitha Ndërmarrjet e Reja të shitura me “Spin Off Special” janë paraqitur vlera e shitjes, vlera e investimeve, numri i të punësuarve dhe përmbushja/mospërbushja e zotimeve të bëra.

TABELA E NDËRMARRJEVE TË REJA TË SHITURA SIPAS MENYRËS ME “SPIN OFF SPECIAL”

Nr.	Ndërmarrjet e Reja me Spin Off Special dhe kushte të veçanta	Vlera e shitjes	Investimet e raportuara	Numrin e të punësuarve	Kushtet e plotësuara PO/JO	Viti i lirim për zotimet e bëra	Komente
1	Përparimi	1,198,749.00	2,001,530.75	154	PO	23/03/2007	Liruar nga KTA
2	Sunflower Oil	460,000.00	0.00	169	PO	25/06/2008	Liruar nga KTA
3	Lamkos Steel LLC	4,151,000.00	1,666,264.86	500	JO	Nuk janë përmbushur kushtet. Janë tërhequr aksionet nga AKP	
4	Xim Strezovci (XIM)	730,000.00	138,073.41	11	JO	Nuk janë përmbushur kushtet. Janë tërhequr aksionet nga AKP	
5	Grand Hotel	8,160,000.00	1,987,060.15	540	JO	Nuk janë përmbushur kushtet. Janë tërhequr aksionet nga AKP	
6	Magnezite Mine Goleshi LLC (MIM)	810,000.00	326,978.00	58	JO	Nuk janë përmbushur kushtet. Janë tërhequr aksionet nga AKP	
7	Banja e Kllokotit	1,805,550.00	3,252,000.84	201	PO	31/07/2009	Liruar nga PAK
8	Peja Brewery	11,130,000.00	15,234,098.28	612	PO	31/07/2009	Liruar nga PAK
9	IMN Brick Factory	5,689,432.00	0.00	667	PO	31/07/2009	Liruar nga PAK
10	Feronikeli	30,554,371.00	59,677,464.00	1,043	PO	31/07/2009	Liruar nga PAK
11	Rahoveci Winery	4,302,900.00	4,772,692.00	252	PO	29/04/2010	Liruar nga PAK
12	Ballkan L.L.C	1,400,000.00	6,115,784.03	375	PO	16/06/2010	Liruar nga PAK
13	7 Korriku	201,999.00	n/a	n/a	PO	04.03.2010	Liruar nga PAK
14	Mulliri Fabrika e Bukës	568,750.00	5,554,287.97	83	PO	28/10/2010	Liruar nga PAK
15	Tullorja Kamenicë	160,189.00	n/a	81	PO	28/10/2010	Liruar nga PAK
16	IMK Pipe Factory	3,657,000.00	13,400,316.04	365	PO	16/12/2010	Liruar nga PAK
17	Shpk"M&SILLOSI"	1,000,000.00	19,328,797.00	370	PO	02/11/2011	Liruar nga PAK
18	Modeli	630,000.00	2,224,142.44	171	PO	21/07/2011	Liruar nga PAK
19	FlourMill Fushë Kosova	2,505,555.00	14,362,698.00	260	PO	21/01/2010	Liruar nga PAK
20	KosovaTex	3,112,001.00	4,341,099.68	200	PO	30/11/2011	Liruar nga PAK
21	FAN	2,310,000.00	1,789,565.31	236	PO	20/01/2012	Liruar nga PAK
22	Hotel Iliria	1,610,000.00	5,761,196.56	256	PO	20/12/2010	Liruar nga PAK
23	Minex	103,000.00	n/a	145	PO	22/03/2013	Liruar nga PAK
24	Jugoterm	1,112,100.00	2,478,860.22	282	PO	31/08/2014	Liruar nga PAK
25	IDGJ Tobacco	1,400,000.00	3,247,245.70	90	Në monitorim, ende nuk janë përmbushur kushtet – Shih shpalosjen e mëposhtme		
26	NBI Suhareka/Agrokosova Holding	4,175,999.00	7,045,713.00	84	Në monitorim, ende nuk janë përmbushur kushtet – Shih shpalosjen e mëposhtme		
		92,938,595	174,705,868	7,205			

Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco”

Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco” Shpk, është privatizuar përmes metodës së Spin Off-it Special në valën e 11-të shitjes, ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të parapara në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 13 Gusht 2008.

Me datë 27 Mars 2012 është aprovuar Marrëveshja për Përtëritje (Novacion) e Marrëveshjes së Zotimeve lidhur me Ndërmarrjen e Re “IDGJ Tobacco” Shpk nga Grupi punues i AKP-së. Kjo Marrëveshje është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 29 mars 2012, si dhe është nënshkruar nga të gjitha palët e përfshira në këtë Marrëveshje me datën 12 prill 2012, ku kusht për këtë Ndërmarrje gjatë periudhës dy vjeçare është të realizoj investime prej EUR 4,000,000.00 dhe të plotësojë numrin e punëtorëve prej 14 punëtorë në muajin e parë, 35 punëtorë në muajin e dytë, 55 punëtorë në muajin e tretë dhe 90 punëtorë nga muaji i katërt e deri në përfundim të Marrëveshjes së Novacionit. Periudha e raportimit për këtë ndërmarrje ka përfunduar me 10 shtator 2014.

Në mënyrë që të verifikohen investimet e realizuara dhe punësimi në këtë Ndërmarrje, AKP ka angazhuar kompaninë audituese të pavarur për të bërë auditimin e investimeve dhe punësimit të realizuar. Kompania audituese më datën 19 Dhjetor 2014 ka dorëzuar raportin e auditimit ku sipas këtij raporti, blerësi nga EUR 4,000,000.00 investime të zotuar ka realizuar investime në vlerë prej 3,254,238.07 apo shprehur në përqindje 81.36%. Sa i përket punësimit sipas raportit të auditimit, blerësi ka përmbushur zotimet për punësim në përqindje prej 95.68%.

Blerësi ka kërkuar që periudha e përmbushjes së zotimeve të zgjatet deri më 28 Shkurt 2015, ngase deri në këtë periudhë, ai ka raportuar investime në vlerë prej EUR 4,818,609 si dhe ka kërkuar që ndërmarrja të lirohet nga marrëveshja e zotimeve.

Blerësi ka raportuar se ka filluar prodhimin me datën 29 Shtator 2016, por e cila prodhimtari më vonë është ndërprerë dhe sipas blerësit kjo ka ardhur për shkak të mungesës së plasimit të produkteve të tyre. Kërkesa e blerësit për zgjatje, raporti i auditimit dhe informatat e tjera do të shqyrtohen nga ana e Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Ndërmarrja e Re “NBI Suhareka/Agrokosova Holding”

Është privatizuar me 27 gusht 2007 nga blerësi “Gruppo Vinicolo Fantinel” dhe “QMI” përmes metodës së “Spin Off-it Special” në valën e 19-të të shitjes, ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të parapara në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 27 gusht 2009.

Sipas Marrëveshjes së Zotimeve blerësi është zotuar se do të bëjë investime kapitale në vlerë prej EUR 8,600,000 si dhe të punësoj 173 punëtorë gjatë 6 mujorit të parë ndërsa në fund të vitit të parë numri i të punësuarve të arrij gjithsej 345 punëtorë.

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më datën 26 dhe 31 gusht 2014 ka vendosur që për Ndërmarrjen e Re “Agrokosova Holding” të anulohet vendimi i Bordit të datës 16 dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve dhe t’i vazhdohet afati për përmbushjen e kushteve të Marrëveshjes për Zotime nga 27 gusht 2009 deri me 31 dhjetor 2014 dhe pas përfundimit të afatit të auditohet ndërmarrja për tërë periudhën e investimeve sipas kontratës për të vërtetuar përmbushjen e zotimeve.

Sipas raportit të fundit të auditimit të realizuar nga kompania e auditimit “AK Konto” për periudhën nga 27 Gusht 2014 deri me 31 Dhjetor 2014 nga vlera EUR 8,600.000.00 janë përmbushur EUR 7,045,713 apo 81.93% dhe shihet se ka dallime të mëdha në mes të këtij auditimi dhe atyre të kryera më herët nga kompanitë “Univerzum Audit” dhe “Trend Biz”.

Pas këtij raporti, nga blerësit e Ndërmarrjes së Re “Agrokosova Holding” kemi pranuar kërkesën për zgjatje të afatit për realizimin e investimeve. Kjo kërkesë arsyetohet me kushtet dhe rrethanat e krijuara në këtë

ndërmarrje si dhe kërkohet që t'i shtyhet afati për investime deri më 30 Prill 2015 ngase ata kanë dorëzuar një raport në të cilin theksojnë se ata kanë realizuar investime në vlerë prej EUR 1,805,500 për periudhën nga 1 Janar 2015 deri me 30 Prill 2015.

Kërkesa dhe informatat e tjera për këtë ndërmarrje do të shqyrtohen nga ane e Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

SPIN OFF-ET ME KUSHTE TË VEÇANTA

Që nga fillimi i procesit të privatizimit e deri më tani janë privatizuar 18 ndërmarrje përmes metodës së "Spin Off-it me kushte të veçanta".

Gjatë periudhës raportuese tetë Ndërmarrje të privatizuara me kushte kanë qenë ende në procesin e monitorimit të përmbushjes së kushteve të kontratës, kryesisht vazhdimit të aktivitetit të njëjtë të biznesit.

Prej këtyre ndërmarrjeve, Ndërmarrja e Re "Hotel Onix dhe Banja e Pejës" me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, pas plotësimit është liruar nga kushtet e marrëveshjes së zotimeve.

Lista e NSh-ve të cilat kanë qenë në monitorim gjatë periudhës raportuese është si më poshtë:

1. Ndërmarrja "Sharrcem";
2. Ndërmarrja "Famipa";
3. Ndërmarrja "Hotel Unioni";
4. Ndërmarrja "Fabrika e Amortizatorëve" (*liruar në Janar 2017*);
5. Ndërmarrja "Emin Duraku Kompleksi Industrial";
6. Ndërmarrja "Emin Duraku Edico";
7. Ndërmarrja "Dubrava Live Stock Dairy Farm"; dhe
8. Ndërmarrja "Fabrika e Baterive Industriale Trepça".

Ndërmarrja e Re "Sharrcem"

Është privatizuar me 9 dhjetor 2010 për shumën prej EUR 30.1 milion. Sipas Marrëveshjes për Shitblerjen e aksioneve blerësi ka marrë përsipër që gjatë 5 viteve në vijim të bëjë investime në vlerë prej 35 milion euro si dhe të vazhdojë të punësoj gjatë 3 viteve të para të gjithë ish-punonjësit e ndërmarrjes, gjithsej 503. Ndërmarrja e Re "Sharrcem" ka qenë e obliguar t'i raportoj AKP-së deri më 9 dhjetor 2015.

AKP ka angazhuar kompaninë audituese ndërkombëtare "BDO Kosovo" që të bëjë auditimin e përmbushjes së zotimeve nga ana e blerësit. Ky auditim ka filluar me vonesë, për shkak se blerësi i Ndërmarrjes ka kërkuar që në terma të referencës të përfshihet edhe auditimi i kushteve të tregut, kurse qëndrimi i AKP-së është që kompania audituese ka për obligim auditimin e përmbushjes së zotimeve për investime kapitale.

Kompania audituese "BDO Kosova" ka dorëzuar raportin e auditimit, ku sipas këtij raporti, nga vlera e zotuar për investime kapitale prej EUR 35,000,000, blerësi gjatë periudhës së zotimeve ka bërë investime në vlerë prej EUR 25,558,237.17. Blerësi i ndërmarrjes ka dhënë disa arsye, të cilat sipas tij kanë pamundësuar përmbushjen e zotimeve për punësim.

Raporti i auditimit dhe informatat e tjera për këtë ndërmarrje do të shqyrtohen nga ana e Bordit të drejtorëve të AKP-së.

Ndërmarrja e Re "Famipa"

Ndërmarrja e Re "Famipa" sh.p.k është privatizuar në valën 49 të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitblerjes është nënshkruar me datën 13 Shtator 2011.

Marrëveshja e Zotimeve parasheh që blerësi i Ndërmarrjes së Re “Famipa” do të vazhdoj aktivitetin e njejtë në ndërmarrje (prodhimin dhe përpunimin e metaleve) si dhe nuk do të çmontoj dhe dislokoj pajisjet nga ndërmarrja deri në përfundim të kontratës që ka qenë deri më 13 shtator 2014.

Pas përfundimit të marrëveshjes së zotimeve AKP ka angazhuar kompaninë audituese e cila ka bërë auditimin e përmbushjes së zotimeve.

Raporti i auditimit të kryer për ndërmarrjen e Re “Famipa” Prizren, shpalos se aktiviteti i ndërmarrjes nuk është mbajtur në kontinuitet, por varësisht prej porosive dhe në kërkesën e AKP-së që kompania audituese të jap opinion të qartë mbi përmbushjen e kushtit të mbajtjes së aktivitetit, kompania audituese në raportin final të dorëzuar ka theksuar se: “pasi që kontrata e shitjes nuk e definon qartë as në mënyrë sasiore, as në vlerë kushtet e përmbushjes së kontratës mbi mbajtjen e aktivitetit”, atëherë sipas tyre është e pamundur që të japin një konstatim të qartë në lidhje me ose në mos përmbushjen e zotimeve.

Raporti i auditimit dhe informatat e tjera do të shqyrtohen nga ana e Bordit të drejtorëve të AKP-së.

Ndërmarrja e Re “Hotel Union”

Ndërmarrja e Re “Hotel Union” është privatizuar në valën 11, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 2 gusht 2006.

Sipas Marrëveshjes së Zotimeve, blerësi i Ndërmarrjes së Re është zotuar së do të restauroj dhe mirëmbajë pamjen e jashtme të ndërtesës në atë mënyrë që thellësisht të ruaj stilin dhe karakterin historik të ndërtesës si dhe t’i siguroj Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës një hapësirë prej 200 m² për 13 vitet e ardhshme.

Njësia për Kontrollë dhe Mbikëqyrje vazhdimisht ka angazhuar takime në mes të Benetton Group si palë blerëse e ndërmarrjes dhe Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Gjatë këtyre takimeve asnjëherë nuk është arritur ndonjë marrëveshje për sigurimin e hapësirës për LSHK-në. Përfaqësuesit e Benetton Group kanë ofruar opzione të ndryshme duke iu dhënë mundësinë e zgjedhjes së lokacionit prej 200 m² në çfarëdo pjese të qytetit, por që LSHK vazhdimisht insiston që 200 m² t’i ndahen në hapësirën brenda objektit të Ndërmarrjes së Re. Në takimin e fundit, përfaqësuesit e Benetton Group iu kanë ofruar shumën prej EUR 150,000.00 LSHK-së por që edhe ky opcion është refuzuar nga ana e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

AKP do të kërkoj angazhime shtesë nga të dy palët që të gjejnë një zgjidhje lidhur me hapësirën prej 200 m² që duhet t’iu bëhet e disponueshme LSHK-së.

Ndërmarrja e Re “Hotel Onix Banja e Pejës dhe Banja e Shëndetit” Pejë

Ndërmarrja e Re “Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix” sh.p.k, është privatizuar si projekt individual përmes tenderit ndërkombëtarë ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 22 prill 2013.

Sipas Marrëveshjes së Zotimeve e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve të thjeshta në Ndërmarrjen e Re “Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix” sh.p.k, blerësi është zotuar të vazhdoj aktivitetin aktual të biznesit që nënkupton vazhdimin e veprimtarisë së njejtë të Ndërmarrjes Shoqërore në banjë shëndetësore dhe hotel deri më 22 prill 2016.

AKP ka angazhuar kompaninë audituese “Audit & Konto” për të bërë auditimin e përmbushjes së marrëveshjes së zotimeve. Sipas kompanisë audituese, blerësi ka përmbushur kushtet e parapara me marrëveshjen e zotimeve dhe bazuar në këtë, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më datën 21 shtator 2016 kanë liruar ndërmarrjen nga marrëveshja e zotimeve.

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Amortizatorëve”

Është privatizuar në valën 45A, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar më 31 mars 2011. Ndërmarrja e Re “Fabrika e Amortizatorëve” gjendet në Komunën e Prishtinës.

Në bazë të marrëveshjes, si detyrim kontraktues, blerësi i ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe të mbaj aktivitetin aktual të biznesit. Blerësi ka raportuar në periudha të rregullta ashtu siç parashihet edhe me Kontratë.

Periudha e Monitorimit përfundon më 31 mars 2016 dhe blerësi ka dorëzuar raportin e fundit gjashtëmujor. Pasi që është bërë përzgjedhja e kompanisë audituese, pritet vendimi i Bordit të AKP-së që të fillohet ky auditim.

Ndërmarrja nuk ka pasur asnjëherë prodhimtari serike por kryesisht me porosi dhe shumë prej të hyrave të tyre janë krijuar nga riparimet e amortizatorëve të vjetër dhe nga qiraja (një pjesë). Blerësi furnizohet me lëndë të parë kryesisht në tregun e Kosovës dhe për ndonjë pjesë specifike furnizohet nga partneri Slloven “Amortizeri D.O.O”.

Me datën 9 shtator 2016 është pranuar raporti i auditimit nga Kompania e jashtme e pavaruar “Audit & Konto”, ku sipas raportit të auditimit citohet: *“Edhe pse Kontrata e Shitblerjes nuk jep specifika mbi kriteret matëse se çka nënkupton aktiviteti aktual i biznesit apo në cilën masë të qarkullimit do të konsiderohet i mjaftueshëm mbajtja e aktivitetit aktual të biznesit, prandaj duke pasur parasysh gjetjet e specifikuar më lartë, asgjë nuk ka ardhur në vëmendjen tonë që na bën neve të besojmë që Ndërmarrja e Re “Fabrika e Amortizatorëve” sh.p.k nuk e ka vazhduar dhe mbajtur aktivitetin e biznesit në masën e parametrave të shitjes, blerjes, nr. të punëtorëve dhe investimeve të specifikuar në fq. 4-8 për periudhën pesë (5) vjeçare ashtu siç ka qenë e paraparë në nenin dy (2) të Marrëveshjes për Detyrime Kontraktuese”.*

Ky raport dhe informatat e tjera për këtë ndërmarrje janë shqyrtuar nga ana e Bordit të Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e Bordit në Janar 2017 me ç’rast është konstatuar se blerësi nuk ka më obligime raportuese.

Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Kompleksi Industrial” sh.p.k

Është privatizuar në Valën 45A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 3 shtator 2012. Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Kompleksi Industrial” sh.p.k gjendet në Komunën e Gjakovës.

Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 3 shtator 2017. Edhe kjo ndërmarrje sikurse pjesa dërmuese e ndërmarrjeve të shitura me kushte nuk kanë ndonjë obligim kontraktual për investime apo punësim me vlera, por kanë kusht vetëm mbajtjen e aktivitetit aktual të biznesit.

Blerësi është duke u marrë me prodhimin e dyshekëve dhe nuk ka ndonjë prodhimtari tjetër në fushën e tekstilit. Blerësi i kësaj ndërmarrje ka vazhduar partneritetin me kompaninë “INTERTEX” sh.p.k, dhe sipas këtij partneriteti, blerësi është duke i ofruar objektin kompanisë “Intertex”, e cila është duke prodhuar mbulesa për një përdorim për kompaninë e veturave “VOLVO” si dhe është duke bërë edhe prodhimin e disa produkteve të tjera. Numri i punëtorëve të angazhuar në ndërmarrje është 14, nga të cilët 8 janë në prodhim kurse 6 punojnë si roje.

Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Edico” sh.p.k

Është privatizuar në Valën 45A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë më datën 14 gusht 2012 e cila gjendet në Komunën e Gjakovës.

Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 14 gusht 2017. Blerësi është duke e vazhduar aktivitetin në fushën e tekstilit, kryesisht prodhimin e trikove, veshjeve sportive dhe xhinseve. Një kohë të gjatë blerësi ka pasur probleme të furnizimit me energji elektrike por që ky problem gjatë pjesës së parë të këtij viti është zgjidhur.

Nga vizitat dhe raportet e dorëzuara deri më tani nga ana e blerësit konstatohet se deri më tani blerësi është duke mbajtur aktivitetin e tij në përputhje me marrëveshjen e zotimeve.

Ndërmarrja e Re “Dubrava Live Stock Dairy Farm”

Është privatizuar në valën e 28 të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 19 dhjetor 2011. Ndërmarrja e Re “Dubrava Dairy Farm” gjendet në Komunën e Istogut.

Në bazë të marrëveshjes, si detyrim kontraktues blerësi i ri ka marrë përsipër që të vazhdojë dhe të mbajë aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së detyrimit kontraktues, respektivisht deri më 19 dhjetor 2016 (periudha prej 5 viteve). Blerësi është i obliguar të mbajë të punësuar 17 punëtorë, si dhe të mbajë 250 krerë gjedhe për këtë periudhë kohore në bazë të Kontratës.

Blerësi vazhdon aktivitetin e tij në përputhje me marrëveshjen e zotimeve dhe mban numrin prej 260 krerë gjedha dhe 17 punëtorë, të cilëve përpos pagës iu siguron edhe shujtën. Nga raportimet e bëra nga ana e blerësit dhe nga vizitat monitoruese, konstatohet se deri më tani blerësi ka mbajtur aktivitetin e tij bazuar në marrëveshjen e zotimeve.

Pas përfundimit të periudhës së zotimeve, AKP do të angazhojë kompaninë audituese për të audituar përmbushjen e zotimeve nga ana e blerësit.

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça”

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça” sh.p.k, është privatizuar si projekt individual ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 14 qershor 2013.

Sipas marrëveshjes së shitjes, blerësi i ri siguron dhe garanton se do të vazhdojë dhe do të mbajë aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së zotimit për tri vitet e ardhshme, konkretisht deri më 14 qershor 2016.

Janë zhvilluar vizita monitoruese, ku mund të konstatohet se ndërmarrja prodhon kryesisht bateri me porosi, pasi që sipas përfaqësuesve të blerësit ata nuk kanë treg për prodhimtari serike, prandaj janë të orientuar për prodhimtari vetëm me porosi. Prodhimtaria e këtyre baterive ka qenë kryesisht për Trepçën veriore dhe pak për eksport në Shqipëri.

Sipas raportimeve të blerësit, në ndërmarrje janë duke punuar 38 punëtorë, për të cilët edhe pagesat e pagave bëhen me vonesa disa mujore. Blerësi ka prodhuar kryesisht sipas kërkesave individuale dhe ka përmbushur kushtet e marrëveshjes së zotimeve.

AKP pas përfundimit të marrëveshjes së zotimeve ka angazhuar kompaninë audituese “Audit & Konto” për të bërë auditimin e përmbushjes së kushteve të marrëveshjes së zotimeve. Sipas raportit të kompanisë audituese, blerësi ka përmbushur kushtet e marrëveshjes së zotimeve. Raporti i auditimit dhe informatat tjera për këtë ndërmarrje do të shqyrtohen nga ana e Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Ndërmarrja e Re “Kualiteti International” sh.p.k Gjilan

Është privatizuar në valën e 25 të shitjes dhe kontrata është nënshkruar më datën 26 maj 2008. Shitja e ndërmarrjes është bërë me Spin Off të thjeshtë, por me kusht që gjatë periudhës 2 vjeçare ndërmarrja të mbaj aktivitetin e vet si mulli respektivisht si depo për grumbullimin e drithërave.

Blerësi i ndërmarrjes edhe përkundër shkresave të dërguara nga AKP, ka bërë shitjen e pjesës më të madhe të parcelave të ndërmarrjes, ku tani aty janë duke u ndërtuar disa objekte afariste banesore. Gjithashtu aty ka filluar demolimi i mullirit me qëllim të ndërtimit të objekteve banesore.

Prona në të cilën ka qenë mulliri, tani sipas të dhënave të marra nga Kadastra i Komunës së Gjilanit nuk është më në emër të Ndërmarrjes së Re “Kualiteti International”. Lidhur me këto transfere të pronës, AKP ka dërguar shkresa në departamentet përkatëse të komunës së Gjilanit dhe tek blerësi lidhur me shkeljet që janë bërë nga ana e blerësit.

Padinë që AKP ka bërë lidhur me fillimin e ndërtimeve pa leje Dhoma e Posaçme e ka hedhur poshtë, prandaj zyra ligjore ka bërë prapësim në këtë vendim.

Gjatë këtij viti AKP ka angazhuar edhe kompaninë audituese “Audit & Konto” për të audituar kushtet e kontratës. Sipas raportit të auditorit, blerësi i kësaj ndërmarrje ka mbajtur aktivitetin e vet por që këtë aktivitet e ka mbajtur me një entitet tjetër biznesor të regjistruar pranë ARBK me emër FBM “Kualiteti” dhe numër tjetër të biznesit që është 70547066.

Raporti i auditimit dhe informatat e tjera për këtë ndërmarrje do të shqyrtohen nga ana e Bordit të drejtorëve të AKP-së.

Ndëshkimet financiare për mospërbushje të zotimeve

Për shkak të mospërbushjes së zotimeve, deri më tani janë aplikuar ndëshkimet financiare për blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet.

Më poshtë japim formën tabelore të ndëshkimeve për periudhën kohore nga fillimi i privatizimit të ndërmarrjeve me Spin Off Special deri më 31 Dhjetor 2016:

PËRSHKRIMI	DERI MË 31 DHJETOR 2014	JANAR - DHJETOR 2015	JANAR - DHJETOR 2016	GJITHSEJ
Emri i Ndërmarrjes së Re:	1	2	3	4=1+2+3
Grand Hotel	8,822,314.97	-	-	8,822,314.97
IDGJ Tobacco	4,573,649.11	-	-	4,573,649.11
Xim Strezovc	7,298,170.76	-	-	7,298,170.76
MIM Golesh	8,447,812.27	-	-	8,447,812.27
Agrokosova Holding	3,579,997.53	-	-	3,579,997.53
Llankos	1,686,459.51	29,029.28	-	1,715,488.79
GJITHSEJ	34,408,405.15	29,029.28	-	34,437,433.43

Në planin e punës për vitin 2017, Agjencia do të fillojë të trajtoj ndëshkimet financiare. Kjo çështje do të marrë kohë deri në zgjidhjen e saj duke marrë parasysh marrjen e masave edhe ndjekjen e anës Ligjore.

5.1.2 SHITJA E BANESAVE – BARTJA E SË DREJTËS BANESORE

Komisioni për Shitjen e Banesave në Pronësi të NSH-ve ka pranuar gjithsej **1439** kërkesa për blerje të banesave nga periodha 01.04.2012, prej të cilave deri më tani nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së janë vendosur **966** kërkesa:

- Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2016, nga Komisioni për Shitjen e Banesave janë shqyrtuar 389 kërkesa dhe janë vendosur nga Bordi i Drejtorëve, prej të cilave:
 - ✓ Janë aprovuar 232 kërkesa;
 - ✓ Janë refuzuar si të pabazuara 87;
 - ✓ Janë hedh poshtë si të papranueshme për shkak të kompetencës lëndore 57 kërkesa;
 - ✓ Janë pezulluar 13 kërkesa për shkak të procedurës gjyqësore.
- Janë përmblyllur 215 kontrata për shitjen e banesave;
- Gjatë periudhës raportuese Komisioni ka kërkuar 97 konfirmime nga Agjencia Kosovare e Pronës lidhur me atë nëse banesat për të cilat palët kanë paraqitur kërkesë për shitjen e banesave pranë AKP-së kanë qenë objekt kontesti pranë ish Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore apo tani pranë Agjencisë Kosovare për Prona;
- Janë draftuar gjithsej 97 Memorandume Informuese për kërkesat e paraqitura në Komision për shqyrtim.

Të hyrat e realizuara për periudhën raportuese janë EUR 103,822.

5.1.3 KOMISIONI PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE JOLIGJORE NË PRONAT E NSH-VE

- Komisioni gjatë periudhës raportuese ka pranuar gjithsej 42 (dyzet e dy) raste të reja si nga ana e anëtarëve të Komisionit, po ashtu edhe nga palët të cilët kanë ardhur për këshilla/kompleteime të lëndëve dhe në fund i kanë dorëzuar personalisht në Komision;
- Janë draftuar dhe firmosur 60 Konkluzione për 60 raste të shqyrtuara nga Komisioni;
- Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga MMPH-ja me mbështetje të projektit të USAID/Partneritet për Zhvillim.

5.1.4 ADMINISTRIMI I ASETVE TË PASHITURA

Asetet e mbetura (të pashitura) me të cilat ende administron AKP-ja janë gjithsej 1,867, ndërsa asetet jashtë Kosovës janë 162. Gjithsesi, ky numër mund të ndryshoj në periudhat pasuese, varësisht në ndërrimin e statuseve të NSH-ve apo identifikimit të aseteve të NSH-ve përkatëse.

RAJONI	ASETET TJERA	TOKAT BUJQËSORE	TOKAT TJERA	GJITHSEJ
Prishtina	302	127	57	486
Peja	274	179	106	559
Prizren	114	159	11	284
Gjilan	66	35	100	201
Mitrovica	193	117	27	337
GJITHSEJ	949	617	301	1867

Gjatë kësaj periudhe lidhur me këto asete, AKP-ja kryesisht ka administruar lidhur me: qiratë, trajtimin e tyre si asete të uzurpuara, në koordinim me institucionet – shpalljen e interesit publik, kontestet gjyqësore dhe të tjera.

5.1.4.1 ASETET E LËSHUARA ME QIRA

Gjatë periudhës raportuese, AKP-ja ka lëshuar me qira dhe ka mbledhur obligime të papaguara për vitin 2016 në shumë totale prej **EUR 6,137,570** dhe ate:

1. Qiraja e inkasuar për NSh-të në likuidim prej EUR 5,226,852;
2. Qiraja e inkasuar për NSh-të në tranzicion prej EUR 910,718.

Në krahasim me vitet paraprake, AKP-ja ka realizuar të hyrat prej 27.96% më shumë në krahasim me vitin 2015 dhe 213.48% më shumë në krahasim me 2014.

INKASIMET SIPAS VITEVE					
NSH	GJITHSEJ	2016	2015	2014	2002 - 2013
Pallati	2,416,698	1,049,235	496,908	454,642	415,913
Grandi	812,627	431,618	381,009	0	0
ABC Genci	224,112	116,364	107,748	0	0
Tregu	1,278,502	651,978	573,466	53,058	0
GJITHSEJ	4,731,939	2,249,195	1,559,131	507,700	415,913
NSH-të TJERA	16,281,186	3,888,375	3,237,410	1,450,195	7,705,206
GJITHSEJ	21,013,125	6,137,570	4,796,541	1,957,895	8,121,119

Rritja e performancës të inkasimeve (sidomos gjatë 2015 dhe 2016) ka ardhur si rezultat i dy faktorëve të paraqitur si më poshtë:

1. Administrimin nga AKP me Nsh-të të cilat kanë vazhduar aktivitetin e përgjithshëm ekonomik - NSh Grandi, NSh Tregu, NSh ABC Genci dhe administrimi (tranzicion/likuidim) me Pallatin e Rinisë; dhe
2. Vendimi i datës 21 Nëntor 2014 nga Menaxhmenti për lirimin e aseteve të uzurpuara. Për këto janë paraqitur shënimet ndarazi në nënkapitullin "Trajtimi i Aseteve të Uzurpuara".

Sa i përket NSh-ve të cilat kanë vazhduar aktivitetin ekonomik, të cilat janë vendosur nën administrim të AKP-së, gjatë këtij viti janë marrë veprime për inkasimin e qirave apo obligimeve të papaguara. Për këto NSh është sfidë e madhe menaxhimi i tyre për shkak të kompleksitetit dhe madhësisë së tyre. AKP-ja përveç tyre menaxhon edhe me 537 NSh (gjithsej 541 NSh nën administrim të AKP-së). Ndërsa sa i përket inkasimeve të NSh-ve tjera, indikator kryesor në rritjen e qirave është vendimi i cili është marrë në Nëntor 2014 nga ana e Menaxhmentit për lirimin e pronave të uzurpuara. Pra, vlenë të theksohet se vetëm për periudhën 2015-2016 janë inkasuar gjithsej EUR 7,125,785, e që është 92.48% e inkasimeve për vitet 2002-2013. Për më tepër, shih tek nënkapitulli "Trajtimi i Aseteve të Uzurpuara".

5.1.4.2 TRAJTIMI I ASETEVE TË UZURPUARA

Numri i aseteve të uzurpuara aktualisht si dhe numri i aseteve që shfrytëzohen nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare ndryshon, ngase edhe pse janë trajtuar uzurpatorët e njohur, megjithatë zyrat rajonale vazhdimisht e kanë azhurnuar këtë listë, pasi që në terren është punuar intensivisht në identifikimin e aseteve të reja, të cilat në shumicën e rasteve kanë qenë duke u shfrytëzuar pa bazë, gjë që e bënë listën të ndryshojë në vazhdimësi.

Kjo pjesë është krahasuese nga raporti vjetor i vitit 2015, që d.m.th. në fund të vitit 2015 kanë qenë 167 uzurpatorë klasik dhe në fund të vitit 2016 janë 53 raste.

Deri në fund të muajit janar 2017 është planifikuar që të mos ketë asnjë aset të uzurpuar të pa trajtuar aty ku është e mundur dhe kjo pikë planifikojmë që të tejkalohet gjatë vitit 2017, dhe për këtë arsye në vitin 2017 nuk ka ndonjë planifikim për këtë segment, por do të trajtohen rastet e reja eventuale.

Numri i aseteve që shfrytëzohen nga palët e treta:

PËRSHKRIMI	VITET		
	2016	2015	2014
Uzurpatorë	53	167	491
Rastet sociale	7	13	N/A
Institucionet vendore	85	85	85
Institucionet ndërkombëtare	4	4	6
Ndërmarrjet Publike	7	8	N/A
Shprehje e interesit për qira	87	15	N/A
Kontest pronësor	20	N/A	N/A
Gjithsej	263	292	582

Prej vitit 2002 e deri më 21 Nëntor 2014 janë inkasuar 8.9 milion euro, prej tyre 4.5 milion janë inkasuar përmes marrëveshjeve me institucionet ndërkombëtare për pagesa të borxheve ndaj NSh-ve, ndërsa 4.4 milion janë inkasuar me qiradhënësit tjerë.

Vetëm gjatë periudhës dyvjeçare (Nëntor 2014 – Dhjetor 2016) janë inkasuar 7.3 milion euro nga qiradhënia e aseteve apo 65.91% më shumë (rritja nga 4.4 në 7.3 milion) se sa inkasimi i qirasë prej 4.4 milion euro që është realizuar në 12 vitet e mëparshme.

Sa i përket vendimit për lirim të pronave nga uzurpatorët ka rezultuar një performancë e shkëlqyer në administrimin e aseteve.

Për më tepër, shih dallimet tek tabela e mëposhtme ndërmjet dy periudhave:

	A	B	C=A+B	D=A/C
PËRSHKRIMI	INKASIMET PAS MARRJES TË VENDIMIT 21 NËNTOR 2014 – 31 DHJETOR 2016	INKASIMET GJATË PERIUDHËS Qershor 2002 – 20 NËNTOR 2014	GJITHSEJ	% PJESËMARRA E TOTALIT
Likuidim	4,949,835	2,070,803	7,020,638	70.50%
Tranzicion	2,394,963	6,865,586	9,260,549	25.86%
GJITHSEJ	7,344,798	8,936,389	16,281,187	45.11%

* tabela nuk përfshinë inkasimin e qirave për NSh-të ABC Genci, Tregu, Pallatin e Rinisë dhe Grand Hotel. Sa i përket ndryshimeve tek NSh-të në tranzicion apo NSh-ve në likuidim, ato vijnë kryesisht si rezultat i ndërrimit të statusit të Ndërmarrjes Shoqërore – hyrje e NSh-së në likuidim.

Gjithashtu, përveç rritjes së inkasimeve të qirave nga vendimi për lirim të aseteve nga uzurpatorët, ky vendim do të reflektojë edhe në shitjen e aseteve në periudhat pasuese. Menaxhmenti ka marrë vendim që asnjë aset të mos shpallet për shitje deri në lirim të tyre nga uzurpatorët.

5.1.4.3 SHPALOSJE PËR TREPÇËN

Meqenëse Ligji për Riorganizim të Ndërmarrjeve të Veçanta pas ndryshimit paraprak për afatin e dorëzimit të planit të riorganizimit i shtyrë deri më 2 nëntor 2016, AKP-ja vazhdoj gjatë gjithë kësaj periudhe të koordinoj dhe të mbikëqyrë proceset e nevojshme për riorganizim në kuadër të përgatitjes të Planit të Riorganizimit të Trepçës. Një ndër hapat konkret dhe më të rëndësishëm në këtë aspekt është angazhimi i Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për të realizuar Studimin e Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj, dokument i cili do jetë bazë për përpilimin e planit të riorganizimit.

AKP-ja, përveç punëve në planin e riorganizimit të ndërmarrjes gjatë periudhës raportuese ka mbikëqyrë punët e përditshme në Trepçë (posaçërisht në PIM). Vlen të theksohet se kërkesat e shumta për mbikëqyrje në Trepçë me specifika të veçanta teknike në fusha të ndryshme kanë kërkuar angazhim të shtuar.

Janë realizuar mbikëqyrjet në shumë procese, por do të ndajmë ato më të rëndësishmet:

- Mbikëqyrja e procedurave të shitjes së Koncentratit të Trepçës;
- Mbikëqyrja e procedurave të prokurimit që tejkalon vlerën 10,000 Euro;
- Asistimi i Trepçës dhe angazhimi në kontestet Gjyqësore të saj; si dhe
- Luajtjen e rolit të urës ndërmjetësuese apo kanalit komunikues ndërmjet Dhomës së Posaçme dhe Trepçës. Gjatë periudhës raportuese, janë dorëzuar raportet e rregullta tremujore në DhPGJS, si dhe të gjitha kërkesat, udhëzimet për veprim dhe komunikimin e natyrave tjera të dorëzuara në DhPGJS, të cilat janë iniciuar dhe proceduar nga AKP-ja dhe të cilat janë realizuar në bashkëpunim me Trepçën.

AKP ka nënshkruar kontratën me OShP për Studimin e Fizibilitetit të Trepçës, kontratë kjo e cila ka filluar të implementohet nga Shtatori 2016 dhe e cila do zgjatë deri në muajin Shkurt-Mars 2017 në vlerë prej EUR 598,920.00. Kjo vlerë nuk është paraparë në vitin 2017, mirëpo me kërkesën e dy buxhetore për vitin 2017, kemi kërkuar nga Ministria e Financave që të bën bartjen e shumës nga buxheti i vitit 2016 në vitin 2017, në vlerën e Kontratës së nënshkruar prej EUR 598,920.00 që ende nuk kemi pranuar konfirmim nga MF.

Aktivitet tjetër shtesë i AKP-së mund të konsiderohet udhëheqja e fazës transitore me qëllim të implementimit me sukses të strategjisë dhe transformimit të Ndërmarrjes Shoqërore “Trepça në Administrimin e AKP-së” në Shoqëri Aksionare, obligime të cilat rrjedhin me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, sipas nenit 17 të të cilit *“dispozitat e këtij ligji mbizotërojnë mbi çdo dispozitë tjetër të legjislacionit tjetër që mund të parasheh diçka ndryshe prej asaj që parashihet me këtë ligj”*, shfuqizon Ligjin nr. 04/L-035 për Riorganizim të Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre, përfshirë këtu edhe Ligjin Nr. 05/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të lartcekur. Meqenëse, sipas ligjit të ri për Trepçën (Nr. 05/L-120) një pjesë e njësive biznesore të NSh. “Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP” nuk parashihet të transformohen në Sh.A. dhe vendimi përfundimtar mbi statusin e tyre do merret vetëm pas përfundimit të studimit të fizibilitetit, për AKP mbeten detyra që do duhet të përcjellen në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2017.

5.1.4.4 ADMINISTRIMI DIREKT I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Në rrjedhën normale të ngjarjeve, mbikëqyrja, kontrolli dhe monitorimi i ndërmarrjeve bëhet nga Zyrat Rajonale të AKP-së.

Masat e Administrimit Direkt janë implementuar në rastet specifike kur një NSh kishte ngadalësim apo ngecje në progres apo ishte në rrezikshmëri financiare për shkak të keqmenaxhimit apo dëmtimit të aseteve, e që reflektonte në dëm të interesave të NSh-së dhe punëtorëve të saj.

Gjatë periudhës raportuese, Njësia e AD ishte kryesisht e fokusuar në Administrimin e Ndërmarrjeve të cilat me vendim të Bordit ishin vendosur nën AD, po ashtu kishte përgatitur të dhënat për Ndërmarrjet të cilat janë larguar nga AD.

Ereniku-Industria

Është proceduar Memorandumi për Bordin e Drejtorëve të AKP-së me kërkesë për aprovimin e hyrjes në qira për Asetin e NSh "Ereniku-Industria". Është formuar komisioni për përcaktimin e çmimit të qirasë për asetin në fjalë. Rekomandimi i komisionit për çmimin e qirasë është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve. Shfrytëzuesi i paligjshëm i asetit është njoftuar me kushtet për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë. I njëjti ka kundërshtuar çmimin e qirasë në vlerë prej 850 euro, pasi që sipas tij është çmim shumë i lartë për të paguar për shfrytëzimin e tokës, duke konsideruar faktin se objektet i ka ndërtuar vet. Rasti është në proces.

Është bërë dëbimi i shfrytëzuesit të paligjshëm të asetit (depo në Fushë Kosovë) pronë e NSh "Ereniku-Industria", dhe i njëjti i është dorëzuar blerësit, i lirë dhe pa pengim të posedimit.

NSh "Boksitet e Kosovës"

Pas shumë përpjekjeve është arritur që të ekzekutohet garancioni bankar i qiramarrësit i cili kishte marrë me qira separacionin në muajin nëntor të vitit 2015 dhe pas nënshkrimit të kontratës së qirasë nuk kishte pranuar ta shfrytëzoj asetin me çmimin e ofertuar. Si rrjedhojë e kësaj NJAD kishte proceduar rastin tek përmbartuesi dhe tek Kompania e Sigurimeve për ekzekutimin e Garancionit Bankar në muajin mars 2016.

Aktivitetet e NSh-së gjatë kësaj periudhe ishin kryesisht qiradhënia e aseteve si dhe kompletimi i dokumentacionit kadastral për pronat e Boksiteve e po ashtu edhe koordinatat e boksiteve të cilat ishin kërkuar nga KPMM.

Po ashtu, ndër aktivitetet e Ndërmarrjes ka qenë edhe përpjekja për rrethimin e gropës (bazenit) në zonën e sferkës pas kërkesës së inspeksionit komunal. Ndërmarrja kishte filluar aktivitetin e hapjes së gropave, mirëpo për shkak të hapësirës së madhe zonës shumë të vështirë për të punuar, peticionit të fshatarëve për ta mos mbyllur bazenin pasi që e shfrytëzojnë për ujë të pijshëm për kafshë, është ndërprerë rrethimi i gropës dhe është vendosur të vendosen shenja se afërsia paraqet rrezik për jetë.

Ndërmarrja e Re "MIM Golesh"

Nga Ndërmarrja kemi pranuar Aktvendimin e lëshuar nga KPMM me të cilin kërkesa e AKP për bartje të licencës për shfrytëzimin e dunitit me nr. 10748/KPMM/2011 është aprovuar.

Pas përpjekjeve njëvjeçare më në fund kemi arritur të marrim licencën për shfrytëzimin e Dunitit. AKP ka paguar detyrimet ndaj KPMM për taksat dhe borxhet e tjera të Ndërmarrjes të cilat kanë qenë kusht për bartjen e licencës.

Bazuar në kërkesën e kompanisë Bechtel Enka si dhe rekomandimit të Stafit Menaxhues të Ndërmarrjes, Njësisë së Administrimit Direkt dhe Menaxhmentit të AKP-së, Bordi i AKP-së në mbledhjen e mbajtur me datën 28 prill 2016 ka marrë vendim që të vazhdohet kontrata për shfrytëzimin e Dunitit në mes të Neë Co "Mim Golesh" sh.p.k dhe Bechtel Enka.

Pas hyrjes në fuqi të kontratës me Bechtel Enka, për shkak të rritjes së volumit të punës stafi menaxhues ka filluar angazhimin e punëtorëve në dy ndërrime. Lidhur me këtë, stafi menaxhues i Ndërmarrjes ka marrë vendim për harmonizimin e pagave si dhe rritjen e numrit të punëtorëve të cilët do të angazhohen nga muaji korrik 2016. Harmonizimi i pagave është bërë konform pozitës, edukimit profesional dhe përshkrimit të detyrave të punës. Të gjithë këta punëtorë ishin punëtorë të Ndërmarrjes "Neë Co MIM Golesh" në momentin e kthimit të aksioneve dhe vendosjes së Ndërmarrjes nën Administrim Direkt.

Aktualisht në Ndërmarrje janë të punësuar gjithsejt 46 punëtorë të cilët marrin pagat me rregull, paguhen tatimet dhe kontributet pensionale. Kompania Bechtel Enka ka përfunduar gjithsejt 8 minime dhe tani mbetet vetëm të vazhdoj me tërheqjen e materialit të përpunuar.

Kemi filluar auditimin e jashtëm të pasqyrave financiare të Ndërmarrjes për vitin 2016.

5.2 LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Gjatë periudhës raportuese në proces të likuidimit ka hyrë vetëm një ndërmarrje Shoqërore dhe atë “Pallati i Rinisë, Kulturës dhe Sporteve”.

Në total, nga fillimi i tërë procesit deri në datën raportuese janë gjithsej 463 Ndërmarrje Shoqërore të cilat kanë hyrë në proces të likuidimit.

Këto Ndërmarrje Shoqërore në likuidim janë administruar nga:

- Autoriteti i Likuidimit me AKP-në për NSh-të të cilat kanë asete sipas shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 – Ofruesin e Shërbimeve Profesionale.
- Njësia e Likuidimit e cila bënë likuidimin e Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat nuk kanë asete. Nga 29 Ndërmarrje Shoqërore janë likuiduar 12 prej tyre (tërë procesi) me vendim të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Ndërsa 17 prej tyre janë në proces të mbylljes.

PËRSHKRIMI	JANAR-DHJETOR 2016	TËRË PROCESI
Numri i NSh-ve në likuidim	1	463
Numri i kërkesave të parashtruara nga kreditorët	244	89,675
Numri i kërkesave të shqyrtuara	271	89,539
Numri i NSh-ve të mbyllura sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) - (NSh-të pa asete apo pa kërkesa)	5	12
Numri i raporteve përfundimtare dorëzuar nga AL te Dhoma e Posaçme për mbyllje të NSh-së	1	4
Numri i raporteve të shpërndarjes përfundimtare	19	21
Numri i raporteve të shpërndarjes së përkohshme	96	96

Nga 89,539 të kërkesave të kreditorëve të shqyrtuara deri në datën raportuese, 83,553 janë shqyrtuar nga Ofruesi i Shërbimeve Profesionale.

5.2.1 OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Ashtu siç është përshkruar më lartë, Ofruesi i Shërbimeve Profesionale është i angazhuar si pjesë e Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore të cilat kanë asete. Kjo në përputhje me nenin 13 të shtojcës të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

	A	B	C=A-B	D=B/A
PËRSHKRIMI	VLERA E KONTRAKTUAR	PAGESAT E REALIZUARA	SHUMA E MBETUR NGA KONTRATA	%
KONTRATA E PARË KOSTOJA FIKSE 10 Korrik 12 - 10 Korrik 16	4,924,740	4,924,740	0.00	100%
KONTRATA E PARË KOSTOJA VARIABILE 10 Korrik 12 - 10 Korrik 2016	13,003,564	9,084,190	3,919,374	69.86%
10% E VLERËS SË ANEKS KONTRATËS	1,992,000	415,000	1,577,000	20.83%
GJITHSEJ	19,920,304	14,423,930	5,496,374	72.41%

Me 9 korrik 2016 ka përfunduar kontrata katër vjeçare me Kontraktorin për projektin me ç'rast kontraktori ka dorëzuar shërbimet dhe dokumentacionin përkatës sipas kërkesës së AKP-së ku përfshihen:

- Konfirmimi lidhur me lëndët e mbetura për të përfaqësuar në DhPGjSK (afatet ligjore dhe informatat e tjera);
- Konfirmim nga Kryesuesit e AL-ve që dosjet fizike dhe elektronike për secilën NSh janë të kompletuara tek zyrtarët e rastit të NSh-ve përkatëse;
- Të gjitha faturat/kredit notat janë dorëzuar dhe janë harmonizuar pagesat;
- Listën e të gjitha kërkesave kreditore ende të pa vendosura nga AL-të;
- Raport përmbljedhës për periudhën kontraktuese 2012 – 2016.

Me datën 8 gusht 2016 është nënshkruar aneksi 2 i kontratës për Projektin e Likuidimit të një portofolio të Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës, me ç'rast janë emëruar Kryesuesit dhe Anëtarët e AL-ve për të gjitha Ndërmarrjet për të cilat Kontraktori i ka sjellë në DKL propozimet (408 NSh), për 26 NSh për të cilat ka paqartësi nëse kanë asete ose jo, pritet që të bëhen emërimet në momentin kur të qartësohet lista me Departamentin e Koordinimit Rajonal.

5.2.2 SHQYRTIMI DHE SHPËRNDARJA E MJETEVE NDAJ KREDITORËVE

Autoritetet e Likuidimit të NSh-ve në Likuidim kanë përgatitur raportet përfundimtare të shpërndarjes dhe ka filluar shpërndarja e mjeteve tek kreditorët e ligjshëm sipas raporteve të aprovuara nga Bordi i Agjencisë.

Në mbledhjet e mbajtura gjatë periudhës Mars - Dhjetor 2016, janë aprovuar për shpërndarje për gjithsej 117 Ndërmarrje dhe është aprovuar një raport për të cilën mjetet janë shpërndarë në vitin 2011. Vlera e fondeve për shpërndarje sipas raporteve të aprovuara për 117 NSh është gjithsej EUR 17,414,431, ndërsa raportet e viteve paraprake (tre raporte) është EUR 45,142. Në total janë **EUR 17,459,573**.

	2011- 2015	GJENDJA E APROVIMEVE DHE PAGESAVE 2016		
PËRSHKRIMI KREDITORËT	APROVUAR PAGUAR	SHUMA E APROVUAR	PAGUAR	PAPAGUAR
1	2	3	4=2-3	
Për paga të punëtorëve	23,165	6,484,402	6,080,864	403,538
ATK-ja	2,607	3,981,721	3,649,248	332,473
Trusti	928	1,718,060	1,620,243	97,817
Tatimi në pronë	14,139	953,263	950,510	2,753
Shërbimet publike	3,018	795,077	713,713	81,364
Kreditor të tjerë	1,285	3,481,908	2,812,308	669,600
Gjithsej	45,142	17,414,431	15,826,886	1,587,545

GJITHSEJ		
SHUMA E APROVUAR	PAGUAR	PAPAGUAR
5=1+2	6=1+3	7=5-6
6,507,567	6,104,029	403,538
3,984,328	3,651,855	332,473
1,718,988	1,621,171	97,817
967,402	964,649	2,753
798,095	716,731	81,364
3,483,193	2,813,593	669,600
17,459,573	15,872,028	1,587,545

Në shumatat e papaguara, kryesisht kanë të bëjnë me vendimet Bordit të Drejtorëve të datës 16 dhe 20 Dhjetor 2016, për të cilat është filluar të paguhet në fillim të muajit Janar 2017. Shuma totale e këtyre vendimeve për shpërndarje për muajin Dhjetor 2016 është EUR 1,378,365, ndërsa pjesa tjetër e papaguar është si rezultat i mungesës të informacioneve të sakta të llogarive bankare për ekzekutim të pagesave.

5.3 SHPËRNDARJA E 20% TË PUNËTORËVE

Nga viti 2003 deri në periudhën raportuese shuma e transferuar e 20% në llogarinë e BSPK-së është EUR 109,973,567 në të mirë të punëtorëve të NSh-ve.

Për periudhën raportuese, gjithsej shuma e transferuar në të mirë të llogarisë bankare të BSPK-së për punëtorët e kualifikuar të NSh-ve është EUR 5,728,413 nga e cila kanë përfituar 11,116 punëtorë.

PËRSHKRIMI	JANAR - DHJETOR 2016	TËRË PROCESI
Shuma e shpërndarjeve të 20%-it për punëtorët e NSh-ve	5,728,413 €	109,973,567 €
Lista finale të punëtorëve	0	310
Vendime të formës së prerë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës	24	147
Listat në pritje për shqyrtim nga gjykata		118
Numri i punëtorëve për të cilët janë bërë pagesat	11,116	46,002
Shuma e fondeve të gatshme për shpërndarje punëtorëve posa të shqyrtohen ankesat nga DhPGJSK		21,121,998 €

5.4 AKTIVITETET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-së

5.4.1 BURIMET NJERËZORE

Gjatë periudhës raportuese kemi pasur rekrutime, pezullime, dorëheqje, pensionim dhe transfer të brendshëm. Më poshtë janë paraqitur përmbledhje e rekrutimit dhe dorëheqjes/daljes në pension të Menaxhmentit dhe Stafit të AKP-së:

- Përgatitja e listave të pagave për periudhën Janar – Dhjetor 2016;
- Me vendim të Bordit të Drejtorëve janë rekrutuar:
 - Drejtori Menaxhues;
 - Zëvendësdrejtor Menaxhues – shitje;
 - Zëvendësdrejtor Menaxhues – likuidimi.
- Me vendim të Menaxhmentit janë rekrutuar dy Zyrtarë Kadastral në ZR Gjilan dhe ZR Mitrovicë;
- Kanë dhënë dorëheqje dy (2) zyrtarë të AKP-së.

Trajnimet dhe të tjera

- Gjatë periudhës raportuese janë ndjekur Trajnime dhe programe certifikuese për 75 zyrtarë të AKP-së;
- Është finalizuar raporti i planit të trajnimeve të Menaxhmenti i AKP-së dhe raporti për vlerësim të performancës;
- Raporte mbi vlerësimin e aktiviteteve zhvillimore.

5.4.2 DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Departamenti i Prokurimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 ka nënshkruar **65** kontrata duke përdorur të gjitha procedurat e prokurimit:

- Procedura e prokurimit me vlerë të madhe;

- Procedura e prokurimit me vlerë të mesme;
- Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë; si dhe
- Procedura e kuotimit të çmimit me vlerë të vogël dhe vlerë minimale.

Me poshtë gjeni ndarjen e kontratave sipas kategorive:

- **Kontratë për shërbime** - janë realizuar gjithsej **35**;
- **Kontratë për furnizime** - janë realizuar gjithsej **29**;
- **Kontratë për punë** - është realizuar **1** kontratë.

Vlera e përgjithshme e kontratave është **EUR 4,477,365.92**.

Vlenë të theksohet se gjatë periudhës raportuese është nënshkruar edhe kontrata me Kompaninë për Ofrim të Shërbimit Profesional për realizim të Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj.

5.4.3 ADMINISTRATA

Aktivitetet kryesore për këtë periudhë të raportimit paraqiten për njësitë: Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme, Njësia e Arkivit, Njësia e Përkthimeve, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Protokollit dhe Zyra e Transportit.

Më poshtë janë paraqitur përmbledhje e aktiviteteve të kryera:

- Janë përkthyer 983 dokumente me 6,178 faqe dhe ka siguruar përkthyesit për 31 takime.
- Njësia e Protokollit: Dokumente hyrëse në këtë zyre 4,801 shkresa. Shkresa dalëse janë regjistruar 4,412. Të regjistruara në sistem hyrje/dalje janë 7032;
- Arkivimin dhe ruajtjen në sistemin e arkivës të 551 regjistratoreve;
- Riparime të ndryshme prej 389;
- Servisimin dhe mirëmbajtjen e veturave – 71 vetura janë servisuar dhe vazhdon servisi i tyre dhe kontrollit sipas nevojës në mënyrë që të plotësohen të gjitha kërkesat e stafit të AKP-së lidhur me transportin. Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 1010 kërkesa për shërbime të rregullta dhe 1324 shërbime-kërkesa urgjente dhe të cilat janë mbuluar po ashtu;
- Shërbimet e ofruara nga stafi i IT-së; Mirëmbajtja e “Server-Room”, avancimi i “Back up” sistemit dhe shërbime të tjera të nevojshme.

5.4.4 MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka siguruar përkrahje të plotë për të gjitha aktivitetet e realizuara nga AKP, institucioneve të shtetit dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare, përgatitja e komunikatave për media lidhur me takimet me institucione ndërkombëtare dhe vendore, odat ekonomike dhe delegacione të ndryshme, përgatitja e komunikatave për media dhe publikimin në ueb faqen e Agjencisë dhe mediat sociale (Facebook, Twitter dhe Instagram).

Njësia ka pasqyruar aktivitetet e Agjencisë tek mediat dhe opinioni i gjerë, duke prezantuar aktivitetet dhe qëndrimet e Agjencisë në media.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka përgatitur rreth **250** përgjigje me shkrim të dërguara përmes e-mailit në pyetje të gazetarëve të medieve të ndryshme:

- Prononcime përmes telefonit – mbi **30** prononcime me telefon;
- Përgjigje dhe prononcime në **Televizione** - rreth **10** prononcimet në TV);
- Përgjigje dhe prononcime në **Radio** - rreth **20** prononcime për radiot vendore dhe ndërkombëtare;
- Njësia për Marrëdhënie me Publikun dhe Media gjatë vitit 2016 ka hartuar dhe dërguar për media dhe përmes tyre tek opinioni i gjerë mbi **40 Komunikata për Media** për aktivitetet e ndryshme të

Agjencisë, ndërkaq ka lëshuar **4 Komunikata** në formë sqarimi/reagimi ndaj shkrimeve/deklaratave dezinformuese për Agjencinë;

- Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka vazhduar të populloj ueb faqen e AKP-së dhe të rretjeve sociale: facebook, twitter dhe instagram me të gjitha informatat në lidhje me aktivitetet e Agjencisë dhe procesin e privatizimit në Kosovë.

Marrëdhënie me Publik dhe Qasje në dokumente Publike

Janë përgatitur raporte të rregullta (çdo tre muaj) dhe këto raporte i janë dërguar njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit, e cila përgatit raportin gjithëpërfshirës të institucioneve publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

5.4.5 DEPARTAMENTI LIGJOR

Në vazhdim po ju paraqesim raportin gjithëpërfshirës të lëndëve dhe veprimeve procedurale si vijon:

- Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar: 1422;
- Veprimet procedurale të ndërmarra në lëndë:
 - Mbrojtje në padi 1380; Kundërpërgjigje 218; Përgjigje në masë të përkohshme 22; Ankesë 31; Përgjigje në ankesë 67; Parashtresë 45; Padi 2; Seanca Gjyqësore 109; Përgjigje në urdhër 88; Aktvendim 62; Aktgjykim 55.

Sa i përket listave të punëtorëve, në vazhdim paraqesim raportin e lëndëve dhe veprimeve procedurale të ndërmarra nga njësia e përfaqësimeve gjyqësore:

- Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar: 475;
- Veprimet procedurale të ndërmarra në lëndë:
 - Përgjigje në urdhër 49; Pjesëmarrje në seancë gjyqësore 17; Ankesa 91; Aktgjykim 115; Përgjigje në ankesë 13; Parashtresa 100; Aktvendim 81; Vërejtje për pagim të taksave gjyqësore 26.

Njësia e Opinioneve Ligjore (NJOL)

Njësia e Opinioneve Ligjore (NJOL) ka zhvilluar aktivitete të ndryshme, por që kryesisht konsistojnë në dhënien e mendimeve dhe këshillave ligjore, hartimin e dokumenteve juridike, rregulloreve apo akteve tjera juridike, si dhe pjesëmarrjen në takimet e ndryshme.

Përmbledhja e aktiviteteve të NJOL gjatë periudhës raportuese, është paraqitur më poshtë:

- Opinione Ligjore të kërkuara me Kërkesë për Veprim apo nga Menaxhmenti25;
- Hartimi, shqyrtimi apo analizimi i dokumenteve të ndryshme115;
- Takimet në të cilat është kërkuar pjesëmarrja e zyrtarëve ligjorë128.

Njësia për Regjistrimin e Kërkesave (NJRK)

Gjatë periudhës një vjeçare 1 Janar - 31 Dhjetor 2016, në Njësinë për Ankesa të Departamentit Ligjor, në Librin intern të protokollit të Njesisë për ankesa janë regjistruar gjithsej 7.277 parashtresa hyrëse dhe dalëse. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave/shkresave hyrëse të pranuar dhe të regjistruara nga Njësia e Ankesave 3.835; prej tyre janë pranuar rreth 1.422 kërkesa/lëndë të reja dhe 2.413 dokumente/parashtresa shtesë lidhur me lëndët ekzistuese të cilat janë regjistruara më herët.

5.5 NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) me sukses ka arritur që të përmbushë planin e vet të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2016, duke i ofruar menaxhmentit të lartë rekomandime konkrete.

Në vazhdimësi paraqiten aktivitetet e NJAB-së gjatë kësaj periudhe:

1. Auditimi i Departamentit të Koordinimit të Likuidimit (DKL) dhe Autoriteteve të Likuidimit (AL);
2. Auditimi i Divizionit të Shitjes, përkatësisht Njesisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes;
3. Auditimi i Njesisë së Burimeve Njerëzore (NJBNI);
4. Auditimi i Departamentit të Koordinimit të Likuidimit (Njësia e Monitorimit të Likuidimit dhe Fondet e Mbetura, Njësia e Likuidimit dhe Njësia e Listave të Punëtorëve);
5. Auditimi i Departamentit të Prokurimit (DP);
6. Auditimi i Departamentit të Koordinimit Rajonal (ZR e Prishtinës);
7. Auditimi i Njesisë së Administrimit Direkt (NJAD);
8. Auditimi i Departamentit të Financave (Menaxhimi i Fondeve në Mirëbesim);
9. Auditimi i Autoriteteve të Likuidimit (AL);
10. **Auditimi mbi Përcjelljen e Implementimit të Rekomandimeve:** Ky auditim ka përfshirë përcjelljen e implementimit të rekomandimeve për auditimet e kryera gjatë periudhës 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 si dhe nëntëmujorin e vitit 2016. NJAB, ka bërë përcjelljen e 128 rekomandimeve, nga të cilat ka arritur të kuptoj se 46 rekomandime janë implementuar plotësisht apo 36% e totalit, 60 rekomandime të dhëna janë implementuar pjesërisht apo 47%, si dhe 22 rekomandime nuk ishin implementuar, apo shprehur në përqindje rreth 17%. Vlenë të theksohet se Drejtori i NJAB-it së bashku me Menaxhmentin dhe Kryesuesin e Komitetit të Auditimit janë dakorduar që disa rekomandime të cilat janë tejkaluar (amortizuar me kohë), të hiqen nga përcjellja e implementimit;
Periudha raportuese për pasqyrat financiare është prej 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2016. Në këto pasqyra financiare janë paraqitur edhe raporte që paraqesin të dhënat financiare nga data 1 Korrik 2003 deri më 31 Dhjetor 2016.

Pasqyrat Financiare janë për Fondet në Mirëbesim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenin 20 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit kontrollohet nga Bordi i Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. AKP i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza vjetore.

3. RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË

AKP-ja menaxhon dhe i kontrollon shpenzimet dhe të hyrat e fondeve në mirëbesim përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP-ja bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi i urdhër-transfereve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së.

4. VALUTA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në raportin përkatës.

5. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë autorizuar për lëshim më datën 30 Janar 2017 nga: Ekrem Hajdari, Drejtor Menaxhues dhe Adem Selishta, U.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

6. FORMATI DHE LIDHJA E PASQYRAVE FINANCIARE ME SHËNIMET SHPJEGUSE

Ashtu siç është cekur edhe më lartë, pasqyrat financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) janë përgatitur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme - Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Prandaj, pasqyrat financiare përgatiten sipas parasë së gatshme, llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme dhe llogaritë (detyrimet kontingjente) janë paraqitur si shpalosje në pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim.

Gjatë leximit të pasqyrave financiare, ju mund t'i referoheni edhe shtojcës së pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim. Shtojca e pasqyrave financiare paraqet bilancet përfundimtare më 31 Dhjetor 2015, transaksionet e ndodhura gjatë periudhës raportuese 1 Janar - 31 Dhjetor 2016. Këto raporte, paraqesin kategorizimet sipas planit kontabël të fondeve në mirëbesim të transaksioneve bankare në llogaritë bankare të cilat administrohen nga AKP-ja për NSh-të përkatëse dhe të tjera.

Shtojca e pasqyrave financiare do t'i dorëzohet vetëm Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Menaxhmentit dhe Departamenteve/Njësive të AKP-së.

TË HYRAT

2. TË HYRAT NGA SHITJA

Të hyrat e realizuara nga shitja përbëjnë bilancet përfundimtare më 31 Dhjetor 2016 të hyrjeve dhe daljeve në llogaritë bankare të Ndërmarrjeve Shoqërore (fondet në mirëbesim) të cilat administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Pasqyra e gjendjes së Fondeve në Mirëbesim pasqyron gjendjen bankare më 31 Dhjetor 2015, gjendje e transaksioneve Hyrje/Dalse gjatë periudhës 1 Janar – 31 Dhjetor 2016 dhe gjendjen përfundimtare bankare më 31 Dhjetor 2016.

Të hyrat e realizuara nga shitjet janë:

1. Shitjet e realizuara përmes valëve të privatizimit dhe likuidimit nga AKP-ja;
2. Shitjet e realizuara nga Administrata Tatimore e Kosovës; dhe
3. Shitjet e tjera të realizuara nga NSh-të në tranzicion

2.1. SHITJET E REALIZUARA PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT DHE LIKUIDIMIT NGA AKP

Janë pagesat e realizuara nga shitjet e aseteve të NSh-ve për të cilat janë nënshkruar kontratat me blerësit dhe pagesat e realizuara për shitjet që janë ende në proces të nënshkrimit të kontratave.

Gjatë periudhës raportuese kemi realizuar të hyra në vlerën prej EUR 1,144,120 siç janë paraqitur më poshtë:

- 2.1.1. Gjithsej pagesat e realizuara prej EUR 969,148 në shitjen e Ndërmarrjeve të Reja përmes valëve të privatizimit:
 - Ndërmarrjet e Reja janë themeluar nga asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore për të cilat veç e veç janë hapur llogaritë bankare, në të cilat janë realizuar pagesat nga blerësit e këtyre aseteve. Gjatë periudhës raportuese është realizuar pagesa prej EUR 951,000 si rezultat i heqjes së masës së përkohshme nga Gjykata për shitjen e valës 42 në vitin 2010. Kjo shumë është paraqitur si llogari e arkëtueshme deri më 31 Dhjetor 2015 (shih llogaritë e arkëtueshme); dhe
 - Pagesa prej EUR 18,148 shtesë për shitjen e Ndërmarrjes së Re “KB Shtime Zyra Administrative” në valën 42. Shuma shtesë është sipas vendimit të Bordit të Drejtofëve më datën 23 dhe 24 Nëntor 2016
- 2.1.2. Të hyrat nga shitja e aseteve të mbetura përmes procesit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar pagesa/transaksione prej EUR 71,150. Këto kanë të bëjnë për rastet si më poshtë:
 - Bartjen e BID depozitit prej EUR 10,000 nga llogaria e BID depozitave të likuidimit në llogari të ndërmarrjes Shoqërore. Bartja e BID depozitit bëhet nga AKP, pas realizimit të nënshkrimit të kontratave me blerësit. Kjo shitje ka qenë e viteve paraprake, por në 2016 është nënshkruar kontrata me blerësinë;
 - Gjithsej pagesat e realizuar prej EUR 61,150 nga fituesit e përkohshëm për valën 27 të shitjes përmes valëve të likuidimit.
- 2.1.3. Të hyrat e realizuara nga bartja e të drejtës banesore të Ndërmarrjeve Shoqërore. Këto pagesa realizohen në përputhje me Ligjin nr. 04/L-061. Gjatë kësaj periudhe, gjithsej të hyrat e realizuara janë EUR 103,822.

Shënim: Agjencia Kosovare e Privatizimit është e ngarkuar për të privatizuar Ndërmarrjet Shoqërore dhe asetet e sajë në Kosovë përmes metodës së spin-off-it dhe likuidimit. AKP përmes tenderit të hapur dhe konkurrues, ka bërë shpalljen e shitjes 27 për disa asete në likuidim më 7 dhjetor 2016. Të gjitha shitjet e SHA janë të aprovuara nga Bordi i AKP-së që do të ndikojnë në rritjen e llogarive të arkëtueshme në vlerën prej EUR 5,177,254. Për më tepër, shih llogaritë e arkëtueshme.

2.2. SHITJET E REALIZURA NGA ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

Shitjet e realizuara nga ATK-ja janë rastet kur vlera e shitjes është më e madhe se ajo e barrës tatimore të vendosur nga ana e ATK-së. Organizimi dhe metodologjia e këtyre shitjeve organizohet nga ana e ATK-së.

Administrata Tatimore e Kosovës në të kaluarën ka realizuar shitjen e aseteve si rezultat i barrës tatimore të vendosur nga ana e saj në asetet përkatëse të NSh-ve në tranzicion. Ndërsa pjesë e mbetur, pas realizimit të barrës tatimore, nga ATK, është transferuar në llogaritë e NSh-ve të AKP-së. Gjithsej vlera e paguar në total e këtyre rasteve është EUR 1,686,063.

Gjatë vitit 2016, nuk ka pasur raste të shitjeve të aseteve nga ana e ATK-së.

2.3. SHITJET E REALIZUARA NGA NDËRMARRJET SHOQËRORE NË TRANZICION

Nga viti 2008, nuk ka pasur të hyra në llogaritë e Ndërmarrjeve Shoqërore në tranzicion.

3. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË

Janë dhënia me qira e aseteve të NSh-ve në tranzicion dhe NSh-ve në likuidim. Në përgjithësi dhënia e aseteve me qira për këto NSh janë: lokalet, toka bujqësore, pikat e shitjes të derivateve, depot dhe të tjera.

Nga viti 2003 deri në periudhën raportuese, të hyra të realizuara nga dhënia me qira të aseteve janë në vlerën prej EUR 21,013,125:

- Nga llogaritë e NSh-ve në tranzicion në shumën prej EUR 10,637,921;
- Nga llogaritë e NSh-ve në likuidim në shumën prej EUR 10,375,204.

Ndërsa, vetëm gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2016, janë inkasuar të hyra nga qiraja në vlerë prej EUR **6,137,570** (në detaje në pikën 3.1 dhe 3.2) më poshtë:

1. Qiraja e inkasuar për NSh-të në likuidim prej EUR 5,226,852.
2. Qiraja e inkasuar për NSh-të në tranzicion prej EUR 910,718.

Vlenë për të theksuar se krahasuar me vitet paraprahe, inkasimin nga të hyrat e qirasë janë rritur në përqindje shumë të lartë.

3.1. QIRAJA E NSH-ve NË LIKUIDIM

Të hyrat e realizuara prej EUR **5,226,852** janë për NSh-të e mëposhtme:

3.1.1. Gjithsej të hyrat e realizuar nga qiraja prej EUR 2,239,286 për NSh-të të cilat kanë vazhduar aktivitetin e tyre pas hyrjes në likuidim. Këto NSh janë:

- Tregu, gjithsej EUR 651,978
- ABC Genci, gjithsej EUR 116,364
- Pallati, gjithsej EUR 1,039,326
- Grand Hotel, gjithsej EUR 431,618

3.1.2. Gjithsej të hyrat e realizuar në vlerën prej EUR 2,987,566 nga qiraja për ndonjë aset të lëshuar nga NSh-ja në likuidim që nuk kanë aktivitetet të përditshëm ekonomik.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur regionet dhe numri i NSh-ve për të cilat janë paguar qiratë në të mirë të llogarive bankare të NSh-ve në likuidim.

Tabela e 3.1. Gjithsej të hyrat e inkasuar nga qiraja për vitin 2016

MUAJI	GJILAN	MITROVICA	PEJA	PRISHTINA	PRIZRENI	GJITHSEJ
JANAR	2,909	9,160	12,815	185,491	13,689	224,064
SHKURT	5,386	16,948	14,101	212,301	9,935	258,671
MARS	11,566	24,737	22,778	203,545	11,546	274,172
PRILL	5,564	16,149	26,173	175,482	5,163	228,531
MAJ	3,969	21,384	29,159	328,238	8,491	391,241
QERSHOR	5,820	17,555	15,100	265,780	16,322	320,577
KORRIK	4,450	11,386	21,482	383,750	7,307	428,375
GUSHT	8,919	14,701	22,441	312,325	8,095	366,481
SHTATOR	6,253	18,788	21,788	305,166	35,085	387,080
TETOR	5,664	12,836	26,362	358,351	11,119	414,332
NËNTOR	8,969	979,542	19,354	344,618	26,078	1,378,561
DHJETOR	11,261	26,941	27,481	457,080	32,003	554,766
GJITHSEJ SHUMA	80,730	1,170,127	259,034	3,532,127	184,833	5,226,851
NUMRI I NSH-VE	19	14	32	41	23	129

Sa i përket Rajonit të Mitrovicës, kemi pranuar të hyra prej EUR 915,063.4 nga shfrytëzimi i objektit nga UNMIK-u. Pagesa është realizuar në Nëntor 2016 për qiranë e papaguar ndërvite.

Vlera e qirasë është përcaktuar nga UNMIK-u, pa ndonjë komunikim zyrtar me AKP-në, por sipas informatave që ka marrë Zyra Regjionale e Mitrovicës, standardi i përcaktuar për vlerën e qirasë nga UNMIK është marrë nga vitet 2005 dhe 2006. Përmes insistimit të Agjencisë mjetet për shfrytëzimin e qiras janë kërkuar nga ish-Menaxhmenti i NSh-së Jugobankes të UNMIK-u, pasi AKP-në si institucion, kjo organizat ende nuk e njehë.

3.2. QIRAJA E NSH-ve NË TRANZICION

Gjithsej janë 16 NSh në tranzicion për të cilat është inkasuar qira. Gjithashtu në të hyrat e përgjithshme janë të përfshirë edhe tri pagesa, në total prej EUR 9,910 që janë bartur nga llogaria bankare e “Pallatit I Rinisë” gjatë periudhës kur ka qenë në tranzicion. Pallati i Rinisë është në likuidim, mirëpo qiramarrësit kanë paguar mjetet në të mirë të llogarisë, e cila, para se të hyjë në likuidim ka qenë llogari bankare e tranzicionit. Këto mjete do të barten në llogarin bankare të NSh-së në likuidim.

Gjithsej të hyrat e realizuara për periudhën Janar – Dhjetor 2016 është në vlerën prej EUR 910,718

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura inkasimet e qirave për NSh-të për të cilat kanë realizuar qarkullimin vjetor të inkasimeve për vitin 2016 mbi EUR 10,000 dhe atë:

1. NSh Jugopetroll – ZR Prishtinë, shuma totale e inkasuar prej EUR 355,559;
2. NSh Treska – ZR Mitrovicë, shuma totale e inkasuar prej EUR 15,050;
3. NSh Borovo – ZR Mitrovicë, shuma totale e inkasuar prej EUR 21,360;
4. NSh Ina – ZR Prishtinë, shuma totale e inkasuar prej EUR 482,527; dhe
5. NSh-të e tjera, shuma totale prej EUR 36,222

4. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË E KOMERCIALIZIMIT

Mban paratë e paguara nga qiratë për kontratat e komercializimit të nënshkruara gjatë vitit 2000 nga UNMIK. Vlera e tërësishme e inkasimeve deri në datën raportuese është EUR 5,021,319.

Gjatë këtij viti fiskal 2016 nuk kemi pasur inkasime të qirave të Ndërmarrjeve nga komercializimi sepse nuk ka kontrata në fuqi të komercializimit.

5. INTERESI I FITUAR

Të hyrat nga interesi janë:

- interesi i fituar nga llogaritë rrjedhëse në Bankën Qendrore të Kosovës. Nga Korrik 2012, norma e aplikuar e interesit nga BQK është zero%;
- interesi bankar i fituar nga afatizimi për periudhat nga 1 muaj deri në 12 muaj i një pjese të mjeteve nga llogaritë bankare të fondeve në mirëbesim.

Gjithsej interesi i përgjithshëm i fituar nga viti 2003 deri në datën raportuese është EUR 34,844,700 në të gjitha llogaritë bankare të hapura në BQK.

Për vitin fiskal 2016, nuk ka pasur të hyra nga interesi për shkak të normave të cilat nuk janë pozitive.

6. TARIFA PËR PJESËMARRJEN E TENDERËVE TË SHITJES

Në përgjithësi, këto të hyra përfshijnë llogaritë bankare nga të cilat janë gjeneruar të hyra nga tarifat për paraqitjen e tenderëve apo konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve të cilët nuk i kanë përmbushur kushtet e pagesës. Llogaritë janë si më poshtë:

- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të privatizimit;

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

- Tarifa për dorëzimin e ofertave të privatizimit;
- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të likuidimit; dhe
- Tarifa për dorëzimin e ofertave të likuidimit

Gjatë kësaj periudhe raportuese ngjarjet janë si më poshtë:

1. Bilanci bankar deri më 31 Dhjetor 2015 është EUR 7,512,464;
2. **PLUS** - gjendjen bankare(hyrjeve dhe daljeve) të depozitave prej EUR 602,320 në llogarinë e depozitave të Likuidimit, për të cilat kanë paguar ofertuesit për pjesëmarrjen e valës 27 “Shitja e Aseteve përmes Likuidimit”. Gjithashtu për këtë ngjarje, referoju shënimit shpjegues nr. 20 të llogarive të arkëtueshme;
3. **PLUS** – Shuma prej EUR 65,100, të hyra nga tarifa për pjesëmarrjen e tenderëve. Këto janë bilancet e e hyrjeve dhe daljeve të llogarisë të tarifës për pjesëmarrje të tenderit të valës 27.
4. **MINUS** – bartjen e BID depozitave në llogaritë e likuidimit në shumën prej EUR 10,000 pas nënshkrimit të kontratës (shih shënimin shpjegues nr. 2 “Të hyrat nga Shitja”, përkatësisht 2.1.1)
5. **GJITHSEJ** – gjendja e tarifës/depozitave për pjesëmarrje të tenderëve EUR **8,169,884**.

Shuma prej EUR 8,169,884 paraqet gjendjen e transaksioneve bankare nga viti 2003 deri më 31 Dhjetor 2016.

7. TË HYRAT E TJERA

Janë të hyrat të cilat janë realizuar në llogaritë e NSh-ve në tranzicion, NSh-ve në likuidim, Donatorëve dhe të tjerë në vlerën prej EUR 6,707,317.

Nga viti 2003 këto të hyra trajtojnë inkasimet në llogaritë e sipër shënuara:

- Shitja e mallrave dhe shërbimeve;
- Dividenta dhe shitja e aksioneve;
- Transferimi i mjeteve nga llogaritë bankare të NSh-ve të cilat kanë qenë aktive në bankat komerciale
- NSht-të e paraqitur si kreditor

Gjatë periudhes raportuese Janar – Dhjetor 2016, janë realizuar të hyrat prej EUR 1,584,217 si më poshtë:

- Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim të cilat kanë akvitetet të përditshëm siç janë: Grand Hotel dhe ABC Genci. Shuma e realizuar është EUR 169,883;
- NSh-të në likuidim për disa raste, shuma totale e të cilat është EUR 1,529;
- NSh-të në likuidim për rastet që është paraqitur si kreditor i NSh-ve të tjera në shumën prej EUR 18,979;
- NSh-të në likuidim, transferimi i gjendjeve bankare nga llogaritë tjera (komerciale) në shumën totale prej EUR 22,919;
- Nga NSh-të në tranzicion: MIM Golesh në shumën prej EUR 1,370,907 nga shitjet e realizuar në marrëveshjen me “Bechtel & Enka”.

8. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-034, Agjencia ka hapur llogarinë bankare për kapitalin themeltar. Gjithsej vlera e kapitalit themeltar është EUR 10,000,000.00, ndërsa shuma e transferuar nga Qeveria është EUR 1,000,000.00. Pjesa e mbetur mund të kërkohet nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së në kohën dhe në shumën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Më poshtë janë të paraqitura detajet e kapitalit themeltar për të gjitha transaksionet nga viti 2003 deri më 31 Dhjetor 2016:

- **Të hyrat në llogarinë e kapitalit prej EUR 1,132,172**
 - Të hyra nga pagesa e kapitalit themeltar prej EUR 1,013,200. Pagesa është realizuar nga Qeveria e Kosovës;
 - Të hyrat nga interesi prej EUR 118,972. Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 5.
- **Pagesat nga llogaria e kapitalit prej EUR 22,623**
 - Pagesat e vendimeve të Gjykatave prej EUR 22,616. Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 14.
 - Shpenzimet bankare prej EUR 7.00. Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 16
- **Gjendja bankare në fund të periudhës 1,109,549**

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur asnjë transaksion bankar nga llogaria e kapitalit bankar.

SHPENZIMET/SHPËRNDARJA

9. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK

Nga viti 2003 deri në periudhën raportuese shuma e transferuar e 20% në llogarinë e BSPK-së është EUR 109,973,567 në të mirë të punëtorëve të NSh-ve

Për periudhën raportuese, gjithsej shuma e transferuar në të mirë të llogarisë bankare të BSPK-së është EUR 5,728,413 dhe atë nga llogaritë bankare të 93 Ndërmarrjeve Shoqërore si më poshtë:

- Llogaritë e Privatizimit - Shitjet e Ndërmarrjeve të Reja të themeluara nga asetet e NSh-ve. Shuma e transferuar në total është EUR 761,349;
- Llogaritë e Likuidimit - Shitjet e aseteve dhe aseteve të mbetura përmes procesit të likuidimit. Shuma e transferuar në total është EUR 374,444;
- Llogaritë e Tranzicionit, nuk ka;
- Llogaritë në mirëbesim për punëtorët e NSh-ve. Shuma e transferuar në total është EUR 4,592,620

10. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Më 11 korrik 2012 është kontraktuar kompania për Ofruesin e Shërbimeve Profesionale mes AKP-së dhe Deloitte Central Europe Limited si pjesë e Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Sipas kontratës bazë janë dy lloje të pagesave: fikse (kuartale) dhe variabile. Pagesat e realizuara për kontratën e parë nga Tetor 2012 e deri në periudhën raportuese janë në vlerën prej EUR 14,008,930.

Ndërsa, pagesat e realizuar nga 8 gusht 2016 deri në datën raportuese për aneks kontratës, janë në vlerën prej EUR 415,000.

Shënimet janë paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme:

	A	B	C	D=B/A
PËRSHKRIMI	VLERA E KONTRAKTUAR	PAGESAT E REALIZUARA	SHUMA E MBETUR NGA KONTRATA	%
KONTRATA E PARË KOSTOJA FIKSE 10 Korrik 2012 - 10 Korrik 2016	4,924,740	4,924,740	0.00	100%
KONTRATA E PARË KOSTOJA VARIABILE 10 Korrik 2012 - 10 Korrik 2016	13,003,564	9,084,190	3,919,374	69.86%
10% E VLERËS SË ANEKS KONTRATËS	1,992,000	415,000	1,577,000	20.83%
GJITHSEJ	19,920,304	14,423,930	5,496,374	72.41%

*vlera e kontraktuar në tabelë përfshin edhe TVSh-në prej 16%. Norma e TVSh-së pas periudhës 1 Shtator 2015 është 18%.

Gjatë periudhës raportue Janar – Dhjetor 2016, gjithsej pagesat e realizuara ndaj OSHP janë EUR **3,713,028** dhe atë:

- nga kontrata bazë prej EUR 3,298,028; dhe
- aneks kontrata janë në total EUR 415,000

10.1. KONTRATA BAZË

Gjithsej vlera e kontraktuar me Ofruesin e Shërbimeve “Deloitte” sipas nr. të kontratës 239/11/068/211 ka qenë në shumën prej EUR 19,920,304. Afati i kontratës ka skaduar më datën **9 Korrik 2016**. Sipas kontratës në fjalë, kanë qenë dy lloje të pagesave:

1. Kosto Fikse (vlera e kontratës) në shumën prej EUR 4,912,036 e ndryshuar pastaj me normën e TVSh-së me 18% në 4,924,740 (ndryshimi vetëm prej EUR 12,704). Pagesa është realizuar pas aprovimit të raportit nga Komisionin e Bordit për aprovomini e raportëve të kontraktonit;
2. Variabile (vlera e kontratës) në shumën prej EUR 14,995,564 Sipas kontratës me Ofruesin e Shërbimeve Profesionale përveç pagesave të kostove fikse, gjithashtu janë edhe pagesat për secilin kërkesë të kreditorit të shqyrtuar (vendim/refuzim). Janë katër llojë kërkesa të kreditorëve të cilët janë kategorizuar. Secili vendim e ka shumën e kontraktuar të cilat janë:
 - 2.1. EUR 299.00 për pronësia e aseteve specifike dhe kërkesat e pronarëve – aksionarëve;
 - 2.2. EUR 99.00 për kreditorët e pasiguar, pagat e papaguara dhe tri pagat e punëtorëve

Gjatë periudhës raportuese, kostoja fikse e paguar është në vlerën prej EUR 1,731,916, ndërsa për koston variable është EUR 1,566,112. Në total janë EUR 3,298,028.

10.2. ANEKS KONTRATA - 10% E VLERËS SË KONTRATËS BAZË

Më datën 8 Gusht 2016 është nënshkruar kontrata e re si aneks i kontratës bazë në vlerën prej 10%. Vlera totale e kontraktuar është EUR 1,992,000. Sipas aneks kontratës, në periudha mujore realizohen pagesat prej EUR 83,000 për 24 periudha. Deri në datën raportuese janë është realizuar gjithsej EUR 415,000 për pesë periudha.

10.3. GARANCION BANKAR

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar një garancion bankar lidhur me performancën e aneks 2 të kontratës nga Deloitte Central Europe Limited për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale për likuidimin e portfolios së NSH-ve (nr. i prokurimit 239-11-068-211). Detajet e garancionit bankar janë si vijon: data e garancionit 21 Shtator 2016, shuma e garancionit 199,200, emri i bankës që ka lëshuar garancionin: ING Bank N.V. PO B0x 350, 1000 Amsterdam, The Netherlands.

Shënim lidhur me pagesat e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale:

Pasi që nuk janë ndarë mjetet nga Buxheti i Kosovës, deri më tani pagesat janë bërë sipas rezolutës së Bordit të Drejtorëve të datës 21 Qershor 2012, financimi i kostove të likuidimit (nenet 40.1.1.1 dhe 40.1.1.3 të Shtojcës së Ligjit të Agjencisë) bëhet si në vijim:

- a) *Tarifa fikse e Autoritetit të Likuidimit paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative¹ të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin e caktimit të saktë të koston fikse*

¹ Llogaria e tarifës administrative është llogari e hapur nga ana e AKP-së me qëllim të alokimit të mjeteve të 5% të të hyrave. Shih nenin 21 të Ligjit nr.04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

proporcionalisht për secilën ndërmarrje shoqërore në likuidim, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompenzohet nga llogaria bankare e ndërmarrjes në likuidim;

- b) *Tarifa variabile (për kërkesat e shqyrtuara) e Autoritetit të Likuidimit dhe kostot tjera të paraqitura në kostot 1.1 dhe 1.3 të nenit 40.1 të shtojcës së ligjit nr. 04/L-034 paguhen nga fondet e ndërmarrjes në likuidim. Në rast se ende nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit, atëherë tarifa variabile paguhet për kohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompenzohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.*

11. MALLRA DHE SHËRBIME

Nga viti 2003 deri në datën raportuese gjithsej pagesat e realizura për mallra dhe shërbime janë në vlerën prej EUR 12,186,335.

Për periudhën raportuese, pagesat e realizuara janë në vlerën prej EUR **2,389,461**.

Në përgjithësi në këtë kategori përfshihen pagesat për: Pagesat ndaj Ofruesve të Shërbimeve për NSh në Likuidim dhe Pagat e Punëtorëve – NSh në tranzicion; qiraja; shpenzime për reklamim; shërbime profesionale dhe mirëmbajtja dhe ruajtja e aseteve

Këto pagesa janë realizuar nga llogaritë e NSh-ve në tranzicion, likuidim dhe tarifa administrative e Agjencisë.

11.1.PAGESAT NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

Angazhimi i ofruesve të shërbimeve bëhet në përputhje me procedurat të aprovuar nga Menaxhmenti i AKP-së. Përveç procedurave, për rastet e NSh-ve në likuidim, këto shpenzime janë të lejuara sipas kornizës buxhetore të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve. Korniza buxhetore përfshinë 29 lloje të shpenzimeve, brenda të cilave është edhe angazhimi i ofruesve të shërbimeve. Gjithsesi, përveç kornizës buxhetore të llojeve të shpenzimeve të lejuara, me aprovim të Bordit caktohet edhe kufiri maksimal i shumës së buxhetuar për shpenzim për 29 kode gjithsej.

Angazhimi i ofruesve të shërbimeve kryesisht bëhet për: arkivat dhe grumbullimin e dokumentacionit për listat e 20% të punëtorëve, kërkesat e kreditorëve, asistencë në identifikimin e aseteve dhe rastet e tjera.

Githashtu, angazhimi i ofruesve të shërbimeve është për mbarëvajtjen e punës për NSh-të komplekse të cilat kanë vazhduar aktivitetin e tyre pas hyrjes në likuidim të tilla si: Pallati, Grandi, ABC Genci, Tregu dhe MIM Golesh.

Sipas procedurës, për të angazhuar Ofrues të Shërbimeve për NSh përkatëse, përparësi kanë ish-punëtorët e atyre Ndërmarrjeve Shoqërore.

Gjithsej, pagesat e realizuara për Ofruesit e Shërbimeve për periudhën raportuese janë EUR **1,321,813**. Më poshtë i paraqesim pagesat për NSh-të e mëdha që kanë aktivitete duke i përfshirë edhe NSh-të e tjera me pagesat e mëdha:

1. Për NSh MIM Golesh, gjithsej pagesat e realizuar janë në vlerë prej EUR 116,869, duke filluar nga periudha e muajit Nëntor – Dhjetor 2016. Numri i punëtorëve 46 për të cilët është paguar.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

2. Për NSh Jugopetrol, gjithsej pagesat prej EUR 11,619, duke filluar nga periudha e muajit Korrik – Dhjetor 2016. Numri i punëtorëve të angazhuar është 24 për të cilët janë bërë pagesa.
3. Për NSh në likuidim Tregu, gjithsej pagesat e realizuara prej EUR 273,184. Pagesat përfshijnë periudhat Nëntor – Dhjetor 2015 dhe Janar – Dhjetor 2016. Gjithsej numri i punëtorëve të angazhuar është 101 për të cilët janë paguar.
4. Për NSh në likuidim Grand Hotel, gjithsej pagesat e realizuara prej EUR 170,440. Pagesat përfshijnë periudhat Janar – Dhjetor 2016. Gjithsej numri i punëtorëve të angazhuar është 84 për të cilët janë paguar.
5. Për NSh në likuidim Pallati i Rinisë, Kulturës dhe Sportit, gjithsej pagesat e realizuara prej EUR 365,201. Pagesat përfshijnë periudhat Maj – Dhjetor 2016. Gjithsej numri i punëtorëve të angazhuar është 115 për të cilët janë paguar.
6. Për NSh në likuidim ABC Genci, gjithsej pagesat e realizuara prej EUR 83,484. Pagesat përfshijnë periudhat Janar – Dhjetor 2016. Gjithsej numri i punëtorëve të angazhuar është 19 për të cilët janë paguar.
7. Për NSh në likuidim Bankos, gjithsej pagesat e realizuara prej EUR 50,810. Pagesat përfshijnë periudhat Janar – Dhjetor 2016. Gjithsej numri i punëtorëve të angazhuar është 15 për të cilët janë paguar.
8. Për NSh në likuidim IMN Kosova, gjithsej pagesat e realizuara prej EUR 37,425. Pagesat përfshijnë periudhat Dhjetor 2015 – Dhjetor 2016. Gjithsej numri i punëtorëve të angazhuar është 10 për të cilët janë paguar.
9. Për NSh në likuidim Rilindja Grafike, gjithsej pagesat e realizuara prej EUR 58,326. Pagesat përfshijnë periudhat Nëntor 2015 (një rast) dhe Janar – Dhjetor 2016. Gjithsej numri i punëtorëve të angazhuar është 21 për të cilët janë paguar.
10. Rastet e tjera për shumë NSh që janë paguar për periudhën raportuese është në vlerë EUR 154,455, numri i punëtorëve të angazhuar është 135.

Sa i përket numrit të punëtorëve të NSh-ve të shënuar më lartë, ky numër ka ndryshuar në periudhat e ndryshme gjatë vitit fiskal 2016, cili nuk ka tejkaluar numrin e punëtorëve të lartë shënuar.

11.2. PAGESAT PËR RUAJTJEJN E ASETEVE TË NSh-ve

Ashtu siç është shpalosur në shënimin shpjegues nr. 10.1 edhe ruajtja e aseteve është kategori që mund të buxhetohet për shpenzim.

Gjatë periudhës raportuese, gjithsej janë realizuar EUR **471,955** për ruajtjen e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim dhe tranzicion. Pagesat janë realizuar ndaj operatorit ekonomik me të cilin AKP-ja ka lidhur kontratë për ruajtjen e aseteve të ndërmarrjeve Shoqërore.

Gjatë periudhës raportuese, pagesat prej EUR 471,955 janë për asetet e 30 Ndërmarrjeve Shoqërore. Pagesat janë realizuar sipas kontratës për periudhën deri më 30 Tetor 2016. Pas kësaj date, për disa raste edhe më herët, janë angazhuar ofruesit e shërbimeve për ruajtjen e aseteve të NSh-ve përkatëse.

Për Zyrat Rajonale dhe Zyrën Qendrore e AKP-së për ruajtjen e objektiteve, pagesat janë realizuar nga buxheti i të hyrave të dedikuara të AKP-së. Këto të dhëna janë të shpalosura në pasqyrat financiare të Buxhetit të AKP.

11.3. PAGESAT TË NDRYSHME OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE PËR NSH-TË PËRKATËSE

Për periudhën raportuese, më poshtë janë të paraqitura pagesat e realizuara në total prej EUR 595,693:

1. Pagesa për mallra, furnizim me ushqim dhe pije për të operuar me bifenë në Grand Hotel, gjithsej EUR 35,433;
2. Furnizim me material administrativ, kompjuter dhe tjera, kryesisht për NSH-të që janë aktive (Grandi, Pallati etj). Gjithsej shuma prej EUR 7,588;
3. Qiraja e paguar për shfrytëzim të pronës (pronësia e përbashkët) në të cilën operon NSH Tregu (NSH aktive), gjithsej EUR 41,999;
4. Pagesa ndaj Komisionit për Miniera dhe Minerale për licensën për gërmimin e minierave për MIM Golesh në shumën prej EUR 126,069
5. Pagesat prej EUR 60,808 për shërbime profesionale për përmbaruesit privat dhe angazhimet për ekspertizë gjeodezike;
6. Shërbimet e pranuar janë në vlerë prej EUR 81,916 për reklamat, pagesat ndaj studiove të filmave të blerë për ABC Genci;
7. Pagesa në vlerë prej EUR 76,890 janë bërë për ngrohje qendrore për Pallatin dhe Grand Hotelin. Kjo kategori i përket shërmive komunalive;
8. Transferimin e mjeteve për garancion bankar për MIM Golesh në shumën prej EUR 64,467. Gjithsej këto mjetet janë të MIM Golesh, mirëpo janë transferuar në llogarinë e bankës komerciale “Procredit Bank” sipas ligjit për “Miniera dhe Minerale”.
9. Shpenzimet nga para e imët prej dhe udhëtime zyrtare prej EUR 31,827;
10. Shpenzimet ndaj KEDS-it prej EUR 25,785. Këto janë paguar nga tarifa administrative për shërbime komunale.
11. Raste të tjera në total prej EUR 42,911

12. SHËRBIMET PUBLIKE

Pagesat e realizuara për shërbimet publike (rrymë, ujë, telefoni) kanë të bëjnë me Ndërmarrjet Shoqërore në tranzicion dhe në Likuidim.

Shuma e paguar gjatë vitit 2016 për shërbimet publike është EUR 435,117 të cilat janë si më poshtë:

- Nga llogaritë e ndërmarrjeve në likuidim, gjithsej shuma e paguar EUR 428,613;
- Nga llogaritë e ndërmarrjeve në tranzicion, gjithsej shuma e paguar EUR 6,504.

Sipas llojeve të shpenzimeve janë si më poshtë:

- Shpenzime për furnizim me ujë në shumën prej EUR 44,826;
- Shpenzimet për rrymë prej EUR 289,003
- Shpenzime për pastrimin e mbeturinave prej EUR 95,080; dhe
- Shërbimet e telekomunikimit prej EUR 6,209

13. TATIMET

Pagesat e tatimeve bëhen për NSh-të në tranzicion dhe në likuidim për të hyrat e inkasuara nga qiraja (TVSh dhe tatimi nga fitimi në qira) dhe mbajtja në burim e tatimeve dhe kontributeve për pagesat e OSh-ve.

Gjatë periudhës raportuese, pagesat e realizuara në Administratën Tatimore të Kosovës janë EUR 930,582:

- Nga ndërmarrjet në likuidim, gjithsej shuma e paguar EUR 537,286;
- Nga ndërmarrjet në tranzicion, gjithsej shuma e paguar EUR 393,296.

14. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE (DEPOZITA DHE TAKSA)

Gjatë periudhës raportuese 2016 janë realizuar pagesat në vlerën prej EUR 34,806 të cilat kanë të bëjnë me rastet e mëposhtme:

- taksave gjyqësore; dhe
- për angazhimin e përmbaruesve për inkasimin e obligimeve të papaguara nga palët e treta për shfrytëzimin e aseteve të disa NSh-ve në tranzicion.

15. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-së

Agjencia Kosovare e Privatizimit që nga vitit 2011 e deri më datën raportuese ka transferuar gjithsej shumën prej EUR 32,148,000 në llogarinë bankare të thesarit për financimin e aktiviteteve administrative dhe operative të AKP-së:

1. Gjatë vitit 2011 ka transferuar shumën prej EUR 1,800,000;
2. Me datën 28 Maj 2012, të transferuara shumën prej EUR 8,200,000.00 për vitin fiskal 2012;
3. Me datën 28 Dhjetor 2012, të transferuara shumën prej EUR 8,048,000.00 për vitin fiskal 2013;
4. Me datën 18 Nëntor 2014, të transferuara shumën shtesë prej EUR 2,300,000.00 për vitin fiskal 2014;
5. Me datën 15 Janar 2015, të transferuara shumën shtesë prej EUR 5,500,000.00 për vitin fiskal 2015; dhe
6. Me datën 15 Janar 2016, të transferuara shumën shtesë prej EUR 6,300,000.00 për vitin fiskal 2016.

16. SHPENZIME TË TJERA

Gjithsej shuma e paguar gjatë vitit 2016 është EUR 22,907. Këto shpenzime përfshijnë avanset për udhëtime zyrtare të Zyrtarëve Ligjor dhe Zyrtarëve të Rastit për NSh-të në likuidim (përfaqësime gjyqësore jashtë territorit të Kosovës) dhe pagesat e tarifave për transaksionet dalse nga llogarit bankare të fonde në mirëbesim që i aplikonë BQK.

Më poshtë janë të paraqitura shpenzimet:

- shpenzimet janë të tarifave bankare për realizimin e transaksioneve në shumën prej EUR 7,016;
- shpenzimet për udhëtime zyrtare (përfaqësime në Gjykata) jashtë vendit për mbrojtjen e aseteve të NSh-ve përkatëse në shumën prej EUR 14,744;
- Shpenzime nga paraja e imët (arkë) nga Pallati i Rinisë, Kulturës dhe Sportit në shumën prej EUR 202;
- Shpenzime dhe avans nga paraja e imët (arkë) nga MIM Golesh në shumën total prej EUR 945. Avansi është EUR 500 për shpenzime të vogla;

17. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve NË LIKUIDIM

Për vitin 2016 janë shpërndarë gjithsej EUR 15,826,866 për 117 Ndërmarrjeve Shoqërore. Raportet aprovohen me vendim të Bordit të Drejtorëve.

Ndërsa nga 2011 deri më 31 Dhjetor 2015 janë shpërndarë gjithsej EUR 45,142 për tre ndërmarrje Shoqërore.

PËRSHKRIMI KREDITORËT	2011- 2015	GJENDJA E APROVIMEVE DHE PAGESAVE 2016			GJITHSEJ		
	APROVUAR PAGUAR	SHUMA E APROVUAR	PAGUAR	PAPAGUAR	SHUMA E APROVUAR	PAGUAR	PAPAGUA R
	1	2	3	4=2-3	5=1+2	6=1+3	7=5-6
Për paga të punëtorëve	23,165	6,484,402	6,080,864	403,538	6,507,567	6,104,029	403,538
ATK-ja	2,607	3,981,721	3,649,248	332,473	3,984,328	3,651,855	332,473
Trusti	928	1,718,060	1,620,243	97,817	1,718,988	1,621,171	97,817
Tatimi në pronë	14,139	953,263	950,510	2,753	967,402	964,649	2,753
Shërbimet publike	3,018	795,077	713,713	81,364	798,095	716,731	81,364
Kreditor të tjerë	1,285	3,481,908	2,812,308	669,600	3,483,193	2,813,593	669,600
Gjithsej	45,142	17,414,431	15,826,886	1,587,545	17,459,573	15,872,028	1,587,545

*Në këto shuma nuk përshihen tarifat bankare. Gjithsej pagesat e tarifave bankare është EUR 2,149.50 për transaksionet e realizuara

Në shumat e papaguara, kryesisht kanë të bëjnë me vendimet Bordit të Drejtorëve të datës 16 dhe 20 Dhjetor 2016, për të cilat është filluar të paguhet në fillim të muajit Janar 2017. Shuma totale e këtyre vendimeve për shpërndarje për muajin Dhjetor 2016 është EUR 1,378,365. Ndërsa, pjesa tjetër e papaguar është si rezultat i mungesës të informacioneve të sakta të llogarive bankare për ekzekutim të pagesave.

Informatë:

1. Në vitin 2015, ATK-ja me kërkesën e saj ka rezervuar mjetet prej EUR 192,357.31 për NSh në likuidim "Jugoterm". Mjetet e rezervuar në BQK janë si rezultat i vendosjes së barrës tatimore mbi asetet e kësaj NSh-je. AKP ka nënshkruar një "Marrëveshje të Mirëkuptimit" me ATK për trajtimin e barrës tatimore, por për rastin në fjalë është vendosur që të trajtohet deri në vendimin e Dhomës të Gjykatës Supreme të Kosovës;
2. Në vitin 2016, Shuma prej EUR 6,893.21 të dedikuara për tatimin në pronë të kreditorit të Komunës të Skenderajt janë tërhequr nga ATK-ja si rezultat i vendosjes të "Barrës tatimore". Tërheqja është bërë nga sistemi i Thesarit të Ministrisë së Financave. Kemi kërkuar që këto mjete të kthehen në llogari të AKP-së.
3. Për arsye të emrit dhe mbiemrit të njëjtë të dy kreditorëve, gjatë realizimit të pagesës në vlerë prej EUR 976.20, një kreditor ka përfituar më shumë për NSh "Trasing". Nga Zyrtari i rastit, kreditori është njoftuar që t'i kthejë mjetet dhe njëhëkosisht janë marrë masat ligjore për rastin në fjalë.
4. Në Mars të vitit 2015, BQK-ja ka ekzekutuar urdhrin e përmbaaruesit privat në shumën 3,194.25 për NSh në likuidim "Malishgani Klinë". AKP-ja ka marrë të gjitha hapat ligjor dhe ka kërkuar kthimin e mjeteve. Të gjitha institucionet relevante janë njoftuar për rastin në fjalë.

18. FONDET TEPRICË TRANSFERUAR QEVERISË SË KOSOVËS

Në përputhje me nenin 19.3.3 i Ligjit të AKP-së, deri më 31 Dhjetor 2015 shuma e transferuar si fonde tepriçë është EUR 90,244,911. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur transferim të mjeteve tepriçë në Llogarinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme janë obligimet e papaguara nga palët e treta ndaj Agjencisë, të cilat paraqiten vetëm si shpalosje. Llojet e të hyrave për Agjencinë janë si më poshtë:

- ndëshkimet financiare për valët e “spin off-ve special”;
- pjesët e papaguara nga valët e privatizimit apo likuidimit; dhe
- qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSh-ve.

Të gjitha këto të dhëna janë të paraqitura nga Njësia për Kontroll dhe Mbikqyrje, Zyrat Regjionale përmes Departamentit të Koordinim të Rajonal dhe Departamenti i Shitjes.

Gjendja e llogarive të arkëtueshme është EUR 53,537,259 për të gjitha rastet e sipër shënuara.

19. NDËSHKIMET NDAJ NSh-ve ME SPIN-OFF SPECIAL

Ndëshkimet në vlerë monetare për zotimet e dhëna ndaj blerësve për disa Ndërmarrjet e Reja si më poshtë, që përveç çmimit të ofertës, ofertuesit kanë dorëzuar dhe ofertat lidhur me investimet për këto Ndërmarrje.

Për shkak të mospërbushjes së zotimeve deri me tani janë aplikuar ndëshkimet financiare për blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet.

PËRSHKRIMI	DERI MË 31 DHJETOR 2014	JANAR - DHJETOR 2015	JANAR - DHJETOR 2016	GJITHSEJ
Emri i Ndërmarrjes së Re:	1	2	3	4=1+2+3
Grand Hotel	8,822,314.97	-	-	8,822,314.97
IDGJ Tobacco	4,573,649.11	-	-	4,573,649.11
Xim Strezovc	7,298,170.76	-	-	7,298,170.76
MIM Golesh	8,447,812.27	-	-	8,447,812.27
Agrokosova Holding	3,579,997.53	-	-	3,579,997.53
Llamkos	1,686,459.51	29,029.28	-	1,715,488.79
GJITHSEJ	34,408,405.15	29,029.28	-	34,437,433.43

Për periudhën Janar - Dhjetor 2016, nuk ka janë aplikuar ndëshkimet. Vlerat janë të bartura nga periudhat paraprake. Këto llogari të arkëtueshme do të fillohet të trajtohen gjatë vitit 2017.

20. SHITJA E ASETETEVE PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT

Gjendja e llogarive të arkëtueshme deri më 31 Dhjetor 2016 është EUR 5,818,388. Nga viti paraprak 2015, llogaritë e arkëtueshme janë rritur kryesisht si rezultat i valës 27 të “shitjes të aseteve përmes likuidimit”.

Shitja 27 për disa asete në likuidim është shpallur më 7 dhjetor 2016. Të gjitha shitjet e SHA janë të aprovuara nga Bordi i AKP-së që kanë ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme.

Më poshtë paraqesim ngjarjet gjatë vitit 2016 të llogarive të arkëtueshme:

1. Bilanci deri më 31 Dhjetor 2015 EUR 1,592,134;
2. **PLUS** – vlera e e aprovuar në Dhjetor 2016 e shitjes prej EUR 5,840,724 të valës 27;
3. **MINUS** - pagesa e realizuar prej EUR 951,000. Shih shënimin shpjegues 2.1.1;
4. **MINUS** – pagesat e realizuara prej EUR 61,150. Shih shënimin shpjegues 2.1.2;
5. **MINUS** - depozitat që mbahen në llogarinë e bid depozitave deri në nënshkrimin e kontratave prej EUR 602,320. Shih shënimin nr. 6 te pika 2;
6. **Gjendja në fund të periudhës më 31 Dhjetor 2016 EUR 5,818,388**

Shuma prej EUR 5,818,388 si llogari e arkëtueshme përfshinë situatat e mëposhtme:

- Shumën prej EUR 641,134 të viteve paraprake. Shitjet e aprovuara nga Bordi i AKP-së, mirëpo këto 4 asete të shitura kanë masë të përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Shuma prej EUR 5,177,254 (5,840,724-61,150-602,320) është shuma e papaguar nga blerësit për valën 27 të “shitjes të aseteve përmes likuidimit.

21. QIRAJA APO TË HYRAT TË TJERA

Marrë parasysh natyrën e punës së Agjencisë, faktorët që ndikojnë në llogarit e arkëtueshme janë si më poshtë:

1. Zgjerimi i aktivitetit të Agjencisë rreth administrimit të aseteve të NSh-ve;
 - 1.1. Në krahasim me vitet paraprake, kemi një rritje të madhe të qiramarrëve që kanë pranuar të nënshtrohen nënshkrimit të kontratave për shfrytëzimin e aseteve të NSh-ve. Faktori tjetër i rritjes së llogarive të arkëtueshme dhe inkasimit të lartë të të hyrave nga qiraja ka reflektuar nga periudha e Nëntor të vitit 2014 pas marrjes së vendimit nga menaxhmentit për lirim të pronave nga uzurpatorët;
2. Faturimi ndaj Kosova Petrol për shfrytëzimin e aseteve të NSh-ve “INA TRGOVINA” dhe “JUGOPETROL” për periudhën nga Shkurti i vitit 2000 deri më 30 Prill 2016. Obligimi është EUR 8,708,329. Fatura e parë për obligimet është lëshuar gjatë vitit 2014. Për shfrytëzimin e këtyre aseteve për periudhën e sipër shënuar është ngritur padi ndaj Kosova Petrol në organet përkatëse.

Gjithsej llogaritë e arkëtueshme për qiratë janë EUR **13,281,091**. Në përgjithësi, për këto obligime janë inicuar paditë gjyqësore nga Zyrtarët e rastit për NSh-të përkatëse.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Vlera e paraqitur në tabelën e llogarive të arkëtueshme për periudhën raportuese paraqet performancën gjatë vitit aktual me vitin paraprak. Ndryshimet tek Departamenti i Shijtes dhe Njesisë së Monitorimit janë të paraqitura në shënimet shpjeguese nr. 19 dhe 20.

Ndërsa sa i përket ndryshimeve të llogarive të arkëtueshme për qiratë, në ZR të Gjilanit, ndryshimi prej EUR 822,339 është si rezultat i identifikimit dhe kontrollës më të lartë gjatë vitit raportues për asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore nën këtë regjion.

Gjithashtu, kemi pranuar të hyra prej EUR 915,063.4 nga shfrytëzimi i objektit nga UNMIK-u për të cilën në periudhat paraprake nuk është paraqitur si llogari e arkëtueshme. Kjo për shkak se nuk kemi pasur njohuri për vlerën e saktë të qirasë.

Vlera e qirasë është përcaktuar nga UNMIK-u, pa ndonjë komunikim zyrtar me AKP-në, por sipas informatave që ka marrë Zyra Regjionale e Mitrovicës, standardi i përcaktuar për vlerën e qirasë nga UNMIK është marrë nga vitet 2005 dhe 2006. Përmes insistimit të Agjencisë mjetet për shfrytëzimin e qiras janë kërkuar nga ish-Menaxhmenti i NSh-së Jugobankes të UNMIK-u, pasi AKP-në si institucion ende kjo organizat nuk e njehë.

LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

Obligimet e papaguara janë të paraqitura në tri shtylla:

1. Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit);
2. Mallrat dhe Shërbimet; dhe
3. Obligimet ndaj Kërkesave të Kreditorëve;

Të gjitha këto të dhëna janë të paraqitura nga Departamenti për Koordinim të Likuidimit dhe Zyrat Regjionale përmes Departamentit të Koordinim të Rajonal.

Raporti është i shpalosur në tabela në këtë format:

- Në kolonën 1 janë të paraqitura obligimet e papaguara deri më 31 Dhjetor 2015;
- Në kolonën 2 janë të paraqitura rezultatet e rritjeve/zvogëlimeve të balanceve deri në periudhën raportuese në krahasim me fund vitin 2015;
- Në kolonën 3 janë bilanci përfundimtare më 31 Dhjetor 2016.

Obligimet e papaguara deri më 31 Dhjetor 2016 janë EUR **1,642,057**.

22. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Për periudhën e përfunduar më 31 Dhjetor 2016, nuk ka asnjë faturë e cila ka mbetur pa u paguar. Të gjitha pagesat janë realizuar. Për më tepër referojuni shënimit shpjegues nr. 10.

23. MALLRA DHE SHËRBIME

Shuma prej EUR 54,512 janë për ofruesit e shërbimeve të cilët angazhohen për NSh-të përkatëse, shërbimet për ruajtjen e aseteve, shpalljet në gazeta për shitjen e aseteve përmes likuidimit, shpalljet lidhur me njoftimet për kërkesat e kreditorëve.

Më poshtë janë paraqitur detajet:

- Shpenzimet për furnizim me material higjienik dhe artikuj ushqimor për funksionimin e bifesë për Grand Hotel në shumë prej EUR 6,781,
- Shpenzimet për ofruesit e Shërbimeve, gjithsej EUR 4,100;
- Shpenzimet për shërbimet e sigurimit fizik për ruajtjen e aseteve prej EUR 26,920;
- Shpenzimet për rrymë prej EUR 1,585;
- Shpenzimet për furnizim me ujë prej EUR 3,165;
- Shpenzimet për pastrimin e mbeturinave prej EUR 1,655;
- Shërbime të tjera prej EUR 884;
- Shpallje në gazeta prej EUR 1,674;
- Shpenzime për mirëmbajtjen e aseteve prej EUR 2,789
- Shpenzime për shërbime profesionale – përfaqësimet në Gjykata dhe shërbimet e përmbaruesve prej EUR 4,385; dhe
- Shpenzimet e telekomunikimit në shumën prej EUR 574.

24. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSh-ve

Ashtu siç është përmendur edhe në shënimin shpjegues nr. 17 “Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-ve”, obligimet e papagura janë pagesat e porealizuara ndaj kreditorëve të NSh-ve sipas vendimit për shpërndarje të Bordit të Drejtorëve.

Nga shuma e papaguar prej EUR 1,587,545 janë si rezultat:

- Gjithsej shuma prej EUR 1,378,365 nga aprovimi nga Bordi i Drejtorëve për shpërndarje të datës 16 dhe 20 Dhjetor 2016. Për këto, është filluar procesimi i pagesave gjatë muajit Janar 2017;
- Gjithsej shuma e papaguar prej EUR 209,180 ndaj gjithsej 211 kreditorëve të NSh-ve. Këto janë shumat të cilat kanë mbetur pa u paguar si rezultat i mungesës të informacioneve të sakta të llogarive bankare. AKP-ja ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të vënë në kontakt kreditorët në fjalë (edhe përmes reklamave në TV). AKP-ja së fundi ka vënë në përdorim edhe aplikacionin në uebfaqen e saj zyrtare në menyrë që kreditorët të informohen me të dhënat e fundit rreth procesit të shpërndarjes.

25. DETYRIMET KONTIGJENTE

Këto detyrime janë për një numër të Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat nuk janë vendosur në likuidim ende të cilat kanë konteste gjyqësore.

Detyrimet kontingjente janë të shpalosura këtë format: Kolona 1 paraqet totalin e shumave të periudhave 2015 dhe 2016 dhe totalin e të gjitha vlerave të bartura të bilanceve deri më 31 Dhjetor 2014.

Detajet në lidhje me detyrimet kontigjente janë në Tabelën 5 te pasqyrat financiare.

PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE

Në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit dhe NSh-ve tjera, atëherë pagesat realizohen përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompenzohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.

Gjatë periudhës raportuese, bilanci i hyrjeve/daljeve nga llogaria e tarifës administrative është si më poshtë:

1. Gjendja bankare më 31 Dhjetor 2015 nw vlerën prej EUR 14,995,375
2. **MINUS** Pagesa e realizuar për buxhetin e AKP-së prej EUR 6,300,000 për të mbuluar aktivitetet operative dhe administrative në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-034. Shih shënimin shpjegues nr.15;
3. **MINUS** Pagesat ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale prej EUR 2,185,913. Shih shënimin shpjegues 10;
4. **MINUS** Pagesat ndaj për ruajtjen e aseteve për NSh-të prej EUR 172,943. Shih shënimin shpjegues nr. 11.2;
5. **MINUS** Pagesat ndaj Ofrusve të Shërbimve për NSh-të prej EUR 55,870. Shih shënimin shpjegues nr. 11.1;
6. **MINUS** shpenzimet nga para e imët për NSh-të në likuidim (shih tabelën më poshtë) prej EUR 31,827;
7. **MINUS** Pagesat për rrymë prej EUR 25,785 për NSh-të përkatëse;
8. **MINUS** Pagesat për Komisionin për Miniera dhe Minerale për MIM Golesh prej EUR 39,530 për NSh-të përkatëse;
9. **MINUS** shuma prej EUR 3,500 për mbulimin e likuiditetit të llogarive të NSh-të në likuidim.
10. **MINUS** Shpenzime të tjera prej EUR 23,634 për shërbime postare, shpallje në gazeta, shërbime komunale, tatimet dhe të tjera;
11. **PLUS** Transferimi i 5% nga shitjet e aseteve në privatizimit, likuidimit apo cfarëdo shitje tjetër, interesi dhe tarifatat për pjesëmarrje të tenderëve (privatizim dhe likuidim). Gjatë vitit 2016 janë transferuar gjithsej EUR 775,607;
12. **PLUS** Pagesa e mjeteve për Tarifë Administrative nga llogaritë e likuidimit në vlerën totale prej EUR EUR 291,156;
13. **Bilanci në fund prej EUR 7,223,136**

Përshkrimi	Avanset	Shpenzimet	Kthimet e mjeteve	Qëllimi i pagesës
Zyra Regjionale Gjiilan	5,000	(4,955.26)	44.74	Taksa komunale, dërgesa postare dhe pagesa të tjera të vogla
Zyra Regjionale Mitrovicë	3,000	(2,661.80)	338.2	Taksa komunale, dërgesa postare dhe pagesa të tjera të vogla
Zyra Regjionale Pejë	7,000	(6,996.01)	3.99	Taksa komunale, dërgesa postare dhe pagesa të tjera të vogla
Zyra Regjionale Prishtinë	5,000	(4,645.76)	354.24	Taksa komunale, dërgesa postare dhe pagesa të tjera të vogla
Zyra Regjionale Prizren	7,000	(6,542.50)	457.5	Taksa komunale, dërgesa postare dhe pagesa të tjera të vogla
Bankos dhe Derma	1,605.00	(927.32)	677.68	Udhëtime Zyrtare jashtë vendit për përfaqësim në Gjykata
Bankos dhe Derma	1,605.00	(960.02)	644.98	Udhëtime Zyrtare jashtë vendit për përfaqësim në Gjykata
Bankos dhe LUX	2,890.00	(2,206.74)	683.26	Udhëtime Zyrtare jashtë vendit për përfaqësim në Gjykata
Bankos	2,220.00	(1,931.38)	288.62	Udhëtime Zyrtare jashtë vendit për përfaqësim në Gjykata
GJITHSEJ	35,320	(31,826.79)	3,493.21	

*Pagesat e realizuara nga para e imët nga Zyret Regjionale regjistrohen në një regjistër për secilën Ndërmarrje Shoqërore Likuidim për të cilën është realizuar pagesa. Pastaj, mjetet alokohen në llogarinë e tarifës administrative nga ato NSh për të cilat është bërë shpenzimi dhe që kanë mjete. Para e imët tërhiqet nga llogaria e tarifës dhe jo nga secila llogari e likuidimit për arsye të kursimeve nga shpenzimet administrative që praktikon BQK si tarifë për një tërheqje EUR 50.00. Mbyllja e këtyre avanseve bëhet në fund të vitit fiskal.

TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE

TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Janë transaksione bankare ndërmjet llogarive bankare të fondeve në mirëbesim në BQK. Siç edhe i kemi paraqitur më lartë. Shkurtimisht, këto ndodhin për arsyt e mëposhtme:

1. Shpërndarja e 75% nga llogaritë e privatizimit për në llogaritë bankare të likuidimit. Është korrigjuar shuma prej EUR (5,088.34) të transferuar më shumë.
2. Transferimi i gjendjes bankare të NSh-ve në tranzicion për në llogaritë bankare të likuidimit. Gjithsej EUR 2,100;
3. Transferimi i 5% nga shitjet e aseteve në privatizimit, likuidimit apo çfarëdo shitje tjetër, interesi dhe tarifat për pjesëmarrje të tenderëve (privatizim dhe likuidim). Gjatë vitit 2016 janë transferuar gjithsej EUR 775,607:
 - Nga llogaritë e privatizimit (Ndërmarrje e Re), gjithsej EUR 165,693;
 - Nga llogaritë e Likuidimit, gjithsej EUR 6,778;
 - Nga llogaria e tarifës për pjesëmarrje të tenderëve të valëve të privatizimit në shumën prej EUR 267,527. Është transferuar e tërë gjendja sipas bilancit përfundimtar të 31 Dhjetor 2015;
 - Nga llogaria e tarifës për pjesëmarrje të tenderëve të valëve të likuidimit në shumën prej EUR 335,609. Është transferuar e tërë gjendja sipas bilancit përfundimtar të 31 Dhjetor 2015;
4. Konfiskimin e depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likuidimit.
5. Bartjen e BID depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likuidimit për në llogaritë përkatëse të NSh-ve (privatizim apo likuidim). Këto raste janë të paraqitura në shënimin 3 dhe 6. Gjithsej shuma e transferuar prej EUR 10,000;
6. Transferimin e shumave të pa shpërndara si pjesë e 20% për në llogarinë në mirëbesim për punëtorët e NSh-ve. Gjatë vitit 2016, gjithsej shuma e transferuar për punëtorët në llogari që mbahet në mriëbesim nga AKP është EUR 693,490. Këto mjete do të shpërndahen pas shqyrtimit të ankesave nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Mjetet e transferuar janë si më poshtë:
 - Gjithsej shuma e transferuar nga llogaritë e privatizimit prej EUR 78,406;
 - Gjithsej shuma e transferuar nga llogaritë e likuidimit prej EUR 615,085;
7. Kompenzimi i llogaris të tarifës administrative nga llogaritë e NSh-ve përkatëse në vlerën prej EUR 291,156;

LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE

AKP-ja mban para edhe në llogari tjera (banka komerciale në Procredit) për situatat e mëposhtme:

1. Mbajtja e kapitalit themeltar për Ndërmarrjet e Reja të themeluara nga asetet e NSh-ve (shih shënimin 2.1.1 të shënimeve shpjeguese). Janë tri llogari bankare, gjithsej EUR 1,545.70;
2. Garancioni bankar për MIM Golesh në shumën prej EUR 64,466.50 për liçensën sipas rregullorës të Komisionit për Miniera dhe Minerale të Kosovës.

Gjithsej gjendja bankare në periudhën raportuese e këtyre llogarive është në vlerën prej EUR 66,012.20.

- FUND -



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Kosovska Agencija Za Privatizaciju

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE	5
RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT	6
SHËNIMI 1 INFORMATA PËR ORGANIZATËN DHE POLITIKAT KONTABËL	7
1.1. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE.....	7
1.2. SUBJEKTI RAPORTUES.....	7
1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA	8
1.4. LLOGARIA E VETME E THESARIT (LLVTH)	8
1.5. KTHIMET E SHPENZIMEVE NGA VITI PARAPRAK	8
1.6. VALUTA DHE SHUMA RAPORTUESE.....	8
1.7. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE.....	8
SHËNIMI 2 PAGA DHE RROGA.....	9
SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME.....	10
3.1. GRANTI QEVERITAR.....	11
3.2. TË HYRAT E DEDIKUARA.....	12
SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE.....	15
SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE.....	16
SHËNIMI 7 KTHIMI I HUAMARRJEVE	17
SHËNIMI 8 TJERA.....	17
SHËNIMI 9 TË HYRAT TATIMORE.....	17
SHËNIMI 10 TË HYRAT JO TATIMORE	17
SHËNIMI 11 TË HYRAT E DEDIKUARA	17
SHËNIMI 12 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE	19
SHËNIMI 13 HUAMARRJET	19
SHËNIMI 14 TË ARKËTUESHMET	19
SHËNIMI 15 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA.....	20
SHËNIMI 16 DETYRIMET KONTINGJENTE.....	21
SHËNIMI 17 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)	22
SHËNIMI 18 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO).....	23
SHËNIMI 19 RAPORT PËR TË HYRAT E DEDIKUARA.....	23
SHËNIMI 20 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE	24
SHËNIMI 21 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE ME KONTRATE PËR SHËRBIME TE VEÇANTA PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE	24
SHËNIMI 22 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA).....	25

ANEKSI I PASQYRAVE FINANCIARE:

TABELA 1 – RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT	FAQE 1
TABELA 2 – PASQYRA KRYESORE.....	FAQE 2
TABELA 3 – DETAJET E FATURAVE TË PAPAGUARA.....	FAQE 3 -5;
TABELA 4 – RAPORTI I PASURIVE.....	FAQE 6

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

		2016		2015		2014	
		Llogaria e vetme e Thesarit		Llogaria e vetme e Thesarit		Llogaria e vetme e Thesarit	
		BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme	BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme	BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme
Shënime		'000	'000	'000	'000	'000	'000
BURIMET E FONDEVE							
	Granti qeveritar	9,515		10,573		406,183	
	Të hyrat vetanake						
	Të hyrat e dedikuara	6,303,375		5,959,695		5,468,210	
	Grantet e përcaktuara të donatorëve						
	Huamarrjet						
	Fondi zhvillimor në mirëbesim						
	Pranimet tjera						
Gjithsej		6,312,890	-	5,970,268	-	5,874,393	-
SHFRYTEZIMI I FONDEVE							
	Operacionet						
	Paga dhe roga	2 4,402,591		4,321,066		3,885,722	
	Mallra dhe shërbime	3 1,745,292		1,401,519		1,754,835	
	Shpenzime komunale	4 73,594		84,980		77,636	
		6,221,477	-	5,807,565	-	5,718,193	-
	Transferet						
	Transfere dhe subvencione	5 78,809		116,003		63,300	
	Shpenzime kapitale						
	Prona, ndërtesa dhe pajisje	6 12,603		46,700		92,900	
	Kthimi i huamarrjeve	7					
	Pagesa tjera	8					
Gjithsej		6,312,889	-	5,970,268	-	5,874,393	-

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016

		2016				2015	2014
		Buxheti fillestar (Ndarja) A	Buxheti final (Ndarja) B	Realizimi C	Varianca D=C-B	Realizimi E	Realizimi F
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Shënime							
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	9						
Të hyrat jo tatimore	10						
Të hyrat e dedikuara	11	7,149,129	7,199,729	7,199,729	-	6,811,383	7,345,873
Grantet e përcaktuara të donatorëve	12						
Huamarrjet	13						
Tjera	14						
Gjithsej Pranimet e mbledhura në FKK-në		7,149,129	7,199,729	7,199,729	-	6,811,383	7,345,873
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Paga dhe roga	2	4,402,884	4,453,484	4,402,591	(50,893)	4,321,066	3,885,722
Mallra dhe shërbime	3	3,944,284	2,537,760	1,745,292	(792,468)	1,401,519	1,754,835
Shpenzime komunale	4	98,000	98,000	73,594	(24,406)	84,980	77,636
Transfere dhe subvencione	5	490,000	90,000	78,809	(11,191)	116,003	63,300
Shpenzime kapitale	6	30,000	30,000	12,603	(17,397)	46,700	92,900
Kthimi i huamarrjeve	7						
Tjerat	8						
Gjithsej pagesat e bëra nga BRK nëpërmes LIVTh		8,965,168	7,209,244	6,312,889	(896,355)	5,970,268	5,874,393

* Tek pjesa e hyrjes e parasë së gatshme në llogari të Thesarit është paraqitur vetëm shuma e buxhetuar nga të Hyrat e Dedikuara (kodi 23), ndërsa daljet e parasë së gatshme janë përfshirë edhe Granti Qeveritar. **P. Sh.** shih kolonën e parë tek totalët, hyrjet 7,149,129 minus daljet 8,965,168. Ndryshimi prej EUR 1,816,039 është nga Granti Qeveritar (kodi 10) ndarje buxhetore për të realizuar “Studimin e Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj”.

SHËNIMI 1 INFORMATA PËR ORGANIZATËN DHE POLITIKAT KONTABËL

1.1. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) janë përgatitur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme - Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Këto pasqyra financiare i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga udhëzimet administrative të Ministrisë së Financave dhe janë të bazuar në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare formojnë pjesën përbërëse të pasqyrave financiare dhe duhet të lexohen së bashku dhe në ndërlidhje me pasqyrat financiare.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë tërë periudhës raportuese.

1.2. SUBJEKTI RAPORTUES

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar sipas Ligjit nr. 03/L-067 (në fuqi më 1 Korrik 2008), i ndryshuar me ligjin nr. 04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011 dhe ndryshuar me Ligjin nr. 080 të datës 24 Dhjetor 2015. Agjencia Kosovare e Privatizimit kontrollohet nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza vjetore.

Aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh-ve) nëpërmjet të metodave të "spin of-it" dhe shitjeve të aseteve përmes procesit të likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore. Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe riorganizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore aty ku paraqitet nevoja. Agjencia Kosovare e Privatizimit administron Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në mirëbesim. Si administruese e besuar, AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerave të NSh-ve në Kosovë.

Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Periudha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2016. Aktivitetet e AKP-së gjatë periudhës raportuese janë financuar nga Të hyrat e Dedikuara dhe Granti Qeveritar.

Sipas Ligjit të LMFPP-së (neni 64) dhe Ligjit të AKP-së 04/L-034 (neni 21), Të hyrat e Dedikuara janë 5% i të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, është tarifë administrative për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative.

Granti Qeveritar është fondi i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore. Në rastin e Agjencisë, ka financuar aktivitetet që kanë të bëjnë me riorganizimin e NSh-së në këtë rast Ndërmarrjen Trepça e cila është nën kompetencën e Agjencisë sipas Ligji nr. 04/-L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre deri në periudhën raportuese.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA

Pagesat e bëra nga pala e tretë nuk përbëjnë pranimet e parave apo pagesave nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Këto pagesa janë të paraqitura në kolonën "Pagesat nga Pala e Tretë" në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave.

Gjatë periudhës raportuese Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka përfituar pagesa nga palët e treta, përpos Grandit Qeveritar dhe Të Hyrave të Dedikuara të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

1.4. LLOGARIA E VETME E THESARIT (LLVTH)

Sa i përket ndarjeve buxhetore që pranon nga Granti Qeveritar, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk operon me llogaritë bankare. Thesari administron shpenzimet e parave që ndodhin dhe pranimet e parave të mbledhura nga të gjitha organizatat buxhetore gjatë vitit financiar.

Shpenzimet operative dhe administrative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit mbulohen nga Të Hyrat e Dedikuara nga vitit fiskal 2012. Thesari ka bërë hapjen llogaris së veçantë në fondin e Buxhetit të Kosovës me emër të llogarisë AKP Privatizimi Tarifa Administrative” dhe numër të llogarisë 1000400070004642. AKP-ja transferon periodikisht të hyrat e dedikuara në këtë llogari bankare, në mënyrë që të financohen aktivitetet e vitit përkatës fiskal.

Sa i përket fondeve në mirëbesim, bazuar në ligjin mbi themelimin e AKP-së dhe procedurave bankare të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, AKP operon me llogaritë bankare në mirëbesim të mbajtura në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Pasqyrat Financiare dhe Shënimet Shpjeguese të Fondeve në Mirëbesim sipas nenit 20 të Ligjit të AKP-së janë paraqitur ndaras nga Pasqyrat Financiare të AKP-së.

1.5. KTHIMET E SHPENZIMEVE NGA VITI PARAPRAK

Sipas Ligjit MFPP, paratë e kthyera në Fondin e Konsoliduar të Kosovës nga viti paraprak regjistrohen si pranime (të hyra) në vitin aktual. Ndërsa, paratë e kthyera në Fondin e Konsoliduar të Kosovës nga viti aktual (vijues) regjistrohen si zbritje e shpenzimeve të vitit aktual.

1.6. VALUTA DHE SHUMA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në tabelat përkatëse.

1.7. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare janë autorizuar për lëshim më 30 Janar 2017 nga: Ekrem Hajdari, Drejtor Menaxhues, AKP dhe Adem Selishta, u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit, AKP.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

SHËNIMI 2 PAGA DHE RROGA

Përshkrimi	Buxheti	2016		Gjithsej	Krahasim	2015	2014
	Final	GQ	THD	Pagesat		€	€
	€	€	€	€	%		
Pagat neto përmes listës së pagave	3,673,484		3,649,751	3,649,751	99.35%	3,584,559	3,230,716
Pagesa per sindikatë				-			
Pagesa neto për punë jashtë orarit				-			
Puntëtorët me kontratë (jo në listen e pagave)				-			
Tatimi ndaluar në të ardhura personale	340,000		333,543	333,543	98.10%	324,976	284,805
Kontributi pensional-punetori	220,000		209,649	209,649	95.29%	205,766	185,100
Kontributi pensional-punëdhënësi	220,000		209,649	209,649	95.29%	205,766	185,100
Paga dhe rroga	4,453,484	-	4,402,591	4,402,591	98.86%	4,321,066	3,885,722

Ashtu siç është paraqitur edhe në tabelën e mësipërme, gjatë këtij viti fiskal, burim i vetëm i financimit për mbulimin e pagave dhe mëditjeve për punëtorët e AKP-së janë të hyrat e dedikuara të AKP-së.

Buxheti i aprovuar për vitin fiskal 2016 është në vlerën prej EUR 4,453,484 dhe është ndarë në programin “Administrata Qendrore” të AKP-së. Numri i punëtorëve sipas Ligjit për Buxhetin për vitin 2016 është aprovuar prej 258 nëpunës.

Buxheti i aprovuar (Ligji Nr. 05/L -071) në fillim të vitit 2016 ka qenë në shumën prej EUR 4,402,884. Rritja e buxhetit është bërë për këtë kategori është bërë me vendim të Qeverisë (sipas kërkesës të AKP-së), në këtë kategori, është bërë rritja e këtij buxheti në shumën 50,600 (shih vendimin nr. 07/112, neni 2 paragrafi 11.). Ministria e Financave ka bërë ndarjen e mjeteve nga burimi financiar prej të hyrave të dedikuara.

Pagat dhe mëditjet procedohen përmes Ministrisë së Administratës Publike, në të cilën, AKP-ja dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse. Ministria e Administratës Publike pas analizave përcjell informatat tek Ministria e Financave e cila procedon pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME

Përshkrimi	Buxheti	2016		Gjithsej	Krahasim %	2015	2014
	Final €	GQ €	THD €	Pagesat €		€	€
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtare brenda vendit				-			1,512
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit				-			1,604
Meditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit				-		125	204
Akomodimi udhëtime zyrtare jashtë vendit	6,000.00	-	2,386	2,386	40%	845	6,260
Shpenzime tjera udhëtime zyrtare jashtë vendit	7,000.00	-	4,654	4,654	66%	2,269	10,657
Shpenzimet per internet	5,000.00	-	3,456	3,456	69%	5,575	14,091
Shpenzimet e telefonisë mobile	59,242.00	-	44,143	44,143	75%	51,456	44,063
Shpenzimet postare	10,900.00	-	1,723	1,723	16%	3,132	5,068
Shërbimet e arsimit trajnimit	33,000.00	-	17,363	17,363	53%	7,555	45,050
Shërbimet e përfaqësimit avokatë dhe ekspertë	26,330.00	415	5,766	6,181	23%	823	16,557
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	494,100.00	-	348,898	348,898	71%	13,729	725,557
Sherbime shtypje-jo marketing	3,200.00	-	1,731	1,731	54%	847	
Sherbime kontraktuese tjera	583,843.00	-	519,699	519,699	89%	574,184	
Sherbime teknike	23,915.00	-	7,659	7,659	32%	5,715	21,503
Mobilje (me pak se 1000 euro)	19,700.00	-	6,908	6,908	35%		4,750
Kompjuterë me pak se 1000 euro)	14,500.00	-	14,158	14,158	98%		
Pajisje tjera (më pak se 1000 euro)	1,500.00	-	1,080	1,080	72%	21,931	11,636
Harduer për teknologji informative (më pak se 1000 euro)	40,200.00	-	36,311	36,311	90%	47,955	11,005
Furnizime për zyrë	49,700.00	-	38,851	38,851	78%	20,631	33,963
Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	18,000.00	-	14,944	14,944	83%	10,292	6,601
Furnizime pastrimi	22,100.00	-	9,339	9,339	42%	9,523	9,451
Furnizim me veshmbathje	-	-	-	-	-	5,857	-
Akomodimi	-	-	-	-	-	274	-
Vaj	100.00	-	21	21	21%	40	20
Naftë për ngrohje qendrore	53,000.00	-	35,204	35,204	66%	29,715	45,796
Derivate për generator	22,000.00	-	1,264	1,264	6%	9,743	5,250
Karburant për vetura	49,000.00	-	23,986	23,986	49%	28,794	33,622
Regjistrimi i automjeteve	5,000.00	-	3,125	3,125	63%	2,250	3,150
Sigurimi i automjeteve	10,000.00	-	8,405	8,405	84%	7,395	8,639
Taksa komuale e regjistrimit të automjeteve	1,000.00	-	350	350	35%	270	825
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	51,070.00	-	20,710	20,710	41%	23,846	32,960
Mirëmbajtja e ndërtesave	5,000.00	-	651	651	13%	7,804	1,662
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	22,813.00	-	14,035	14,035	62%	13,193	14,940
Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	15,653.00	-	14,538	14,538	93%	20,660	14,590
Qiraja për ndërtesa	414,940.33	-	414,334	414,334	100%	420,564	417,258
Reklamat dhe konkurset	10,000.00	-	5,988	5,988	60%	807	730
Botimet e publikimeve	-	-	-	-	-		758
Shpenzimet për informim publik	409,403.67	9,100	79,668	88,768	22%	10,829	104,719
Drekat zyrtare	9,550.00	-	8,539	8,539	89%	3,225	3,134
Sigurimi i Ndërtesave dhe tjera	10,000.00	-	-	-	-	-	-
Shpenzime-vendimet e gjykatave	31,000.00	-	25,890	25,890	84%	39,666	97,251
Mallra dhe shërbime	2,537,760	9,515	1,735,777	1,745,292	69%	1,401,519	1,754,835

Shumat e paraqitura në tabelën e mallrave dhe shërbimeve janë financuar nga Granti Qeveritar dhe të hyrat e dedikuara. Më poshtë janë paraqitur dhe shpalosur në detaje shënimet lidhur me dy burimet e financimit për buxhetin e AKP-së.

3.1. GRANTI QEVERITAR

Për periudhën Janar - Dhjetor 2016, nga Granti Qeveritar janë financuar aktivitetet që kanë të bëjnë me riorganizimin e NSh-ve dhe në veçanti për Trepçën e cila ka qenë nën kompetencën e Agjencisë sipas Ligji nr. 04/-L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre.

Buxheti i pa shpenzuar pas përfundimit të vitit fiskal kthehet në buxhetin e Republikës së Kosovës. Për vitin 2016 nga Buxheti i Republikës së Kosovës (kodi 10) për planin e riorganizimit të Trepçës kemi pasur buxhetin e aprovuar në shumë prej **1,816,039 €**.

Buxheti i aprovuar për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” gjatë periudhës raportuese është në vlerën prej EUR 1,416,039. Ndërsa nga kategoria subvencione pa kërkesën e AKP-së janë ndarë nga MF në vlerën prej EUR 400,000.

Buxheti për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” është kërkuar nga AKP-ja për mbulimin e shpenzimeve sipas nënvijave buxhetore si më poshtë:

Përshkrimi i nënvijave buxhetore të AKP-së	Shuma e Buxhetuar	Kategorizuar në kodin ekonomi të Thesarit – tabelën të paraqitur më sipër
Ofrues të shërbimeve profesionale për Trepçën	1,346,039.00	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse
Shpenzime postare për Trepçën	5,000.00	Shpenzimet postare
Publikime në gazeta kombëtare dhe ndërkombëtare për Trepçën	50,000.00	Shpenzimet për informim publik
Shërbime teknike (përkthime, fotokopjime dhe shërbime tjera) për Trepçën	15,000.00	Shërbime Teknike

Qëllimi i mjeteve të kërkuara dhe të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës për buxhetin e AKP-së për vitin 2016, ka qenë mbështetja e punëve të nevojshme për përgatitjen e Planit të Riorganizimit të Trepçës. Si bazë e përgatitjes së Planit të Riorganizimit është cilësuar Studimi i Fizibilitetit dhe i njëjti është iniciuar me Vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP.

Gjatë vitit 2016, AKP ka iniciuar dhe përfunduar të gjitha procedurat e prokurimit publik deri në publikim të fituesit të kontratës për realizim të “Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj” në Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) për fillim të kontratës në korrik 2016.

Afati i paraparë për përfundim të studimit të fizibilitetit ka qenë 1 Nëntor 2016, mirëpo procedurat e tej zgjatura për shqyrtim të ankesave të parashtruara në Organin për Shqyrtim të Prokurimit (OSHP), kanë shkaktuar vonesa të cilat kanë bërë që kontrata të nënshkruhet me vonesë, respektivisht me datën 20 Shtator 2016.

AKP ka nënshkruar kontratën me OSHP për Studimin e Fizibilitetit të Trepçës, kontratë kjo e cila ka filluar të implementohet nga Shtatori 2016 dhe e cila do zgjatë deri në muajin Shkurt-Mars 2017 në vlerë prej EUR 598,920.00. Kjo vlerë nuk është paraparë në vitin 2017, mirëpo me kërkesën e dy buxhetore për vitin 2017, kemi kërkuar nga Ministria e Financave që të bën bartjen e shumës nga buxheti i vitit 2016 në vitin 2017, në vlerën e Kontratës së nënshkruar në vlerë prej 598,920.00.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Kushtet e pagesës në kontratën e nënshkruar përcaktojnë se pagesa realizohet pas dorëzimit dhe miratimit final të këtij Raporti nga AKP.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë dy here vendim për kursime buxhetore gjatë vitit 2016.

1. Vendimi i Qeverisë Nr. 11/0120 i datës 14.12.2016 ku është reduktuar shuma prej 795,639.26 vetëm nga buxheti i Trepçës (Granti Qeveritar, kodi 10);
 2. Vendimi i Qeverisë Nr. 01/123 i datës 28.12.2016 ku është reduktuar shuma prej 610,884.75 nga kategoria Mallra dhe Shërbime si dhe shuma prej 400,000.00 nga kategoria e Subvencioneve. Të dyja këto janë reduktuar nga buxheti i ndarë për Trepçën (Granti Qeveritar, kodi 10).
- Gjithsej shuma e kursimeve buxhetore për buxhetin e Trepçës për Programin buxhetor Riorganizimi dhe Administrimi i NSh-ve është gjithsej 1,806,524.01.

Duke marrë parasysh të gjitha pikat e shënuar më lartë, buxheti final është i barabartë me shpenzimet.

3.2. TË HYRAT E DEDIKUARA

Për të Hyrat e Dedikuara, buxheti i aprovuar për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” është EUR 2,528,245.00. Gjithsej pagesat e realizuar në këtë kategori nga ky burim i financimit është EUR 1,735,777.46 apo 68.66% të buxhetit.

Buxheti prej EUR 2,528,245.00 është buxheti origjinal (përfundimtar) dhe nuk ka pasur ndryshime gjatë procesit të rishikimit gjysmë-vjetor, por janë bërë transfere ndërmjet programeve buxhetore nëpërmjet procesit të rishikimit gjysmë-vjetor (Ligji nr. 05/L -109). Shih tabelën e mëposhtme:

Mallra dhe Shërbime	Buxheti i aprovuar 2016	Shuma e transferit	Buxheti pas transfereve
Likuidimi (zvogëlim nga nënvija e publikimeve)	654,045	- 150,000	504,045
Departamenti Ligjor (rritje te kategoria përfaqësimet)	30,000	+ 20,000	50,000
Administrata Qendrore (kompensimi të anëtarëve të Bordit)	1,314,200	+130,000	1,444,200

Më poshtë do të shpalosen më në detaje tabela 3 për ato vlera që janë më të mëdha dhe përfshihen disa pagesa të shërbimeve të ndryshme, që lexues të ketë një pasqyrë më të qartë, pasi që kodet e reja që janë paraqitur në tabelën 3, të dhënat financiare janë në vlera të përgjithshëm si p.sh. “Shërbime Kontraktuese të tjera”:

1. Shërbimet kontraktuese të tjera në shumën prej EUR 519,669 përfshinë në vete:

1.1. **Shërbimet e sigurimit fizik** – Pagesat prej EUR 402,359.87 për Zyrat e AKP-së (Zyra Qendrore dhe 5 Zyra Regjionale) dhe ruajtjen e aseteve të atyre NSh-ja që ende nuk kanë hyrë në likuidim, por janë në tranzicion dhe raste të tjera.

1.1.1 Pagesat e bëra në vlerë prej EUR 393,360.04, ndaj operatorit ekonomik me të cilin AKP-ja ka pasur kontratë. Pagesat përfshijnë periudhën Dhjetor 2015 – Nëntor 2016. Pagesat totale prej EUR 228,698.46 është për ruajtjen e Zyrave Rajonale dhe Zyrën

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

- Qendrore të AKP-së dhe pagesa totale prej EUR 164,661.58 për NSh-të para se të hyjnë në likuidim (programet buxhetore Privatizim dhe Administrimi direkt)
- 1.1.2 Pagesat prej EUR 5,199.83, ndaj Ofruesve të Shërbimeve për ruajtjen e aseteve të atyre NSh-ve që ende nuk kanë hyrë në procesin e likuidim. Pagesat janë realizuar për periudhën Nëntor – Dhjetor 2016.
- 1.1.3 Pagesat prej EUR 3,800.00 ndaj Policisë së Kosovës për ruajtjen hapësirës së Zyrës Qendrore të AKP-së dhe Zyrave Rajonale. Pagesa ndaj Policisë së Kosovës përfshinë vlerën për shërbimin e bërë për periudhën 23 – 30 Nëntor 2016 (7 ditësh). Fatura për muajin dhjetor ende nuk është pranuar deri në raportimin e pasqyrave financiare.
- 1.2 **Ofrues Shërbimesh për shërbime të ndryshme për NSh-të para se të hyjnë në likuidim** – Pagesat prej EUR 41,363.90. Këto raste përfshijnë angazhimin e OSh-ve për arkivat dhe mbledhjen e dokumentacioneve të ndryshme lidhur me 20%e punëtorëve, kërkesat e kreditorëve apo raste të tjera.
- 1.3 **Pagesat ndaj BSPK-së** - pagesat prej EUR 38,971.62 për kompensimin e shpenzimeve mujore që kryejnë aktivitetet e tyre në teren dhe e bëjnë shpërndarjen e 20% të punëtorëve. Ky kompensim bëhet sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.
- 1.4 **Blera e Licencës për përdorimin e softuerëve.** Shuma prej EUR 5,288.99.
- 1.5 Pagesa ndaj Administratës Tatimore dhe Trustit pensional në shumën prej EUR 10,041.96 si p.sh. për ofruesit e shërbimeve
- 1.6 Shërbime për përkthime në shumën prej EUR 4,250
- 1.7 Pagesa prej EUR 9,654 për punëtorin dy ditore për amandamentimit akteve nënligjore për shitje, për mbledhjen ekzekutive të Menaxhmentit dhe misionin tregtar në ShBA.
- 1.8 Pagesa prej EUR 2,442.06 si shpërblim në përputhje me rregulloren e shërbyesve civil (një pagë) dhe atë të punës (tri paga) për dy ish-punëtorët e AKP-së të cilët kanë dalë në pension.
- 1.9 **Tjera**- Pagesat prej EUR 5,327.00 janë obligimet ndaj “Six Stars Media” në vlerë prej EUR 2,935 dhe raste të tjera të ndryshme.

2 Shërbimet të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse në shumën prej EUR 348,898:

- 2.1 **Shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse - (Kompensimi i Anëtareve të Bordit të AKP-së).** Pagesat neto prej EUR 273,349.96 për periudhën Dhjetor 2015 – Dhjetor 2016 (pagesa për kompensimit për muajin dhjetor 2015 është bërë në fillim të vitit fiskal 2016). Pagesat për kontribute dhe tatime në shumën prej EUR 48,092.24 (detajet shih tek shënimi 3.2.1)
- 2.2 Gjithsej pagesat totale prej EUR 27,456.00 për vlerësimin dhe auditimin e Ndërmarrjeve Shoqërore me kushte të veçanta. Buxheti i ndarë për këto raste është EUR 150,000.00. Arsye e mos shpenzimit të buxhetit të paraparë ka qenë edhe pranimi i ofertave nga kompanitë fituese më çmime shumë të ultë.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

3 Shpenzimet – vendimet e Gjykatave në shumën prej EUR 25,890:

3.1 Pagesa prej EUR 14,123.77 (neto) për 50% të pagave të papaguara për kthimin e zyrtarit në punë. Gjithashtu në vlerën e pagave të pa paguara përfshirë edhe kontributet dhe tatimet në vlerë prej EUR 2,687.05;

3.2 Shuma prej EUR 9,079.01 vendim i përmbauesit privat për pagesën e obligimeve (shërbime 2013) ndaj gazetës vendore. Këto obligime në pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2015 janë paraqitur si detyrime kontingjente. Shuma prej EUR 9,079.01 përshin interesin dhe koston e përmbauesit privat.

Shënim:

Sistemi i kontabilitetit i AKP-së për vitin 2016, ka qenë ndryshe nga struktura e re e raportimit, nga e cila është nxjerrë nga Ministria e Financave më datën 18 Janar 2017 jemi njoftuar me këtë rregullore, e cila është e zbatueshme edhe për vitin 2016.

Ndryshimet e kësaj rregullore kryesisht vijnë me ndryshimet e bëra në Ligjin e Buxhetit dhe formularët e vitit 2017. Sidoqoftë, AKP ka zbatuar kërkesën nga Thesari dhe përshtat kode e reja me buxhetin e vitit 2016.

Sipas rregulloreve të mëparshme, për dallim nga kjo rregullore, nuk është raportuar buxheti në kode detaje të shpenzimeve si p.sh. për kodin “shpenzimet e akomodimit zyrtarë jashtë vendit”. Për rastin e marrë shembull, AKP ka pasur të strukturuar buxhetin në nivel të nënvijave buxhetore si p.sh. nënvija buxhetore “Udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit” brenda të cilës janë përfshirë më shumë kode detaje të shpenzimeve të tilla si: shpenzimet e tjera brenda vendit; shpenzime e tjera jashtë vendit; shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit dhe shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit.

Për situata të tilla, me qëllim të zbatimit të rregullores së re, në disa raste, AKP-ja ka bërë shpërndarjen e buxhetit në nivel të kodeve në detaje për shpenzimet, aty kanë ndodhur.

3.2.1. Shpalesje e Pagesave ndaj Anëtarëve të Bordit të AKP-së

Për periudhën raportuese pagesat neto të realizuara ndaj Anëtarëve të Bordit të AKP-së rezultojnë me situatat e mëposhtmet cilat janë si më poshtë:

Përshkrimi	Gjithsej pagesat bruto	Kontributet	Kontributet	Tatimi i mbajtur në burim	Pagesat neto të realizuara
Për mbledhje të Bordit	295,640.00	11,371.00	11,371.00	28,714.92	258,211.78
Për komisionet	17,399.52	580.05	580.05	1,682.04	15,137.43
Gjithsej	313,039.52	11,951.05	11,951.05	30,396.96	273,349.21

* **Shënim:** Është pasqyrë e të dhënave të nxjerra nga EDI –sistemi i Administratës Tatimore të Kosovës.

Pagesat e realizuara gjatë vitit 2016 kanë të bëjnë me aktivitetet e mëposhtme:

1. Mbledhjet e Bordit – 16 mbledhje (mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme), duke e përfshirë pagesën për mbledhjen e muajit Dhjetor 2015 të paguar në fillim të 2016;

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

2. Mbledhje te Komisionit për aprovimin e raporteve të Kontraktorit te likuidimit (për kontratën deri me 10 korrik 2016) – 8 mbledhje. Janë shqyrtuar raportet e kontaktonit edhe për një periudhë të vitit 2014, tërë vitin 2015 dhe raportin 1 Janar- 10 Korrik 2016.
3. Mbledhje te Komitetit te Auditimit – 4 mbledhje për shqyrtimin e raporteve të Auditimit.

SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE

Përshkrimi	Buxheti	2016		Gjithsej	Kraha sim	2015	2014
	Final € '000	GQ € '000	THD € '000	Pagesat € '000		€ '000	€ '000
Rryma	61,300	-	61,034	61,034	100%	72,151	61,822
Uji	6,500	-	4,968	4,968	76%	1,766	2,023
Mbeturinat	4,200	-	3,045	3,045	73%	2,982	3,193
Ngrohja Qendrore	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet telefonike	26,000	-	4547	4,547	17%	8,080	10,599
Pagesa-vendimet gjyqësore	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime komunale	98,000	-	73,594	73,594	75%	84,980	77,636

Për periudhën raportuese, burim i financimit për shërbime komunale janë të hyrat e dedikuara të Agjencisë. Pagesat e shërbimeve publike përfshijnë të gjitha pagesat për zyrat e ndara sipas regjioneve, zyrat satelitore (Gracanicë, Shtërpcë dhe Leposavic) dhe zyrën Qendrore të Agjencisë.

SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Përshkrimi	Buxheti	2016		Gjithsej	Krahasim %	2015	2014
	Final € '000	GQ € '000	THD € '000	Pagesat € '000		€ '000	€ '000
Subvencione për entitetet publike	90,000	-	78,809.16	78,809	88%	116,003.14	63,300.01
Subvencionet për entitetet publike (tea.bib)				-			
Subvencione për entitetet jopublike				-			
Subvencione dhe transfere	90,000	-	78,809	78,809	88%	116,003	63,300

Për periudhën raportuese, burim i financimit për subvencione dhe transfere janë të Hyrat e Dedikuara të Agjencisë. Sa i përket të hyrave të dedikuara, shuma prej EUR 90,000.00 është për të mbështetur funksionin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në Administrim Direkt të AKP-së me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së këtyre Ndërmarrjeve para privatizimit.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Ndërsa shuma prej EUR 400,000 e ndarë si Grant Qeveritar tek programi “Riorganizimi dhe Administrimi i NSh-ve- Trepca”, është transferuar në këtë kategori. Kërkesa e AKP-së ka qenë që shuma totale prej EUR 1,816,039 të transferohen tek mallrat dhe shërbimet, por janë transferuar EUR 400,000 si subvencione dhe EUR 1,416,039 si mallra dhe shërbime. Kjo ndarje e shpërndarjes të subvencionit është bërë pa kërkesën e AKP-së.

Në fund të vitit shuma prej EUR 400,000 është reduktuar me vendim të Qeverisë nr. 01-123.

SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE

Përshkrimi	Buxheti	2016		Gjithsej	Krah	2015	2014
	Final	GQ	THD	Pagesat	asimi		
	€	€	€	€	%	€	€
Vetura Zyrtare	-	-	-	-	-	-	92,900
Ndërtesat administrat.afar	-	-	-	-	-	-	-
Rrethoja	-	-	-	-	-	-	-
Garazha	-	-	-	-	-	-	-
Trotuaret	-	-	-	-	-	-	-
Kanalizimi	-	-	-	-	-	-	-
Ujësjiellësi	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja investive	20,000	-	2,655	2,655	13%	-	-
Paisje të teknologjis inform	10,000	-	9,948	9,948	99%	46,700	-
				-			
Shpenzime Kapitale	30,000	-	12,603	12,603	42%	46,700	92,900

Për periudhën raportuese, burim i financimit për investime kapitale janë të hyrat e dedikuara të Agjencisë.

Për vitin 2016 janë dy projekte kapitale të aprovuara:

1. Pajisjet mbi EUR 1,000 brenda shpenzimeve kapitale dhe
2. Riparimi i ndërtesës së AKP-së dhe Zyrave Rajonale

Gjatë periudhës raportuese, janë realizuar gjithsej katër pagesa në vlerën prej EUR 12,603 si më poshtë:

- Furnizim me Skaner digjital për nevojat e Bordit të Drejtorëve EUR 3,148
- Furnizim me pajisje për “backup” të serverëve EUR 5,500;
- Riparimi i zyrave Menaxheriale në ZQ në shumën prej EUR 2,655; dhe
- Furnizimi me pajisje të TI “Laptop” EUR 1,300;

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Gjatë periudhës raportuese është bërë edhe investim në vijim për Zyrat Regjionale në Zyrën Qendrore të AKP-së në shumën prej EUR 2,655.00. Këto nuk regjistrohen në regjistrin e pasurive kapitale, por prezantohet shpenzimin e krijuar në këtë kategori.

SHËNIMI 7 KTHIMI I HUAMARRJEVE

Agjencia nuk është e përfshirë në huazimin e fondeve.

SHËNIMI 8 TJERA

AKP-ja mban depozitat e ofertuesve për pjesëmarrje në tender si depozitë e sigurisë, por që janë menjëherë të kthyeshme në rastin kur ofertat e tyre nuk pranohen. Rastet kur ofertuesit janë fitues të përkohshëm dhe nuk i plotësojnë kriteret tjerë, depozitat e tyre konfiskohen dhe njihen si të hyra. Rastet e tilla paraqiten si të hyra në nr.11 të shënimeve shpjeguese.

Detaje të tjera janë të paraqitura në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

SHËNIMI 9 TË HYRAT TATIMORE

Nuk janë pjesë e pasqyrave financiare të Agjencisë.

SHËNIMI 10 TË HYRAT JO TATIMORE

Të hyrat nga licencat, të hyra nga pasuritë, të hyra nga shitja e shërbimeve, gjoba dhe taksa të aplikueshme nga AKP-ja në këtë kategori, për këtë periudhë raportuese nuk ka të hyra të kësaj natyre.

Të gjitha të hyrat e realizuara që trajtohen dhe janë për AKP-në, njihen si të hyra të dedikuara. Për detaje, referojuni shënimit shpjegues nr. 11

SHËNIMI 11 TË HYRAT E DEDIKUARA

Në bazë të nenit 21 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të hyrat e dedikuara janë përshkruar si më poshtë:

1. Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operativeve; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia menjëherë transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

pajtim me rregullat ne fuqi të LMFP-së; Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë;

2. Të gjitha të ardhurat e dedikuara të Agjencisë i nënshtrohen procesit të përvetësimit të krijuar nga LMFP për agjencitë e pavarura. Çdo e hyrë e tillë e dedikuar që nuk është përvetësuar nga Agjencia për t'u shpenzuar gjatë vit kalendarik sipas Ligjit përkatës të përvetësimit vjetor, mbahet në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë dhe mund të shfrytëzohet vetëm për bërë përvetësime në të ardhmen për Agjencinë.

Përshkrimi	Shënime	2016	2015	2014	% e	
		€	€	€	% e totalit 2016	ndryshimi t nga 2015
ati1 - Interes i fituar mbi tarifën administrative të Agjencisë		-	500	9,677		-100.0%
ati2 - 5% e shitjeve nga likuidimi		6,778	546,163	789,713	0.86%	-98.8%
ati3 - 5% nga shitja prej privatizimit		165,693	-	139,724	21.08%	100.0%
ati4 - 5% e të ardhurave të komercializimit		-	-	-		-
ati5 - 5% e të ardhurave të tjera nga NSH nëse ka		-	-	-		-
ati6 - nga Fondi Rezervë i AKP-së		-	-	(70,000)		-
ati7 - nga Llogaria për Deponimin e Ofertës për Privatizim		-	-	-		-
ati8 - nga Tarifa për Dorëzimin e Ofertës për Privatizim		267,527	(28,690)	(100,000)	34.04%	
ati9 - nga Llogaria për Deponimin e Ofertës në Likuidim		-	31,407	-		
ati10 - nga Tarifa për Regjistrim për Likuidim		335,609	-	-	42.70%	
ati11 - 5% e interesit në Llogarinë Bankare të Likuidimit		-	-	-		-
ati12 - nga llogaria për Deponimin e Shqyrtimit të Likuidimit		-	5,487	-		
Konfiskimi I depozitave nga valët e privatizimit		-	-	143,000		
Konfiskimi I depozitave nga valët shitja e aseteve përmes likuidimit		-	-	97,500		
Inkasimet nga përdorimi i telefonisë fikse dhe mobile		10,418	4,800	10,976	1.33%	
Inkasimet e kapitalit themeltar të paguar më parë.			60,369			
Gjithsej		786,025	620,034	1,020,590	100%	-1

Inkasimet janë të njohura në momentin që realizohen transaksionet në të mirë të llogarisë bankare.

Në tabelën e mësipërme, shumat janë të paraqitura për periudhat raportuese fiskale, ndërsa inkasimi i vlerës në total për të gjitha periudhat është në vlerën prej **EUR 40,617,992**. Nga kjo shumë e inkasuar, janë transferuar për vitet fiskal 2012 – 2016 të AKP-së që janë aprovuar nga Kuvendi i Kosovës buxheti në vlerë prej EUR 30,348,000 dhe atë:

1. Me datën 28 Maj 2012, të transferuara shumën prej EUR 8,200,000.00 për vitin fiskal 2012;

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

2. Me datën 28 Dhjetor 2012, të transferuara shumën prej EUR 8,048,000.00 për vitin fiskal 2013;
3. Me datën 18 Nëntor 2014, të transferuara shumën shtesë prej EUR 2,300,000.00 për vitin fiskal 2014;
4. Me datën 15 Janar 2015, të transferuara shumën shtesë prej EUR 5,500,000.00 për vitin fiskal 2015; dhe
5. Me datën 15 Janar 2016, të transferuara shumën shtesë prej EUR 6,300,000.00 për vitin fiskal 2016.

Gjithashtu, para se të fillohet të operohet me llogarinë e tarifës administrative, gjatë vitit 2011 janë transferuar gjithsej EUR 1,800,000. Prandaj, duke pasur parasysh edhe transferin e mjeteve për e vitit 2011, transferuara për buxhetet e AKP-së për vitet fiskale për operimi të aktiviteteve të saj janë në TOTAL EUR 32,148,000 (30,348,000 +1,800,000).

Mjetet e paraqitura që janë shpalosur më lartë, nga pika katër deri në gjashtë, janë transferuar vetëm për ato shuma shtesë të nevojshme për të mbuluar buxhetin e periudhës fiskale, pasi që kemi pasur mjete të pa shpenzuar dhe këto mjete sipas Ligjit të Buxhetit dhe të AKP-së barten në vitin e ardhshme.

Në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit janë paraqitur vlerat e buxhetura dhe jo sumat e transferuara.

Detajet e tjera të pagesave për fondet në mirëbesim, janë të paraqitura në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

SHËNIMI 12 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka përfituar Grante nga Donatorët.

SHËNIMI 13 HUAMARRJET

Agjencia nuk është e përfshirë në huazimin e fondeve.

SHËNIMI 14 TË ARKËTUESHMET

		2016	2015	2014
Kodi				
ekonomik	Përshkrimi	€	€	€
61000	Shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile	3,128.63	5,769.83	7453.63
Gjithsej		3,128.63	5,769.83	7453.63

Sipas politikës dhe procedurave për telefoninë fikse dhe mobile, AKP-ja për stafin dhe menaxhmentin mbulon një pjesë të shpenzimeve të krijuara. Shuma e tejkaluar mbi kufirin e caktuar kompensohet nga punëtorët dhe menaxhmenti.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Gjendja e faturave të papaguara gjatë vitit 2016, përfshinë periudhën e faturimit deri më 30 Tetor 2016

Më poshtë, janë të paraqitura ngjarjet lidhur me llogaritë e farkëtueshme, gjendjen në fillim të vitit dhe faturimin e ndodhur Janar –Tetor 2016

1. Bilanci fillestar më 1 Janar 2016 Gjithsej EUR 5,769.83;
2. **PLUS** - Faturimi nga PTK – Vala për periudhën Janar – Tetor 2016. Ky faturim përfshinë vetëm situatat për rastet të cilat zyrtarët kanë kaluar limitin e mbuluar nga AKP-ja. Gjithsej shuma është EUR 12,481;
3. **MINUS** inkasimi i obligimeve të krijuara nga telefonja mobile nga stafi i AKP-së dhe ndalesat që janë bërë nga pagat e tyre në vlerë prej EUR 15,122.2;
4. Gjendja në fund të periudhës 3,128.63.

Shënime e detaje të tjera:

Menaxhmenti më datën 8 Shtator 2014 ka marrë vendim për ndalesë në pagë ndaj stafit të AKP-së për obligimet e papaguara. Vendimi ekzekutues përfshinë ndalesën deri në 50% të pagës mujore bruto deri në inkasimin e plotë të obligimeve.

Duke llogaritur edhe zbritjen e ndalesës në pagë, atëherë shuma e papaguar është EUR 2,322.03 (3,128.63 – 806.60). Ky obligim, gjatë vitit 2017 do të trajtohet nga Menaxhmenti pasi që ky obligim kryesisht i përkasin periudhës para marrjes të vendimit Shtator 2014, për ndalesë në pagë për personat të cilët nuk janë më pjesë e stafit të AKP-së.

Nga kjo rrjedhë se nga obligimet e papaguara të faturimit deri më 31 Tetor 2016 pas shumës të ndalur në paga prej EUR shuma prej EUR 806.60 është realizuar nga ndalesat në paga e muajit Janar 2017. Faturimi për muajin Nëntor dhe Dhjetor 2016 është bërë më 20 Janar 2017.

SHËNIMI 15 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA

Kodi ekonomik	Kategoria ekonomike	2016 €	2015 €	2014 €
11	Paga dhe roga			
13	Mallra dhe shërbime	14,167	2,868	2,822
14	Shpenzime komunale	1,511	580	1,137
20	Transfere dhe subvencione			
30	Shpenzime kapitale			
Gjithsej		15,678	3,449	3959

Ky bilanc është i raportuar edhe në raportin e faturave të papaguara deri më 31 Dhjetor 2016 në Ministrinë e Financave dhe Buxhetit.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Ndërsa shumat që kanë tejkaluar afatin prej 30 ditësh për pagesë pas datës të pranimit është EUR 730.80. Për më tepër sqarime janë paraqitur në shënimet shpjegues nr. 27 – Detyrimet Kontingjente dhe Detajet janë të paraqitura edhe në aneksin (shtojcën) e pasqyrave financiare.

SHËNIMI 16 DETYRIMET KONTINGJENTE

Natyra e detyrimeve kontingjente	Arsyeja për detyrime	2016	2015	2014
		€	€	€
Pezullim nga puna për punëtorët të AKP-së	Llogaritja e 50% të pagës bruto (duke e përfshirë edhe 5% e punëdhënësit) për 10 punëtorët e AKP-së. Kjo në përputhje me ligjin shërbyesit civil	174,440.18		
Shërbime për mirëmbajtje të fotokopjesë	EUR 215.86 janë të papaguara nga kjo fature, një pjesë janë pa kontratë dhe kemi gabim në faturim F-15-2295	215.86	215.86	215.86
Shërbime për mirëmbajtje të fotokopjesë	Fatura me nr. SH-1089/2016 lidhur me shërbimet e fotokopjimit është në vlerë prej € 1,232.09, janë paguar vetëm € 600. Pjesa prej € 632.09 nuk ka pasur mbulës në kontratë.	632.09	-	-
Shërbimet e përkthimit	Fatura me nr.IN2413 lidhur me shërbimet për përkthime është në vlerë prej € 654.79, janë paguar € 474.39. Për pjesën prej € 180.4 shtetë tejkaluar vlera e kontratës.	180.40	-	-
Shërbimet për marrjen me qira të paisjeve për zërim dhe përkthim simultant	është tejkaluar vlera e kontratës për 4 fatura.Shuma për faturë është EUR 170.	-	680.00	680.00
Shërbime të dizajnit të broshurave	është tejkaluar vlera e kontratës	-	2,935.00	2,935.00
Shërbime të shpejta postare	Janë pranuar katër (4) fatura të cilat nuk kanë kontratë për ofrimin e këtyre shërbimeve. Paraqitet si detyrim kontingjent, në rast të padisë gjyqësore.	-	252.40	252.40
Shtypja e materialeve promovuese	EUR 260 janë të papaguara nga kjo faturë 15-210-001-2749, tejkallim i sasise për një artikull	-	260.00	260.00
Shpalljet për njoftimet në gazeta	Janë pranuar njëzetë e shtatë (27) fatura të cilave u është tejkalluar vlera e kontratës dhe për të cilat kontrata nuk ka mbuluar periudhën për ofrimin e këtyre shërbimeve.	-	14,960.55	14,960.55
Gjithsej		175,468.53	19,303.81	19,303.81

Detyrimet kontingjente paraqiten në rastet kur malli dhe shërbime i pranuar nuk është në përputhje me kushtet e kontraktuara. Gjithashtu, AKP-ja llogaritë edhe shpenzimet të cilat mund të ndodhin në të ardhmen, të cilat nuk janë në kontrollin e saj apo nëse mund të quhen ndryshe “faktorët e jashtëm”.

Vlera e përgjithshme e detyrimeve kontingjente deri më 31 Dhjetor 2016 është EUR 175,468.53.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Detyrimet kontingjente më 31 Dhjetor 2015 kanë qenë 19,303.81. Nga kjo vlerë janë bërë në tërësi pagesat e obligimeve.

Ndërsa ndryshimet që kanë ndodhur është si rrjedhojë që kemi shtuar obligimin e mundshme që mund të ndodh për 10 zyrtarët që janë pezulluar me pagesë 50% si më poshtë:

1. MINUS – pagesa e realizuar në shumën prej EUR 2,935 për shërbimet të Dizajnit dhe Broshurave.
2. MINUS – bartja në llogari të pagueshme shuma prej EUR 252.40 – Shërbime të shpejta postare.
3. MINUS – bartja në llogari të pagueshme shuma prej EUR 680.00 për shërbimet e dizajnit dhe broshurave.
4. MINUS pagesa e realizuar prej EUR 260.00 për shtypjen e materialeve promovuese (para vendimit).
5. MINUS – bartja në llogari të pagueshme shuma prej EUR 478.40 dhe pagesave prej EUR 19,482.15 për shpalljeve në gazeta. Këto shërbime kanë qenë si detyrime kontingjente më 31 Dhjetor 2015 si rezultat i tejkallimit të vlerave të kontratave për shërbimet e vitit 2013. Shih shumën prej EUR 14,960.55 tek pasqyrat financiare Janar – Dhjetor 2016.
6. **PLUS - Shuma shtesë ndër vite prej EUR 174,440.18.** Llogaritja e 50% të kostos së pagës (pagës bruto plus 5% i punëdhënësit) pezullimi nga puna në përputhje me ligjin për shërbyesit civil të Kosovës. Gjendja e llogaritur është bërë për 10 zyrtar të suspenduar të AKP-së që paguhën me 50% të pagës. Prandaj, janë përfshirë në listën e detyrimeve kontingjente. Përndryshe ndryshimi nga vitit 2015 i detyrimet kontingjente me vitin 2016 do të ishin vlerën prej EUR 1,028.35.
7. PLUS – dy raste që kanë tejkallim të vlerës/kushteve të kontratës në shumën totale prej EUR 812.49.

Detyrimet kontingjente të paraqitura më 31 Dhjetor 2015, të cilat janë paguar gjatë vitit 2016 janë si rrjedhojë e vendimit të datës 1 Shtator 2016 nga Menaxhmenti i AKP-së. Ky vendim është marrë si rezultat i shmangies të kostos së lartë për Agjencinë, në rast se çështjet do të trajtohen nga një organ tjetër ekzekutiv (përmbaues privat apo gjykatë kompetentet) siç ka ndodhur në dy raste kur e drejta është fituar nga operatorët ekonomik përmes përmbauesve dhe janë paguar taksat dhe interesi shtesë krahas obligimit.

SHËNIMI 17 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)

Klasifikimi i pasurive	2016	2015	2014
	€	€	€
Ndërtesat	127,571	131,457	135,343
Toka	-	-	-
Pajisjet	51,255	75,678	57,614
Infrastruktura	-	-	-
Makineria	-	-	-
Automjetet	77,083	127,236	190,268
Tjera	19,966	27,702	35,438
Gjithsej	275,875	362,073	418,663

* janë paraqitur vlerat neto pas zhvlerësimit të realizuar deri më 31 Dhjetor 2016

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Zhvlerësimi i pasurive:

AKP raporton koston historike, zhvlerësimin dhe vlerën neto të pasurive deri më 31 Dhjetor 2016. Të dhënat janë të harmonizuara me raportin e Ministrisë së Financave.

Vlera neto e pasurive kapitale deri më 31 Dhjetor 2016 është EUR 275,875.

Komisionit për Verifikimin e Aseteve gjatë vitit 2016 ka bërë kontrollimin dhe identifikimin e asetëve të AKP-së. Nëse një pasuri është ende në përdorim, mbahet në Regjistrin e Pasurive të AKP-së edhe nëse vlera e tyre për llogaritje është zero. Pasuritë të cilat nuk janë në përdorim (të dëmtuara) mbahen në regjistër deri në momentin e asgjësimit të pasurisë bazuar në Udhëzimin Administrativ të MF-së.

Detajet janë të paraqitura në aneksin e pasqyrave financiare

SHËNIMI 18 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO)

Klasifikimi i pasurive	2016 €	2015 €	2014 €
Pajisjet dhe mobiljet	90,121	73,533	74,368
Gjithsej	90,121	73,533	74,368

Sa i përket llogaritjes së zhvlerësimit (udhëzimet UA 2009/21 dhe rregullorja 2/2013 e datës 18 Nëntor 2013 e MF-së për menaxhimin e pasurive) ato janë të paraqitura si më poshtë:

- Zhvlerësimi bëhet sipas metodës drejtvizore bazuar në jetë gjatësinë e përdorimit të pajisjes.
- Llogarita e zhvlerësimit nuk bëhen në muajin e parë të blerjes;

Meqenëse nuk ka udhëzues nga Ministria e Financave se si të kalkulojnë zhvlerësimet për inventar, ne kemi zhvlerësuar sipas metodës të sipërshtuar.

SHËNIMI 19 RAPORT PËR TË HYRAT E DEDIKUARA

	2016 €	2015 €	2014 €
Të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar	863,529	1,315,428	4,477,444
Të hyrat vetanake të pranuar në këtë vit	6,311,932	5,507,796	2,306,194
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	7,175,461	6,823,224	6,783,638
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	(6,303,375)	(5,959,695)	(5,468,210)
Shuma e mbetur për bartje	872,086	863,529	1,315,428

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Shpenzime e paraqitura në tabelën më lartë “Shuma e shpenzuar në vitin aktual” janë nga mjetet e buxhetuara prej Hyrave të Dedikuara (kodi 23) në vlerën prej EUR 6,303,375 plus edhe shpenzimet nga Buxheti i Kosovës (kodi 10) në vlerën prej EUR 9,515.

SHËNIMI 20 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE

Departamenti	punëtorëve në Ligjin e	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2016		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2015		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2014	
	I aprovar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti i Administratës	258	248		250		250	
Gjithsej							

Agjencia Kosovare e Privatizimit, në tabelën e mësipërme ka paraqitur numrin e punëtorëve sipas programit buxhetor në Ministrinë e Financave. Për sqarim, ky numër i punëtorëve nuk është vetëm në këtë Departament, por në Departamentet, Njësitë dhe 5 Zyrat Rajonale të AKP-së.

Shpalosja në detaje janë bërë në tabelën numër 2 për paga dhe rroga.

SHËNIMI 21 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE ME KONTRATE PËR SHËRBIME TE VEÇANTA PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE

Departamenti	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2016		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2015		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2014	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti i Likuidimit	10	-	5	-	-	-
Departamenti i Shitjes	4	-	-	-	-	-
Njesia e Rirorganizimit	6	-	-	-	-	-
Gjithsej	20	-	5	-	-	-

AKP-ja ka angazhuar Ofruesit e Shërbimeve për çështjet që kanë të bëjnë si më poshtë:

- Departamenti i Likuidimit** –Këto shërbime kanë të bëjnë me dhe për NSh që janë në transicion: regjistrimin e kërkesave, ekzaminim fizik të pasurive dhe dokumentacionit, mbledhja e regjistrimeve të inventarit; listat e të punësuarve për shpërndarjen e 20%; emrat e kreditorëve dhe dokumentacionit dhe arkivimi i tyre për disa Ndërmarrje.
- Departamenti i Shitjes** - Pas përfundimit të kontratës me operatorin ekonomik për ruajtjen e aseteve për NSh-të në fazën e privatizimit para se të hyjnë në likuidim, janë angazhuar disa ofrues të shërbimeve për ruajtjen e aseteve për disa NSh.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

3. **Njësia e Riorganizimit dhe Administrimi Direkt i NSh-ve** –Gjithashtu, si në Departamentin e Shitjes, AKP-ja për NSh-të të cilat i ka nën administrim direkt, ka angazhuar Ofrues të Shërbimeve për ruajtjen e aseteve, dhe këtë pas përfundimit të kontratës me operatorin ekonomik.

AKP-ja ka të ndarë dhe aprovuar buxhetin nga Kuvendi i Kosovës për nënvijat buxhetore dhe programet buxhetore të shënuar më sipër. Detajet e pagesave janë të paraqitura në shënimin shpjegues nr. 3 “Mallra dhe Shërbime”.

SHËNIMI 22 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Më poshtë po paraqesim vetëm një raport të Adresimit përkatës të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) sipas vitit fiskal që është Audituar.

	1	2	3	4	5=sum(1:4)	1	2	3	4	5=sum(1:4)
Viti	Tejkaluar	Zbatuar	Jo	Pjesërisht	Gjithsej	Tejkaluar	Zbatuar	Jo	Pjesërisht	Gjithsej
2013	3	19	1	2	25	12%	76%	4%	8%	100%
2014	5	16	1	3	25	20%	64%	4%	12%	100%
2015	0	14	0	8	22	0%	64%	0%	36%	100%
2016	0	0	0	0	0	0%	0%	0%	0%	0%
Gjithsej	8	49	2	13	72	11%	68%	3%	18%	100%

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: Janë paraqitur në raportin e aktiviteteve të AKP-së në detaje për secilën rekomandim apo të gjetur “matrica e detajuar mbi përcjelljen dhe adresimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)”

- **FUND** -

MATRICË E DETAJUAR MBI PËRCJELLIEN E ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

për auditimet deri më 31-Dec-15

plani azhurnuar më 28-Dec-16

		sipas përcaktimit nga Menaxhmenti				rekomandimet			
		Tejkualuar	Po	Jo	Pjesërisht	Tejkualuar	Po	Jo	Pjesërisht
		11%	68%	3%	18%	11%	68%	3%	18%
GJITHSEJ		72	8	49	2	13			
		11%	68%	3%	18%	11%	68%	3%	18%
nëse filtrohen		72	8	49	2	13			

72

SIPAS PLANIT TË RI TË ADRESIMIT TË PËRCAKTUAR NGA MENAXHMENTI

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	
Nr.	Indeksi	Viti	TË GJETURAT	REKOMANDIMI I ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	Afati i VJETËR për zbatim	Arsyeja e mos implementimit	Tejkualuar	PO	JO	Pjesërisht	Njësia organizative përgjegjëse për zbatim	Afati për adresim	Indeksi (për zbatim)	Veprimi i planifikuar	Monitorimi i zbatimit nga Bordi i Drejtorëve / Menaxhmenti	
1	BID	2013	Mos aplikimi i ndëshkimeve dhe falja e tyre për disa blerës të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet	Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i AKP-së: Duhet të rishikojnë bazën sipas të cilës ndëshkimet e shqiptuara financiare janë falur, të konsiderohet ndikimi i këtij vendimi dhe çfarë veprime janë të nevojshme dhe nëse një zotim nuk përmbushet duhet t'i nënshtrohet ndëshkimit adekuat, financiar dhe ligjor.	31-12-2014				1		Bordi i Drejtorëve	30-Jun-17	BID			
2	M	2014	AKP nuk e ka kryer vlerësimin e rregullt të performancës së stafit	Menaxhmenti i AKP-së: Të siguroj që në 2015 të aplikohen vlerësimet e performancës për të gjitha gradat menaxheriale.	31 janar 2016				1		Menaxhmenti	31-Jan-17	M			
3	AL	2015	Shfrytëzimi i lokaleve nga qiramarrësi në mungesë të kontratës së nënshkruar.	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë se të gjitha kontratat për qiratë të jenë të nënshkruara nga qiramarrësit.	31 dhjetor 2016					1	Autoriteti i Likuidimit	31-Mar-17	AL	Do të riinicohen bisedimet me TV21		
4	BID	2014	Mbledhja, monitorimi dhe trajtimi i llogarive të arkëtueshme	Menaxhmenti i AKP-së: Të implementoj një politikë formale për llogaritë e arkëtueshme e cila përfshinë një vlerësim të arkëtimit, monitorimit dhe raportimit të vazhdueshëm si dhe ti aplikoj të gjitha opsionet, përfshirë masat ligjore, për të siguruar realizimin e pagesave të dakorduara.	Kjo politikë është zbatuar në Dhjetor 2014.					1	Bordi i Drejtorëve	30-Jun-17	BID			
5	DA	2015	Obligimet paraprake paguhen në vitin 2015	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë se është ndërtuar një sistem i besueshëm i kontrollit për pranimin e faturave, pagesën e tyre brenda afatit ligjor si dhe prezantimin e obligimeve në PVF.	31 dhjetor 2016	Departamenti i Administratës dhe ai i Financave kanë qene duke e analizuar te gjendet menyra me e mire qe do ndikonte ne kontrollimin e plote te pranimi te faturave ne tere Agjencine dhe menqenese eshte aprovuar udhezuesi qe rregullon kete ceshtje, pritet qe brenda ketij viti te jete				1	Departamenti i Administratës	31-Jan-17	DA			
6	DFB	2015	Tejkalim i limiteve të shpenzimeve të telefonit	Kryesuesi i BD-së: Duhet të forcojë nivelin e kontroleve mbi menaxhimin e shpenzimeve të telefonisë mobile dhe të krijojë një sistem për arkëtimin e obligimeve të krijuara si rezultat i tejkalimeve të limiteve të nënshkruara.	31 dhjetor 2016						1	Departamenti i Financave dhe Buxhetit	31-Mar-17	DFB		
7	DP	2014	Dobësi sistematike në prokurim	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse vonesat e pagesave janë shfaqur në rastet e lartë cekura dhe pse nuk janë përpiluar urdhërblertjet në kohën e duhur si dhe të aplikoj kontrole të përmirësuara për të siguruar që dobësitë e identifikuara sistematike mos të përsëriten.	31 dhjetor 2015						1	Departamenti i Prokurimit	31-Mar-17	DP		
8	DivSH	2013	Mungesa e rregulloreve të shkruara, të cilat do të rregullonin mënyrën e kontrollit dhe monitorimit të NSH-ve që monitorohen nga AKP	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet të rishikoj objektivat e monitorimit dhe të implementoj një proces monitorimi nga një staf profesional. Kjo duhet të rregullohet në mënyrë që të prodhohen raporte të rregullta mujore për menaxhmentin për të ofruar paralajmërim e hershëm nëse kushtet e kontratave do të plotësohen.	31-12-2014						1	Divizioni i Shitjes	31-Jan-17	DivSH	Njësia e Monitorimit	

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT															
PLANI I ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT DERI MË 31 DHJETOR 2015															
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
Nr.	Indeksi	Viti	TË GJETURAT	REKOMANDIMI I ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	Afati i VJETËR për zbatim	Arsyeja e mos implementimit	Tejkaluar	PO	JO	Pjesërisht	Njësia organizative përgjegjëse për zbatim	Afati për adresim	Indeksi (për zbatim)	Veprimi i planifikuar	Monitorimi i zbatimit nga Bordi i Drejtorëve / Menaxhmenti
9	M	2013	Të ardhurat e arkëtueshme nga fondet në mirëbesim	Menaxhmenti i AKP-së të: Sigurojnë se të gjitha llogaritë e arkëtueshme menaxhohen bazuar në kontratat nëkatëse.	31-12-2014					1	Menaxhmenti	31-Jan-17	M		
10	M	2014	Dorëheqje e stafit në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe zyrtarët ushtrues detyre	Menaxhmenti i AKP-së: Të siguroj se në rastet e dorëheqjeve nga stafi të ndërmerren masat sipas ligjeve në fuqi dhe kontratës së nënshkruar me punëmarrësin. Konsideratë duhet t'i jepet edhe zgjatjes së periudhës për njoftimin e stafit të lartë në 3 muaj. Bordi i ardhshëm duhet të zbatoj procese të hershme të rekrutimit për të siguruar se pozitat e mbuluara me ushtrues detyre plotësohen në mënyrë të përhershme në mundësinë e parë.	30 qershor 2016					1	Menaxhmenti	31-Mar-17	M		
11	M	2015	Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë zbatimin e plotë dhe me kohë planin e rishikuar për adresimin e rekomandimeve. Kjo duhet të monitorohet në baza të rregullta kohore dhe arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak duhet të përcaktohen nga zyrtarët relevant dhe t'i raportohen menaxhmentit.	31 dhjetor 2016					1	Menaxhmenti	31-Mar-17	M		
12	M	2015	Lista kontrolluese e vetvlerësimit	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar	31 dhjetor 2016					1	Menaxhmenti	31-Jan-17	M		
13	M	2015	Dobësi në Kontrollët Menaxheriale	Kryesuesi i BD-së: Të shqyrtojë shkaqet e mosaplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushat e cekura më lartë dhe të sigurojë eliminimin e tyre në mënyrë që të përmirësojë dobësitë në procesin e shpenzimeve.	31 dhjetor 2016					1	Menaxhmenti	31-Mar-17	M		
14	M	2015	Shkallë e ulët e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë se janë hartuar afate të qarta kohore për mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe marrjen e masave ligjore për t'i realizuar ato.	31 dhjetor 2016					1	Menaxhmenti	30-Jun-17	M		
15	M	2015	Mos kryerja e vlerësimit të performancës për të gjithë punonjësit.	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë kryerjen e vlerësimeve të performancës për të gjithë punonjësit.	31 janar 2017					1	Menaxhmenti	31-Jan-17	M		
16	BID	2013	Pagesa për shërbimet e likuidimit nga fondet e NSH-ve në Likuidim	Bordi i Drejtorëve duhet të bashkëpunojë me: Kuvendin për të siguruar qartësi se si duhet buxhetuar kostot për shërbime të likuidimit.	31-12-2014			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID	Është ridorëzuar kërkesa buxhetore në Ministrinë e Financave.	
17	BID	2013	Pagesa për shërbimet e likuidimit nga fondet e NSH-ve në Likuidim	Menaxhmenti i AKP-së duhet të sigurojë që: Të gjitha të ardhurat nga mjetet e realizuara nga shitja, transferimi, likuidimi i NSH-ve, me përjashtim të fondeve tepëricë të mbahen në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët dhe të ruhen nga Agjencia sipas ligjit të AKP-së.	31-12-2014			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
18	BID	2013	Vendosja e anëtarëve të BD në punët ekzekutive të AKP-së	Bordi i Drejtorëve duhet të: Siguroj se ekziston një ndarje e qartë dhe e dokumentuar në mes të rolit të anëtarëve të BD dhe roleve ekzekutive, përmes të cilit fokusi do të ishte tek BD që ofron mbikëqyrje pa qenë nënshtrues.	31-12-2014			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
19	M	2013	Paqartësi dhe mungesë e kontrollave adekuate në pagesat për kompensimin e anëtarëve ndërkombëtar të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.	Menaxhmenti i AKP-së duhet të rivlerësojë kornizën e përgjithshme qeverisëse në lidhje me Bordin e Drejtorëve të AKP-së për të siguruar se: Janë krijuar mekanizma për mbikëqyrje efektive të kompensimeve ndaj anëtarëve.	31-12-2014			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BiD		
20	BID	2013	Mungesa e funksionalitetit të Komitetit të Auditimit (KA)	Menaxhmenti i AKP-së dhe Bordi i AKP-së: Duhet të sigurojnë që të aprovohet statuti i Komitetit të Auditimit.	31-12-2014			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
Nr.	Indeksi	Viti	TË GJETURAT	REKOMANDIMI I ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	Afati i VJETËR për zbatim	Arsyeja e mos implementimit	Tejkaluar	PO	JO	Pjesërisht	Njësia organizative përgjegjëse për zbatim	Afati për adresim	Indeksi (për zbatim)	Veprimi i planifikuar	Monitorimi i zbatimit nga Bordi i Drejtorëve / Menaxhmenti
21	BID	2014	Pagesa për shërbimet e jashtme profesionale në mungesë të buxhetit të aprovuar për "Ofruesin e Shërbimeve Profesionale për Autoritetin e Likuidimit"	Menaxhmenti i AKP-së duhet që: Si pjesë e procesit të rishikimit të buxhetit për 2015, ta rishqyrtoj mundësinë e përfshirjes së shpenzimeve të likuidimit në buxhetin e Agjencisë së AKP-ës. Duhet të identifikohen barrierat dhe të përpilohet plan veprimi për të siguruar se shpenzimet e pritura për likuidim të jenë në tërësi të përfshira në buxhetet e ardhshme të Agjencisë dhe që fondet në besim të mos zvogëlohen përmes transferimeve për t'i mbështetur shpenzimet e Agjencisë.	31 dhjetor 2015			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
22	BID	2014	Pagesa për shërbimet e likuidimit nga fondet e NSH-ve në likuidim	Shih Rekomandimin 1 më lart.	31 dhjetor 2015			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
23	BID	2014	Menaxhmenti ekzekutiv i AKP-së në përbërje jo të plotë	BD i ardhshëm, si çështje me urgjencë: Ta implementoj një orar për rekrutim të pozitave të lira në menaxhmentin e lartë. Kjo do të përfshinte dispozitën për t'i bërë zëvendësimet në menaxhmentin e lartë në të ardhmen, me kohë, atëherë kur paraqiten pozita të lira.	30 qershor 2016			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
24	BID	2014	NJAB e AKP-së nuk kishte arritur të përmbush në plotësi objektivat audituese	BD i ardhshëm dhe Menaxhmenti i AKP duhet të: Sigurojnë rishikimin formal dhe aprovimin e planeve të auditimit të bazuara në rrezik dhe të cilat i pasqyrojnë burimet adekuate duke i ofruar menaxhmentit sigurinë e nevojshme; Ofrojnë monitorim efektiv të implementimit të planeve të auditimit; Implementojnë një Komitet funksional të Auditimit i cili edhe e mbështet edhe e sfidon NJAB-ën dhe që i jep fokus të veçantë cilësisë së raporteve të AB-ës dhe implementimit të rekomandimeve.	30 qershor 2016			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
25	BID	2015	Përpilimi i Pasqyrave Vjetore Financiare të FM-ve dhe AKP-së	Kryesuesi i BD-së: Të rishqyrtoj mundësinë e përfshirjes së shpenzimeve të likuidimit në buxhetin e Agjencisë, në mënyrë që fondet në mirëbesim të mos zvogëlohen përmes transferimeve për t'i mbështetur shpenzimet e Agjencisë.	31 dhjetor 2016			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
26	BID	2015	Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm: Komiteti i Auditimit duhet të rishikoj në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe ti ofroj sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.	30 korrik 2016			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID	Komiteti i Auditimit (i Implementuar)	
27	BID	2013	Mungesë e transparencës në vendimmarrjen e Bordit të AKP	Bordi i Drejtorëve duhet të: Dokumentojë qartë çdo vendim të marrë për aprovim apo refuzim të shitjeve në përputhje me kushtet e përcaktuara me rregullat e nënshtrimit të tyre.	31-12-2014			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
28	BID	2014	Aprovimi/Refuzimi i shitjeve	BD i ardhshëm: Duhet të rikonfirmoj kërkesën që t'i bazojë plotësisht vendimet e pazakonshme përmes analizave të dokumentuara duke e pasqyruar arsyeshmërinë ekonomike dhe gjendjen e tregut.	30 qershor 2016			1			Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
29	BNJ	2014	Testet për rekrutim	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet të siguroj se janë vendosur kontrole efektive të cilat sigurojnë se të gjithë aplikantët legjitim do të ftohen në testimet e konkursave për rekrutim.	31 dhjetor 2015			1			Burimet Njerëzore	31-Dec-16	BNJ		
30	BNJ	2014	Mungesë e kontrolleve për pushimet e lehonisë	Menaxhmenti i AKP-së: Të siguroj se i ka rishikuar arsyet për gabimet e identifikuar dhe t'i përmirësoj kontrollet/udhëzimet për të siguruar se të gjitha pagat kalkulohen dhe paguhen sipas ligjeve në fuqi.	31 dhjetor 2015			1			Burimet Njerëzore	31-Dec-16	BNJ		
31	BNJ	2015	Rekrutimi i punonjësve pa i plotësuar kushtet dhe kriteret e parapara me konkurs	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë që zbatimi i procedurave me rastin e rekrutimit të punonjësve të bëhet konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi për shërbyesit civil.	31 dhjetor 2016			1			Burimet Njerëzore	31-Dec-16	BNJ		

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
Nr.	Indeksi	Viti	TË GJETURAT	REKOMANDIMI I ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	Afati i VJETËR për zbatim	Arsyeja e mos implementimit	Tejkaluar	PO	JO	Pjesërisht	Njësia organizative përgjegjëse për zbatim	Afati për adresim	Indeksi (për zbatim)	Veprimi i planifikuar	Monitorimi i zbatimit nga Bordi i Drejtorëve / Menaxhmenti
32	DA	2015	Mangësi në sistemin e kontrollit për pranimin e shërbimeve/furnizimeve pa u mbuluar me kontratë	Kryesuesi i BD-së: Duhet të inicioj një analizë për furnizimet/shërbimet e marra pa u mbuluar me kontratë dhe të sigurojë që ZKF e ka shtuar fokusin duke ofruar një sistem të besueshëm të kontrollit për shërbimet apo furnizimet e porositura.	31 dhjetor 2016	Nuk pajtohem me kete te gjetur, sido qe te jete, ne mundohemi ne vazhdimesi te rrisim kontrollin dhe besojme qe kjo verehet ne ofrimin e sherbimeve ne perditshmeri		1			Departamenti i Administratës	31-Dec-16	DA		
33	DFB	2013	PFV të AKP-së nuk prezentojnë shpenzimet për shërbimet nga Autoriteti i Likuidimit	Menaxhmenti i AKP-së të sigurojë se: Shpenzimet për Autoritetin e Likuidimit të prezantohen në PVF të AKP-së në vitet e ardhshme.	31-12-2014			1			Departamenti i Financave dhe Buxhetit	31-Dec-16	DFB		
34	DFB	2013	Ekzekutimi i buxhetit	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet të sigurojë se përgatitja e buxhetit është zhvilluar nga një proces rigoroz i vlerësimit i cili reflekton në plotësi të gjitha informatat relevante duke përfshirë edhe shpenzimin e viteve të kaluara duke pasur parasysh ndryshimet e planifikuara.	31-12-2014			1			Departamenti i Financave dhe Buxhetit	31-Dec-16	DFB		
35	DFB	2013	Ekzekutimi i buxhetit	Menaxhmenti i AKP-së: Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet identifikimit të barrierave dhe mundësive për të ngritur përqindjen e ekzekutimit për kategorinë malica dhe shërbime.	31-12-2014			1			Departamenti i Financave dhe Buxhetit	31-Dec-16	DFB		
36	DFB	2013	Ekzekutimi i buxhetit	Menaxhmenti i AKP-së: Monitorimi efektiv i buxhetit vijtor duhet të aplikohet me qëllim që veprimet kohore të ndërmerren për të adresuar variancat përkundër shpenzimeve të planifikuara.	31-12-2014			1			Departamenti i Financave dhe Buxhetit	31-Dec-16	DFB		
37	DFB	2014	Përpilimi i PVF-ve	BD dhe Menaxhmenti relevant i AKP-së duhet: T'i vazhdojnë përpjekjet për t'i thjeshtësuar PVF-ët që tu ofrojnë lexuesve kuptueshmëri më të mirë dhe të ndërlidhen me Ministrinë e Financave/ZAP-in, sipas nevojës, për ta mbështetur këtë proces. Plani i prodhimit të PVF-ve 2015 duhet ta përfshijë një rishikim të detajuar të draft PVF-ve nga menaxhmenti me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë/ose aty ku janë identifikuar gabime në vitet paraprake.	31 dhjetor 2015			1			Departamenti i Financave dhe Buxhetit	31-Dec-16	DFB		
38	DFB	2015	Klasifikim jo i saktë i pasurive	Kryesuesi i BD-së: Duhet të sigurojë që pasuritë regjistrohen në grupimet e pasurive sipas kriterave për rregjistrimin e tyre.	31 dhjetor 2016			1			Departamenti i Financave dhe Buxhetit	31-Dec-16	DFB		
39	DKR	2015	Mos prezantimi i saktë i informatave në dispozicion të publikut me rastin e shitjes	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë se dokumentacioni i shitjes/tenderimit përmban informatat e sakta dhe të drejta në veçanti ato për sipërfaqen e objektit të shitjes. Po ashtu, të sigurojë se është analizuar rasti dhe të kuptojë arsyet e paraqitjes së sipërfaqes së gabuar në dokumentacionin e shitjes përfshirë edhe ato të publikimit.	31 dhjetor 2016			1			Departamenti i Koordinimit Rajonal	31-Dec-16	DKR	Është ndryshuar procedura e shitjes. Tani shqyrtimi i dokumentacionit kadastral dhe ligjor bëhet para publikimit.	
40	DKL	2013	Kualifikimi i punëtorëve jo legjitim për të përfituar nga fondet e 20%	Menaxhmenti i AKP-së duhet të: Vendosië kontrollet shtesë në procesin e konfirmimit të punëtorëve legjitim për të përfituar nga 20%-shi i të ardhurave nga shitja e NSH-ve ashtu që të sigurojë punëtorëve qasje të barabartë që shpërndarjen e fondeve.	31-12-2014			1			Departamenti i Koordinimit të Likuidimit	31-Dec-16	DKL	Komisioni i 20%-it	
41	DKL	2014	Shpërndarja e 20%-shit punëtorëve nga NSH-të e privatizuara përmes Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK)	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet ta amandamentoj marrëveshjen me BSPK-në për të siguruar se janë aplikuar kërkesa të mjaftueshme monitorimi që konfirmojnë se shpërndarja e 20%-shit është bërë ashtu siç është pritur.	31 dhjetor 2015			1			Departamenti i Koordinimit të Likuidimit	31-Dec-16	DKL		
42	DKL	2015	Shpërndarja e 20% punëtorëve të NSH-ve të privatizuara përmes Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK)	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë se është bërë marrëveshja me BSPK-në për të siguruar një monitorim dhe harmonizim se shpërndarja e 20% është bërë ashtu siç është pritur.	31 dhjetor 2016			1			Departamenti i Koordinimit të Likuidimit	31-Dec-16	DKL		
43	DP	2015	Dobësi sistematike në prokurim	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë ndjekjen e procedurave në mënyrë kronologjike ashtu siç përcaktohet me korrigjime rregulluese.	31 dhjetor 2016			1			Departamenti i Prokurimit	31-Dec-16	DP		
44	M	2013	Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Menaxhmenti i AKP-së të sigurojë që: Plani i veprimit, përcakton saktë afate kohore praktike por sfiduese për adresimin e rekomandimeve të bëra, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet dhe rishikohet nga Menaxhmenti	31-12-2014			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
Nr.	Indeksi	Viti	TË GJETURAT	REKOMANDIMI I ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	Afati i VJETËR për zbatim	Arsyeja e mos implementimit	Tejkaluar	PO	JO	Pjesërisht	Njësia organizative përgjegjëse për zbatim	Afati për adresim	Indeksi (për zbatim)	Veprimi i planifikuar	Monitorimi i zbatimit nga Bordi i Drejtorëve / Menaxhmenti
45	M	2013	Zhvillimi i aktiviteteve të privatizimit në mungesë të planit vjetor të punës	Menaxhmenti i AKP-së të sigurojë që: Të hartohet plani vjetor për t'u aprovuar nga BD-ja jo më vonë se tre muaj para se të fillojë viti operativ dhe i cili plan qartazi i prezanton objektivat, resurset dhe aktivitetet.	31-12-2014			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
46	M	2013	Kompania fituese nuk i ka përmbyshur kriteret e kërkuara për kualifikim	Menaxhmenti i AKP-së duhet të: Rishikoj kontrollat për procesin e shitjeve të ndërmarrjeve në të ardhmen dhe të sigurohet se kompanitë fituese i përmbyshin të gjitha kushtet dhe kriteret e vendosura për kualifikim.	31-12-2014			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
47	M	2013	AKP pa bazë ligjore kishte bërë ndryshimin e kushteve të kontratës fillestare për privatizimin e ndërmarrjeve me spin-off special	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet vazhdimisht të monitorojë kontratat me blerësit dhe monitorimi të kryhet në baza të rregullta përfshirë vlerësimin nëse janë arritur apo jo objektivat e privatizimit.	31-12-2014			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
48	M	2013	Vazhdimi i aktiviteteve afariste të blerësit të NSH pa kontratë të nënshkruar	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet të sigurojnë që të gjitha kontratat dhe marrëveshjet me blerësit e NSH-ve të jenë të formalizuara dhe të nënshkruara me kohë nga të gjitha palët.	31-12-2014			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
49	M	2013	Të ardhurat e arkëtueshme nga fondet në mirëbesim	Menaxhmenti i AKP-së: Në mënyrë aktive duhet t'i shqyrtojë të gjitha opsionet, përfshirë edhe mjetet ligjore, për të siguruar se pagesat e pagtuara do të kohen.	31-12-2014			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
50	M	2013	Mungesa e adresimit të mjaftueshëm të rekomandimeve të dala nga NIAJB e AKP-së	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet të zhvilloj një plan të qartë veprimi për të adresuar rekomandimet e NIAJB, i cili konfirmon zyrtarët përgjegjës dhe kohën për korrësin e vendimeve.	31-12-2014			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
51	M	2013	Mungesa e funksionalitetit të Komitetit të Auditimit (KA)	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet të punoj me udhëheqësin e Komitetit të Auditimit për të mbështetur një KA i cili aplikon praktikat më të mira.	31-12-2014			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M	Implementuar	
52	M	2014	Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Menaxhmenti i AKP-së duhet të sigurojë që: Plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Arsyet për mos implementimin e rekomandimeve duhet t'i raportohen menaxhmentit dhe BD-së së ardhshëm në baza tremujore.	31 dhjetor 2015			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
53	M	2014	Menaxhimi i Projektit dhe raportimi nga AKP	BD i ardhshëm dhe menaxhmenti duhet të: Implementojnë një plan vjetor si çështje me urgjencë, i cili demonstroi se objektivat strategjike janë duke u implementuar në mënyrë efektive. Raportimi i jashtëm dhe ai i brendshëm duhet të ndërliken dhe të përdoren si baza për planin e ardhshëm.	31 dhjetor 2015			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
54	M	2014		Menaxhmenti i AKP-së duhet të sigurojë që: Të hartohet plani vjetor për t'u aprovuar nga BD jo më vonë se tre muaj para se të fillojë viti operativ dhe i cili i prezanton qartë objektivat, resurset dhe aktivitetet.	31 dhjetor 2015			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
55	M	2014	Menaxhimi i rrezikut	Bordi dhe Menaxhmenti i ardhshëm duhet t'i: Rishikoj rregullimet ekzistuese të qeverisjes/illogaridhënies si dhe kërkesat jo-ekzistuese për menaxhim të rrezikut të jenë të implementuara deri në shtator 2015 për të siguruar arritjen e objektivave strategjike.	31 dhjetor 2015			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
56	M	2014	Planifikimi i buxhetit	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet t'i rivlerësoj bazat për përcaktim të nevojave për Mallra dhe Shërbime (përfshirë edhe koston për likuidim) dhe ta monitoroj në mënyrë sistematike të performancës buxhetore në baza mujore, t'i identifikoj dhe adresoj barrierat për ta realizuar buxhetin në nivelet e pritura.	31 dhjetor 2015			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M	Në bashkëpunim me Departamentet / Njësitë përgjegjëse brenda AKP-së.	
57	M	2014	Planifikimi i buxhetit	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet ta përpiloj buxhetin bazuar në nevojat reale për staf.	31 dhjetor 2015			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
Nr.	Indeksi	Viti	TË GJETURAT	REKOMANDIMI I ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	Afati i VJETËR për zbatim	Arsyeja e mos implementimit	Tejkaluar	PO	JO	Pjesërisht	Njësia organizative përgjegjëse për zbatim	Afati për adresim	Indeksi (për zbatim)	Veprimi i planifikuar	Monitorimi i zbatimit nga Bordi i Drejtorëve / Menaxhmenti
58	M	2014	Dobësitë josistematike të prokurimit	Menaxhmenti i AKP-së: Të përcaktoj se pse kontratat e identifikuar janë dizajnuar pa u siguruar se kostot për AKP-en janë minimizuar. Për këtë arsye duhet të aplikohen procedura të përmirësuar për të siguruar se objektivi i parë është që të arrihet cilësia e nevojshme me çmimin më të mirë të mundshëm. Kontrollat duhet të përmirësohen edhe që të parandalojnë ofrimin e shërbimeve pa kontratë valide.	31 dhjetor 2015			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
59	M	2015	Përpilimi i Pasqyrave Vjetore Financiare të FM-ve dhe AKP-së	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF duhet të dorëzohet nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollat e nevojshme.	31 dhjetor 2016			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
60	M	2015	Moszbatimi i kërkesave për hartimin e objektivave strategjike	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për vendosjen e objektivave strategjike dhe hartimin e planit strategjik.	31 dhjetor 2016			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
61	M	2015	Menaxhmenti ekzekutiv jo në përbërje të plotë dhe shumë pozita drejtuese me ushtrues natyra	Kryesuesi i BD-së: Duhet të sigurojë rekrutim të stafit me kohë për të minimizuar periudhën e ushtruesit të detyrës.	19 maj 2016			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M	Implementuar	
62	M	2015	Mos përfundimi i procedurave të likuidimit të portfolios së NSH-ve	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë që OSHP-ja ka shtuar dinamikën e kryerjes së punëve si dhe hartimin e raporteve finale të likuidimit, në mënyrë që procesi i likuidimit të përfundojë brenda afatit kohor të paraparë me kontratë. Po ashtu, të sigurojë që në kontratën eventuale të ardhshme, të parashihet që kërkesat kolektive të së njëjtës natyrë të mos trajtohen si individuale në mënyrë që të kursehet kohë dhe mjete financiare.	31 dhjetor 2016			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M	Menaxheri i Kontratës	
63	M	2015	Mos realizimi i buxhetit në mënyrë sistematike	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë se janë analizuar arsyet për mos realizimin e buxhetit dhe të përcaktojnë veprimet praktike për të përmirësuar mangësitë. Për më tepër, të ketë një ndikim më të madh në të gjithë pjesëmarrësit në planifikim të buxhetit, për të krijuar buxhetin më real financiar dhe në përputhje me objektivat e kompanisë.	30 tetor 2016			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M	Në bashkëpunim me Departamentet / Njësitë përgjegjëse brenda AKP-së.	
64	M	2015	Gradimet dhe avancimet jo në pajtueshmëri me kornizën ligjore	Kryesuesi i BD-së: Të sigurojë që zbatimi i procedurave me rastin e avancimit dhe gradimit të nëpunësve të bëhet konform rregullores mbi avancimin dhe gradimin të nëpunësve.	31 dhjetor 2016			1			Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
65	BID	2013	AKP pa bazë ligjore kishte bërë ndryshimin e kushteve të kontratës fillestare për privatizimin e ndërmarrjeve me spin-off special	Bordi i Drejtorëve duhet të: Sigurojë vlerësime ligjore për ndryshime urgjente të cilat duhet të bëhen në kontrata dhe që të gjitha ndryshimet në kontratat e ardhshme të bëhen vetëm më pajtim me konkluzionet e këtij vlerësimi ligjor.	31-12-2014		1				Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
66	M	2013	Paqartësi dhe mungesë e kontrolleve adekuata në pagesat për kompensimin e anëtarëve ndërkombëtar të Bordit të Drejtorëve të AKP-së	Menaxhmenti i AKP-së duhet të rivlerësojë kornizën e përgjithshme qeverisëse në lidhje me Bordin e Drejtorëve të AKP-së për të siguruar se: Termat e Referencës formale aplikohen për të gjithë anëtarët e bordit, duke specifikuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë e tyre shtesë/specifike.	31-12-2014		1				Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
67	BID	2014	Kompensimi për punën e anëtarëve ndërkombëtarë të BD-së	Menaxhmenti i AKP-së: Duhet të sigurojë se KSE-të janë paraqitur për të gjithë anëtarët e ardhshëm të Bordit të ardhshëm dhe që baza për pagesat e bëra t'i pasqyroj ato dhe rregulloret e ndërlidhura. Duhet të aplikohet një formë e rishikimit të pavarur siç ka qenë qëllimi edhe më parë.	31 gusht 2014		1				Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID	Rekomandim i tejkaluar	

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
Nr.	Indeksi	Viti	TË GJETURAT	REKOMANDIMI I ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	Afati i VJETËR për zbatim	Arsyeja e mos implementimit	Tejkaluar	PO	JO	Pjesërisht	Njësia organizative përgjegjëse për zbatim	Afati për adresim	Indeksi (për zbatim)	Veprimi i planifikuar	Monitorimi i zbatimit nga Bordi i Drejtorëve / Menaxhmenti
68	BID	2014	Ndikimi në investime nga aktivizimi i ulët i fondeve në mirëbesim	Bordi i ardhshëm të: Zhvilloj dhe implementoj një strategji investimi e cila e përcakton minimumin e kërkesave për likuiditet bazuar në kërkesat e pritura nga Fondi i Privatizimit dhe ta maksimizoj kthimin nga investimet në fondet e rehatura.	31 dhjetor 2015		1				Bordi i Drejtorëve	31-Dec-16	BID		
69	DKL	2014	Nuk është ofruar ndërprerja formale e marrëdhënies së punës	Menaxhmenti i AKP-së duhet: Ta përcaktoj se pse nuk janë ofruar dokumente/vendime zyrtare për ndërprerje të marrëdhënies së punës në rastet e identifikua dhe t'i përmirësoj kontrollet për të ofruar konfirmimin që të gjitha dokumentet/vendimet për shkëputje të marrëdhënies së punës u janë shpërndarë të punësuarve në ditën e shijes së NSH-së.	31 dhjetor 2015		1				Departamenti i Koordinimit të Likuidimit	31-Dec-16	DKL		
70	M	2014	Rregullorja e brendshme për shpërndarjen e 20% i tejkaloni dispozitat e rregullores bazike	Menaxhmenti i AKP-së duhet të: Merr këshilla ligjore për të konfirmuar se rregulla e saj e brendshme lidhur me shpërndarjen e 20%-ëshit është në harmoni të plotë me ligjet dhe rregulloret ekzistuese dhe nëse është e domosdoshme të aplikoj ndryshime për të siguruar se është arritur harmonia.	31 dhjetor 2015	Ka mospajtime ndërmjet ZKA-së dhe AKP-së. Moshja e pensionimit prej 65 vjet është e rregulluar me ligj.	1				Menaxhmenti	31-Dec-16	M		
71	QK	2013	Mungesa e përbërjes së plotë të Bordit të Drejtorëve të AKP-së	Bordi i Drejtorëve duhet të: Paraqes në Kuvend nevojën për aprovimin e dispozitave të cilat përcaktojnë qartë afatet kohore dhe organin përgjegjës për përzgjedhjen e konkursit për një bord në përbërje të plotë të një kualiteti të duhur i cili do të siguronte funksionimin e Agjencisë.	N/A		1				Qeveria dhe Kuvendi	31-Dec-16	QK	Kuvendi i Kosovës	
72	QK	2014	Mungesa e përbërjes së plotë të Bordit të Drejtorëve të AKP-së	Kuvendi i Kosovës duhet që: Përmes komisioneve të tij funksionale, si çështje me urgjencë, ta implementoj një orar kohor për rekrutim të një Bordi të Drejtorëve të kompletuar. Kjo duhet ta përfshij edhe dispozitën që i përmbush nevojat për zëvendësimet në BD në të ardhmen, me kohë, nëse paraqiten vende të lira.	N/A		1				Qeveria dhe Kuvendi	31-Dec-16	QK	Ky rekomandim është i pa aplikueshëm. AKP-ja nuk ka kompetenca ligjore për adresimin e këtij rekomandimi (Duhet t'i adresohet Kuvendit të Kosovës) - i Tejkaluar	